



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 27.5. 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
27.05. 2011. GODINE**

**MAJ – MAJA
2011**

E premte, më 27. 5. 2011,

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupeve parlamentare 5 minuta, për deputetët 3 minuta. Ju njoftoj se koha është e rezervuar për deputetët, replika nuk ka, që ta dini paraprakisht. Vazhdojmë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po diskutojmë sot në një moment të veçantë, kur e tërë bota vazhdon t'i gëzohet dhe ta përshëndesë një ngjarje të madhe dhe të mirë për njerëzimin që ndodhi dje- arrestimin e kriminelit të luftës, atij që kreu krimet më të mëdha kundër njerëzimit dhe që e bëri gjenocidin në Bosnjë, Ratko Mlladiqit.

Pas eliminimit të kriminelit dhe terroristit të shumëkërkuar për 10 vjet, Osama Bin Ladenit, bota dhe gjithë ne po i gëzohemi arrestimit të një kriminelit tjetër, që u kërkua për 15 vjet, Ratko Mlladiqit.

Por, Serbia kapi kriminelin në një moment të veçantë, për të kryer pazare të tjera politike dhe për të përfituar në arenën ndërkombëtare, e jo pse ajo donte të dënojë kriminelin, terrorin dhe gjenocidin që ndodhi në Bosnjë nga udhëheqësit e saj politik në 10 vjetët e fundit të shekullit XX.

Serbia kapi kriminelin Mlladiq, në ditën e vizitës në Beograd, të zyrtares së lartë evropiane, Kathrin Ashton dhe për t'i eskivuar dhe shtyrë, në anën tjetër, nënshkrimin e të paktës së një marrëveshje me Kosovën gjatë bisedimeve në Bruksel.

Serbia vepron ashtu sa herë që e ka ndonjë presion tjetër politik ndërkombëtar, e jo pse ka një vullnet të vërtetë për të ndëshkuar krimin.

Serbia kapi Mlladiqin, por jo edhe kriminelë tjerë, ajo po e dorëzon një nga udhëheqësit dhe ideatorët e gjenocidit, por po i mbanë të fshehur dhe po strehon në gjirin saj, një armatë e tërë kriminelësh dhe kryesish të gjenocidit në Ballkan.

E ftojme Serbinë që nëse donë të tregojë fytyrë tjetër nga ajo e Millosheviqit, t'i arrestojë të gjithë kriminelët dhe ta bëjë denoncimin e vërtetë të krimit që paraardhësit politikë të

Serbisë së liderëve të sotëm të saj, Tadiqit, Jeremiqit dhe bashkëpunëtorëve të ngushtë politikë të Ivica Daçiqit, i kryen si Kroaci, Bosnjë ashtu edhe në Kosovë.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se Mlladiqi dhe bashkëpunëtorët e tij janë kriminelët e vërtetë e jo prijësit dhe udhëheqësit e luftës për lirinë e popujve në Kroaci, Bosnjë e Kosovë, të cilëve dikush po mundohet t'ua shpifë dosjet e t'ua vizatojë dëshmitarët, në mungesë të plotë provash, faktesh kundër tyre.

Nëse drejtësia në Ballkan duhet të vendoset plotësisht, atëherë, lajmi për arrestimin e Mlladiqit, është lajm i mirë për demokracinë.

Ne si deputetë të Kuvendit, por edhe si qytetar dëshiroj të shpërej shqetësimin tim për grevën e një grupi të veteranëve dhe invalidëve të luftës. Askush nga ne nuk mund të ndihet mirë dhe të rrijë indiferent ndaj pamjeve që besoj që secili prej jush i ka parë gjatë rrugës për të ardhur në sallën e këtij Parlamenti.

Besoj që kjo grevë, para dyerve të institucioneve, nuk është një mesazh dhe pamje e mirë, as për mysafiren e lartë evropiane që do të vizitojë sot Kosovën.

Unë i besoj vullnetit politik dhe angazhimit të kryeministrit, Qeverisë dhe institucioneve tjera të vendit për përmirësimin e kushteve dhe rritjen e mirëqenies për kategoritë e luftës.

Po ashtu besoj se qeveria e Kosovës shumë shpejtë do t'ia sjellë këtij Kuvendi miratimin e Ligjit, që është kërkesë jo vetëm e këtij grupi, por edhe gjithë veteranëve dhe invalidëve të luftës. Invalidët dhe veteranët grevistë duhet të kenë besim te institucionet dhe shteti i tyre që do t'i kryejë obligimet që kanë ndaj këtyre kategorive meritore.

Unë dëshiroj të besoj në një zgjidhje të shpejtë të kësaj situate jo të këndshme, në mënyrë që grevistët t'i kthehen jetës së tyre normale duke i dhënë kohë institucioneve që në afatin e duhur të miratojnë ligjin.

Invalidët dhe veteranët e luftës për liri kanë bërë shumë sakrifica, prandaj të gjithë duhet të punojmë të mos i detyrojmë ata të bëjnë sakrifica tjera. Ata kanë nevojë për mbështetje dhe përkujdes të duhur institucional që u garanton jetë të dinjitetshme. Unë besoj në gatishmërinë e institucioneve dhe shoqatave të dala nga lufta që të bisedojnë me grevistët për të gjetur një zgjidhje të shpejtë dhe të pranueshme. Mungesa e komunikimit nuk prodhon asnjëherë zgjidhje të problemit. Kërkoj falje se unë i pata dy fjalë, por nuk e ndava për shkak se isha në emër të Grupit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Unë do të doja ta ngrit edhe një shqetësim edhe në një mënyrë një kërkesë. Shqetësimi ka të bëjë me vërshimet e para disa ditëve në Prishtinë. Dhe, sigurisht që ne përshëndesim atë që Qeveria i ka ndihmuar shumë shtete, të cilat besoj s'kanë bërë kërkesë dhe konsiderojmë që s'ka pasur nevojë të bëjnë kërkesa ato për rastet që kanë pas fatkeqësi, duke përfshirë Haitin, Pakistanin e Shqipërinë e shumë shtete tjera. Kjo është për ta përshëndetur sikur që besoj edhe shteti Santa Lucia, s'ka bërë kërkesë për ta ndihmuar. Sidoqoftë ne do të duhej të solidarizoheshim me ato familje, sepse kanë pësuar shumë nga një fatkeqësi që është natyrore, sigurisht, po që është obligim i Qeverisë së Kosovës, sigurisht edhe komunës së Prishtinës. Dhe, komuna e Prishtinës e dini që ka ndarë një shumë prej 70 mijë euro për t'i ndihmuar dhe po ashtu do ta plotësojë besoj atë anën formale të kërkesës siç e ka thënë Qeveria, kërkesës së Qeverisë që t'iu ndihmojë këtyre familjeve dhe pa dyshim që në raste të tilla, mendoj që duhet të veprojmë shumë më shpejtë dhe ata qytetarë janë taksapagues edhe të Qeverisë edhe sigurisht të komunës së Prishtinës, dhe mendoj që qasja ndaj këtij rasti nuk ka qenë korrekte në nivelin e Qeverisë dhe besoj që ata do të reflektojnë dhe do t'iu ndihmojnë këtyre familjeve, sepse fatkeqësitë natyrore nuk duhet të ndajnë njerëzit në parti politike dhe kjo në asnjë mënyrë nuk do të duhej edhe të keqpërdorej si rast, sepse është fatkeqësi. Edhe një herë përsëris kërkesën edhe shqetësimin, po besoj që kjo e para, kërkesa do të miratohet në një mënyrë nga Qeveria do të kihet parasysh kjo dhe do t'iu ndihmohet këtyre familjeve të cilët vërtet kanë pësuar nga një fatkeqësi dhe për raste të tilla fundi i fundit Qeveria ka mjete dhe ka obligim. Ju e dini gjithë që shpeshherë ndahen mjete ndoshta edhe për çështje që s'janë edhe shumë urgjente. Unë desha vetëm në emër të Grupit të deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës e besoj që ky shqetësim është edhe i deputetëve të tjerë dhe këto familje meritojnë t'iu ndihmohet dhe ta tejkalojnë këtë situatë të vështirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, në emër të Grupit.

REXHEP SELIMI: I nderuar zoti kryetar,

Kolegë deputetë,

Sot dua ta shfrytëzoj këtë foltore për ta ngritur një shqetësim, shqetësim i cili nuk është larg nga ky objekt, për vetë faktin se pak metra nga ky objekt është ngritur një tendë, në atë tendë janë futur në grevë veteranët e Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kërkesat e tyre për ligj.

Pra, ata kërkojnë diçka, ata kërkojnë ligj, ata i kërkojnë të drejtat e tyre dhe njëkohësisht ata kërkojnë që Ligji për veteranët e luftës të procedohet sa më shpejtë dhe të mos prolongohet më.

Në të njëjtën kohë, mendojmë që përgjigja e institucioneve të Kosovës, përkatësisht e Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, të cilave ata u drejtohen nuk ka qenë aspak dinjitoze dhe po thuaj se ka qenë injuruese për ta.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, shprehim brengosjen tonë thellë për shëndetin e tyre dhe mbi të gjitha për gjendjen e tyre për ata çfarë janë futur në grevë.

Normalisht, greva e tyre, siç duket edhe mund të përshkallëzohet, për shkak se ata nuk janë futur në grevë për dy ditë. Njëkohësisht nuk do të doja që kurrë veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të futeshin në grevë. Po ashtu edhe ne si Grup Parlamentar nuk do të donim t'i shihnim kurrë veteranët e luftës të futen në grevë, por greva ka filluar dhe ne i mbështesim kërkesat e tyre për procedim sa më të shpejtë të Ligjit për veteranët e luftës, kërkesë e cila ka dalë nga ky grup i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Normalisht që i kemi përcjell gjatë gjithë kohës reagimet e subjekteve të ndryshme, qoftë ato subjekte të ndryshme politike, qoftë ato qeveritare dhe të organizatave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i kemi përcjell, i kemi analizuar, por megjithatë unë mendoj që, edhe ne mendojmë që veteranët e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë një të drejtë dhe nuk janë aty me dëshirën e tyre dhe nuk janë aty për politikë dhe të mbështetur nga asnjë grupacion politik. Dhe, më lejoni që po ashtu t'ju konfirmoj që lëvizja "Vetëvendosje" i mbështet kërkesat e tyre, jo futjen e tyre në grevë, po përderisa ata janë në grevë, ne do t'i mbështesim kërkesat e tyre dhe grevën e tyre.

Në të njëjtën kohë, normalisht që edhe nga deputetët këtu mund të kërkohet që ata t'i kthehen jetës së tyre normale, por të mos harrojmë që ata nuk ka ardhur nga jetë normale në një tendë para Qeverisë së Kosovës, pra jetën normale ata duhet ta kenë të rregulluar me ligj.

Po ashtu më lejoni të shpreh edhe brengosjen tonë për tendencat e pushtetarëve për t'i dhënë kahe politike kësaj greve, edhe një herë e konfirmoj që lëvizja "Vetëvendosje" nuk e ka mbështetur hyrjen e tyre në grevë, po mbështet të drejtat e tyre.

Në të njëjtën kohë është thënë që ata nuk përfaqësojnë veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sidoqoftë ata përfaqësojnë pjesën e të pakënaqurve, jo pjesën e të kënaqurve të veteranëve edhe mirëfilli dihet se sa janë të kënaqur dhe sa janë të pakënaqur në organizatën e veteranëve. Pra, ata përfaqësojnë pjesët e të pakënaqurve, ata përfaqësojnë familjet e tyre që janë në gjendje shumë të rëndë dhe tek e fundit përfaqësojnë luftën e tyre dhe plagët e tyre që po vazhdojnë t'i mbajnë në tendë.

Sidoqoftë, u bëj thirrje gjithë deputetëve të Kosovës e në veçanti të gjithë atyre bashkëluftëtarëve dhe veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kthehen te kjo tendë dhe t'i shohim se çfarë kërkesash kanë ata. Dhe, njëkohësisht më lejoni që të kërkoj nga kryesia e Kuvendit dhe nga Kuvendi, që ta formojë një grup pune, t'i vizitojë ata, t'i marrë kërkesat e tyre, sepse tek e fundit ata janë futur për të drejtat dhe për ligj dhe nuk ka nevojë që t'i quajmë ne ata njerëz të cilët e shkelin ligjin, sepse ata po kërkojnë ligj, asgjë më tepër se sa ligji.

Pra, zoti kryetar, më lejoni të kërkoj nga ju dhe deputetët, që të formohet një grup, t'i vizitojë menjëherë ata, t'i marrë kërkesat e tyre dhe pse jo t'ua plotësojë kërkesat e tyre për një seancë të jashtëzakonshme. Ne e dimë që Ligji për veteranët e luftës është dikur gjatë verës dhe gjatë vjeshtës së këtij viti, por gjendja është më urgjente se sa ne mund ta kemi komoditetin tonë ta presim agjendën, ta presim me komoditet agjendën dhe

zhvillimin e agjendës. Veteranët e luftës kanë të drejtë, prandaj më lejoni edhe një herë të shpreh përkrahjen për kërkesat e tyre të drejta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ramiz Kelmendi, e ka fjalën. Në emër të Grupit apo në emër tënd personal?

RAMIZ KELMENDI: Në emrin tim personal.

KRYETARI: Mirë, e ke fjalën!

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryeparlamentar,

Të nderuar kolegë,

Kosova ka fqinjësi me shtete miqësore dhe jo miqësore, prandaj, ne duhet të bëjmë legjislacion fiskal të atillë që të zvogëlojmë ndikimin e këtyre shteteve në ekonominë e Kosovës dhe atë duke detektuar artikujt apo shërbimet që vijnë nga këto shtete dhe duke i liberalizuar këto shërbime apo artikuj me shtete të Evropës së pari, dhe shtete të tjera së dyti.

Nëse angazhohemi me kujdes të veçantë dhe të pandikuar në lobistët e ndryshëm, atëherë ky ndikim i shteteve jomiqësore do të zvogëlohet që në vitin e parë për 30%. Çka duhet bërë për të ardhur deri te kjo? Duhet së pari të identifikojmë shërbimet dhe artikujt që janë ndikues në tregun e Kosovës nga shtetet jomiqësore dhe liberalizimin e tregut me shtetet tjera për këto produkte dhe shërbime siç janë për shembull: vaji, sheqeri, mielli dhe të tjera. Identifiko dhe heq doganën për ato kategori shërbimesh dhe produktesh që mundësojnë zhvillimin e prodhimit të qëndrueshme dhe stabile vendore që t'i plotësojnë kërkesat vetjake, shtimin e kërkesave pas liberalizimit dhe mundësinë e rritjes së eksportit dhe konkurrencë të denjë me shtete të tjera, duke e ditur se kjo mundëson rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike për 30%.

Kjo formë e liberalizimit të kujdesshëm do të mundësojë rritjen apo qëndrueshmërinë buxhetore të aprovuar në Kuvend, sepse ky liberalizim do mundësojë konsum më të madh dhe eksporte më të fuqishme, do të vëmë në veprim ligjin e tregut të lirë ekonomik, që është bazë e suksesshme e ekonomisë botërore. Kjo formë e identifikimit dhe veprimit na bën shtet vetjak dhe me veprime në interes të qytetarëve dhe ekonomisë së tyre dhe në arenën ndërkombëtare shton imazhin dhe nuk cenon interesat e bashkësive që jetojnë në Kosovë. Duke vepruar në këtë mënyrë shtojmë miqësinë me shtetet tjera të Evropës dhe regjionit dhe shtohet përkrahja e atyre ndërkombëtare dhe lobimi i tyre për Kosovën.

Gjithnjë duhet të jemi të kujdesshëm që çdo veprim ynë të mos jetë mollë përfitim i të tjerëve nga ndryshimet e nevojshme dhe të domosdoshme, të jetë veprim që nuk cenon lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë dhe mallrave të tranzituara nëpër këto shtete pas liberalizimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Vjosa Osmani, e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot dua ta ngrejë një çështje që po i shqetëson thellë gjithë qytetarët e Kosovës, por në veçanti nxënësit dhe prindërit e tyre.

Siguria në shkolla, apo më mirë të them mungesa e sigurisë në shkolla deri tani ka shkaktuar një numër viktimash në mesin e nxënësve dhe të rinjve. Bredhja e individëve që mbajnë armë pa leje nëpër oborret e shkollave dhe në afërsi të shkollave, është një dukuri shqetësuese e cila edhe para pak ditësh pati si pasojë vrasjen e një të riu para Gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë. Fatkeqësisht, kjo nuk është hera e parë që raste të tilla ndodhin në shkollat e Kosovës, sepse bilanci është aq i tmerrshëm sa që arrin deri në qindra incidente mes nxënësve brenda një gjysmë vjetori shkollor, të cilat shpesh përfundojnë me pasoja fatale. Dhuna në shkolla po reflekton atë çka është duke ndodhur në shoqërinë tonë si tërësi.

Përpjekjet e institucioneve përgjegjëse për vënien e rendit në ambientet shkollore deri tani po shihet nga praktika se kanë dështuar, meqë vrasjet dhe veprat tjera penale si ngacmimet, rrahjet e fyerjet mes nxënësve po vazhdojnë në nivele tashmë shqetësuese. Fatkeqësisht, kjo bërë që frika në mesin e mijëra nxënësve të rritet dhe ata të jetojnë në ankth dhe presion, pa qenë të sigurt për jetën e tyre. Këto probleme nuk mund të zgjidhen me përpjekje të institucioneve lokale, por kërkojnë një koordinim dhe angazhim serioz të institucioneve qendrore.

Prandaj, këto institucione, në veçanti Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Arsimit, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që procesi edukativo- arsimor të mos jetë një sfidë që nga vetë nxënësit konsiderohet si rrezikuese për jetën e tyre, por po ashtu t’i identifikojnë shkaqet dhe arsyet që po qojnë deri te këto vepra, të gjenden zgjidhje konkrete që do të ndikonin në luftimin e këtyre krimeve dhe reduktimin e përfundimisht asgjësimit të tyre.

Në veçanti është tejet me rëndësi që strategjia për siguri në shkolla, e hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Arsimit, të mos mbetet edhe një nga qindra letra e pazbatuara, por të përfundohet menjëherë dhe zbatimi i saj të fillojë me urgjencë, në mënyrë që të luftohet kjo dukuri që ka marrë përmasa shqetësuese. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Janë dy çështje që dëshiroj t’i ngre në këtë pikë.

E para është për një marrëveshje mes vendit tonë dhe Zvicrës, për sa i përket pensioneve të qytetarëve tanë që kanë punuar atje. Dhe siç e dini në nivelin teknik ka një lloj dialogu që po zhvillohet, mirëpo rezultati konkret ende nuk është. Dëshiroj të ngre këtë çështje

dhe të bëjë ftesë Qeverisë që tashmë kur ka edhe një ministri të veçantë që do të merret me çështje të emigracionit, ta shtroj këtë çështje në nivelin politik dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur qytetarët tanë t'i realizojnë të drejtat e tyre. Siç e dini, njëanshëm është shkëputur kjo marrëveshje, janë qitur disa kushte që janë krejtësisht teknike, komuniteti kosovar në Zvicër tashmë zyrtarisht është i pesti, është në interes edhe i shtetit zviceranë, ajo që na duhet tash është ta ngrisim më fuqishëm nivelin politik dhe diplomatik, në mënyrë që kjo e drejtë të realizohet sa më shpejtë. Unë besoj që tash siç e thashë me plotësimin edhe të një ministrie që do të merret vetëm me këtë punë, besoj që kjo mund të bëhet edhe më lehtë.

Dhe çështja tjetër është, me qenë se po bëhen punë me ndryshimin e Kushtetutës, është mirë që urgjentisht të trajtohet edhe çështja e të burgosurve, është një grevë që po zhvillohet tash për çështje të amnistisë. Ka disa vjet radhazi që këto sinjale vinë nga të burgosurit që janë nëpër burgjet në Kosovë, është mirë që krahas punës që po bëhen për ndërtimin e burgjeve të reja që ka në plan Qeveria, bashkë me donacionet e BE-së, është mirë që në paketë të ndërtohet edhe një strategji për ndryshimin kushtetues. Siç e dimë ne ka një nen atje, në një pjesë të Kushtetutës ku i lejon presidentit të drejtën e lirimit ose të amnistisë. Kërkesa është që të ketë ligj të veçantë dhe mendoj që është koha në një paketë të ndryshimeve kushtetuese të trajtohet kjo.

Mendoj që do të jetë sinjal i mirë dhe do ta plotësonte këtë fushë, e cila ka mangësi dhe siç e thashë ka disa vite radhazi që ka elemente të tilla, protesta të tilla nga vetë të burgosurit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputetja Alma Lama, e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit!
I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë

Një krim shumë i rëndë ndodhi para pak ditësh në mes të kryeqytetit të Kosovës, në mes të ditës dhe mes dhjetëra kalimtarëve. Diana Kastrati, 27 vjeçare, nënë e një fëmije, u qëllua për vdekje nga ish-bashkëshorti.

E gjithë shoqëria është tronditur nga kjo vrasje e shëmtuar, të gjitha gratë, nënat dhe motrat janë të indinjara me apatinë e organeve të rendit për të arrestuar dorasin.

Vrasja e Dianës nuk është një krim individual, por është një krim i përbashkët i një bashkëshorti vrasar dhe i një gjykate të papërgjegjshme e cila nuk ndërmori masat parandaluese në kohën e duhur. Dhe, kjo e bën edhe më të rëndë këtë tragjedi.

Mungesa e vëmendjes së organeve të drejtësisë, të cilat dështuan të parandalojnë këtë krim, është e pafalshme. Gjykata Komunale e Prishtinës nuk ishte përgjigjur pozitivisht kërkesës së Dianës për t'i dhënë asaj mbrojtjen e nevojshme për jetën. Ky refuzim i bërë

me kaq lehtësi, nuk është gjë tjetër, veçse mungesë përgjegjshmërie dhe profesionalizmi, por është njëkohësisht edhe mungesë ndjeshmërie njerëzore.

Çfarë mund të jetë më e rëndësishme në punën e një polici, prokurori apo gjyqtari sesa të marrë në mbrojtje një jetë njerëzore? Asgjë.

Sot kur po flasim, janë me qindra gra apo mijëra raste të raportuara në polici, ku gratë janë viktimat e dhunës në familje.

Por, qindra gra të tjera që përjetojnë dhunë psikologjike dhe fizike, hezitojnë t'i drejtohen këtij institucioni, pikërisht për shkak të mungesës së besimit.

Dhe, rasti i Dianës vetëm sa ua ka konfirmuar dyshimin në organet e sigurisë dhe drejtësisë. Vrasja e Dianës do t'i dekurajojë me dhjetëra apo qindra gra të tjera për të kërkuar mbrojtje nga shteti.

Sot në Kosovë janë me dhjetëra gra të cilat nuk do të dëshironin gjë tjetër në jetë, veçse të gjenin një strehë ku të fusnin kokën e të largoheshin një herë e mirë nga ferri i dhunës ku jetojnë.

Sot në Kosovë janë me qindra fëmijë të cilët rriten në një ambient i cili garanton vetëm një të ardhme për ta, atë të prindërve të tyre.

Sot në Kosovë, gruaja nuk ka të garantuar as minimumin pra, jetën. Do të ishte ironi të flisnim tani për diskriminimin e saj në shoqëri, institucione, vendimmarrje, ekonomi e tjerë.

Rasti fatkeq i Dianës duhet të na shërbejë të gjithëve për t'u treguar më të vëmendshëm për dhunën në familje, e në radhë të parë duhet të jetë një kampanë alarmi për institucionet e drejtësisë, vendimet e të cilëve peshojnë me jetë njerëzish.

Lëvizja “Vetëvendosje” kërkon nga ministria e Drejtësisë dhe institucionet që emërojnë dhe kontrollojnë punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, që të tregohen më të përgjegjshëm dhe të heqin dorë nga emërimet politike dhe nga retorika e zbrazët, e të angazhohen seriozisht për të ndërtuar një gjyqësor të pavarur dhe të nivelit të lartë profesional.

Në të kundërt, rasti i Dianës do të na përsëritet sërish dhe krime të tjera të shëmtuara do të ndodhin, sa kohë që kriminelët nuk e ndjejnë frikën e ndëshkimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit, fjalën e ka kërkuar deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Kërkesa për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, është në vazhdimësi një kërkesë dhe një presion që po na bëhet edhe si grup parlamentar përmes qytetarëve të asaj zone, të cilët konsiderojnë se zvarritja e procesit të demarkacionit me Malin e Zi, po vazhdon t' i shqetësojë banorët në të dy anët e kufirit. Sidomos, tendenca e kohëve të fundit për të zbritur kufirin, ka ngritur tensionet të cilat rrezikojnë t' i prishin marrëdhëniet e mira ekzistuese ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi.

Në vazhdimësi kryetarët e komunave përkatëse kanë drejtuar kërkesa me shkrim për të finalizuar sa më parë këtë proces, mirëpo Qeveria Thaçi nuk ka vepruar. Sot territori i Kosovës po copëtohet në të gjitha anët e kufirit e nga kjo të vetmit të cilët po përfitojnë janë kontrabanduesit dhe cisternat e naftës, ndërsa neglizhenca e vazhdueshme e Qeverisë Thaçi po krijon përshtypjen sikur nga kjo zvarritje po përfiton edhe vetë Qeveria, përndryshe do të ishte më aktive në këtë drejtim.

Dhe derisa qeveritarët kohë pas kohe në takime kurtuazie po e ngritin kalimthi si temë, ata që po humbin janë banorët të cilëve jo u rrezikohet qasja në pronë dhe kjo po ndodhë në vazhdimësi, po nxit tensionimin e panevojshëm të vendbanimeve ndërkufitare në të dy anët e kufirit, të cilat nuk shkojnë në favor të fqinjësisë së mirë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kërkon, në emër të banorëve të këtyre anëve, që sa më shpejtë të kalohet nga fjalët në vepra, me qëllim të finalizimit të demarkacionit, që është kërkesë jo vetëm e banorëve, por do të shkojë edhe në favor të raporteve të mira ekzistuese ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryetar,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Shqetësimin që unë do të ngre sot në këtë pikë të rendit të ditës ka të bëjë me magjistralen Prishtinë – Pejë, konkretisht me aneksin rrugor afër fshatit Korroticë të Drenasit.

Kjo magjistrale që e dinë të gjithë që është shumë e dobishme dhe me admirim e kanë pritur të gjithë qytetarët e Kosovës, dita- ditës po shndërrohet në rrezik për banorët e fshatit Korroticë, por edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës që kalojnë në ato anë. Si rrezik permanent gjithmonë në këtë rrugë janë prezentë kafshët shtëpiake të fshatit Korroticë, por gjithashtu edhe rreziku vjen nga ngasësit e makinave të cilët të shkujdesur bëjnë kthime gjysmë rrethore aty ku të ju teket, domethënë, në vendet e palejuara. Prandaj, kërkoj nga Ministria e Infrastrukturës që ta shqyrtojë këtë çështje me urgjencë dhe të mos ta neglizhojë tutje, sepse dita -ditës kjo magjistrale po shkakton rrezikun e jetës së qytetarëve të Kosovës, konkretisht të banorëve të fshatit Korroticë të Drenasit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Imri Ahmeti, e ka fjalën.

IMRI AHMETI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Siç duket sot në Kosova asgjë nuk do të shpëtojë nga komercializimi dhe shfrytëzimi i mundësive për përfitime materiale, pa marrë parasysh se si ku bëhet, ndaj kujt bëhet dhe cilat mund të jenë pasojat.

Të gjithë e dinë se institucionet tona shkollore organizojnë aktivitete të ndryshme si eskurzione, vizita, shëtitje, mbrëmje të maturës e tjera, nganjëherë pa asnjë karakter edukativo - arsimor dhe me kosto mjaftë të lartë financiare për familjet tona edhe ashtu me mjaftë halle të kësaj natyre, ndonëse ka një udhëzim administrativ i cili fare nuk përfillet.

Por, objektivi im është pikërisht tek një aktivitet i veçantë i filluar javëve të fundit në shkollat fillore lidhur me shfaqjen e projektit filmik të Halil Budakovës për Azem Bejtën dhe pjesëmarrjen e organizuar të nxënësve të nivelit fillor dhe parafillor në shfaqjen e këtij filmi. Kjo ka ndodhur javën e kaluar dhe po vazhdon të ndodhë në komunën e Lipjanit, mbase mund të jetë zhvilluar e gjetiu. Unë nuk jam këtu për vlerësimin e këtij filmi, sigurisht ky film ka vlerat e veta dhe është temë për kritikët e filmit, por unë kam pasur rastin të takojë fëmijë të trishtuar e prindër të shqetësuar dhe ndaj bindjen se institucionet tona shkollore nuk do të duhet t'i ekspozojnë fëmijët pranë skenave të tilla.

Shkenca e pedagogjisë dhe veçanërisht ajo për zhvillimin e psikologjisë fëmijërore, kanë paraqitur rezultate shkencore të konfirmuara se fëmijët duhet të mbrohen nga skenat e ndryshme të dhunës të ndodhura në çfarëdo forme, sepse fëmijët mund të kenë pasoja zhvillimin psikofizik dhe në gjendjen e tyre emocionale. Kjo mënyrë e organizuar nga shkollat për nxënësit e të gjitha niveleve, pa përjashtuar as parashkollorët, nuk ka asnjë karakter edukativ- arsimor dhe pedagogjik, sepse kjo moshë e fëmijëve dhe nxënësve 5 – 6 vjeçar nuk e akcepton përmbajtjen e këtij filmi.

Imagjinoni, të nderuar kolegë deputetë, vetëm momentin e fikjes së dritave dhe krijimin e territ në sallë, paramendoni skemat e krismave të armëve, zjarrin e gjakun, deri te skenat e sakatimit të gjymtyrëve të trupit në këtë film, për fëmijët e moshës 5-6 vjeçare, kjo sjell vetëm trishtim dhe të njëjtën kohë mund të sjellë tronditje, që do të ketë të meta sigurisht në gjendjen e tyre të ardhshme emocionale dhe të njëjtën kohë frymëzon dhunën, frymëzon krismën, frymëzon zjarrin, frymëzon sjelle të tjera devijante.

Kjo shfaqje filmike nuk është e shikuar mirë nga Ministria, përkatësisht nga dikasteret e Ministrisë së Arsimit, nuk është bërë anamneza dhe nuk është dhënë asnjë leje nga Ministria përkatëse, në mënyrë që fëmijët të qohen në mënyrë të organizuar në këtë film. Parashqevi Simaku dikur këndonte një këngë për fëmijë:” mos ua prishni lumturinë, mos ua prekni dashurinë” sepse ata vetëm fëmijë janë, por siç duket ky mesazh nuk vlen për të gjithë e aq më keq për disa që si duket janë në gjendje ta zgjasin dorën e korrupsionit edhe tek te fëmijët parashkollorë, me qëllim të zhvatjes dhe përfitimeve nga të cilat së

paku do të duhej kursyer fëmijët. Pres që ministri i Arsimit të reflektojë sa më parë që kjo dukuri të ndërpritet dhe jam i bindur që këtë do ta bëjë, në mënyrë që fëmijët të mos pësojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi harxhuar kohën. Ndoshta këta që kanë mbetur nuk dëshirojnë për herën tjetër se vjetrohen ato çka kanë dashur t'i thonë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës-

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve është e kufizuar në 60 minuta, deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti 2 pyetje parlamentare.

Fillojmë me pyetjen e parë.

Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Blerand Stavileci, Blerandin s'e kemi këtu, deputet a do ta bësh pyetjen? Herën tjetër, mirë. Faleminderit!

Deputetja Rita Hajzeraj – Beqaj, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, ministrin s'e kemi këtu.

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ – BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Me qenë se është hera e dytë dhe ministri nuk është këtu, me siguri është duke lobuar për Kosovës, për atë çështje edhe është pyetja ime parlamentare.

Pra, pyetja ime është se për zotin ministër se prej marrjes së postit të ministrit të Punëve të Jashtme, sa njohje ka sjell për shtetin e pavarur të Kosovës? Nëse po, cilat janë ato shtete, nëse jo, a konsideron ministri se është duke e përmbushur detyrimin e tij karshi qytetarëve të Kosovës në këtë ministri për këtë çështje? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Njazi Idrizi, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

Ministrin e kemi këtu, deputet e ke fjalën!

NJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryeparlamentar,

Pyetja ime ka të bëjë me ujërat termominerale në Kosovë. Siç është e ditur në një hapësirë të konsiderueshme të Kosovës gjendet edhe një resurs i rëndësishëm, i cili nuk është duke e dhënë kontributin e vetë për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe në krijimin e mirëqenies. Më intereson ta di- ku shtrihen këto ujëra, sa është potenciali i tyre, në cilën thellësi ndodhen, sa arrijnë temperaturat e tyre, me qëllim që këto ujëra vihen në shërbim të bizneseve dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë nga Kabineti qeveritar,

I nderuar deputet Idrizi,

Çështja e ujërave në përgjithësi dhe çështja e ujërave terminale është e rregulluar me ligjin nr. 2004/24 për ujërat e Kosovës. Ky ligj rregullon çështjen të cilat kanë të bëjnë me administrimin, planifikimin mbrojtjen dhe përgjegjësinë institucionale në fushën e ujërave dhe resurseve ujore. Kompetencë për çështjen e ujërave, menaxhimin, trajtimin dhe rregullimin në përgjithësi të këtyre çështjeve, është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, prandaj, unë nuk jam kompetent për tu përgjigjur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetje shtesë, nuk ka. Faleminderit!

Deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministren Flora Çitaku. Ministra nuk është këtu, a doni ta bëni pyetjen, deputet? Faleminderit!

Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin Tomiq Radoica, mund ta bëni pyetjen ministri është këtu.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetje për ministrin për Komunitete dhe Kthim.

Zoti ministër, cilat janë kriteret për ndërtim dhe rindërtim për të kthyerit dhe struktura etnike e komuniteteve që kanë përfituar në ndërtim, nga Ministria për Komunitete? E bëj këtë pyetje për arsye se Ministria për Komunitete që nga viti 2004 ka një fond milionësh që merret me ndërtim dhe rindërtim dhe në këtë drejtim besoj që ka shkelje për arsye se 90% përfiton komuniteti serb, ndërsa komunitetet tjera kanë përfitua shumë pak. Për këtë arsye e bëj edhe këtë pyetje.

KRYETARI: Faleminderit!

Ministër, e ke fjalën.

TOMIQ RADOJICA: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Dame i gospodo i kolege ministri,

Gospodo narodni poslanici,

Uvaženi narodni poslanice Neziraj

Nemoguće je odgovoriti na ovo pitanje a da vas prethodno ne upoznam sa strategijom Ministarstva za zajednice i povratak. Naime, strategija Ministarstva za zajednice i povratak definiše održiv povratak i razvoj svih zajednica, kao i dugoročni proces koji utiče na sve aspekte života, mislim na ekonomski, socijalni i institucionalni aspekt.

Jedan od najvažnijih ciljeva održivog povratka je stvaranje mogućnosti zapošljavanja, kao i smanjenje socijalne nejednakosti. Cilj strategije Ministarstva za zajednice i povratak je da odredi politiku prema kojoj će se težiti ka balansiranju dva ključna elemenata: stabilizaciju zajednica i održiv povratak na Kosovu. Strategija se vodi vizijom u cilju doprinošenja razvoju multietničkog i prosperitetnog demokratskog društva sa jednakim mogućnostima.

Strategija se fokusira na tri primarna cilja, to su: stabilizacija zajednica, održiv povratak i reintegracija raseljenih lica. Što se prvog dela vašeg pitanja tiče vezano za kriterijume, za izgradnju i obnovu kuća za povratnike. Pomoć u rekonstrukciju može se pružiti raseljenim licima koji su bili vlasnici zemljišta do 1999. godine, i licima kojim opština alocira svoje zemljište. Prioriteti su raseljena lica unutar Kosova i Metohije, Republike Srbije i Crne Gore i ostalim zemljama u regionu, a koji su izrazili želju da se vrate i integrišu u mestu odakle su bili interno raseljeni.

Što se drugog vašeg pitanja tiče, a to je vezano za etničku strukturu zajednica u izgradnju kuća od strane Ministarstva za zajednice i povratak i naših partnera, u poslednje tri godine izgrađene su bile kuće za Srpsku zajednicu 599 kuća, za Rome, Aškalije, Egipćane 182 kuće, za Bošnjake 23 kuća, za Gorance 22 kuće, za Albance 14 kuća, uključujući još plus 30 kuća za Albansku zajednicu kao balans komponentu. Ne bih se složio isto sa vama da forsiramo Srpsku zajednicu, pošto smo i ostalim zajednicama pomogli dosta. Imate u naše ministarstvo ...

KRYETARI: Në pyetjen plotësuese përgjigjesh ministër.
Deputet, a ke pyetje plotësuese?

XHEVDET NEZIRAJ: Po, veç sa të rehatohet ministri.
Zoti ministër, vij nga rajoni i Pejës. Në Brestovikë, Levoshë dhe Cigë janë qindra shtëpi të ndërtuar për komunitetin serb dhe gjysma janë të boshatisura, ndërsa kohëve të fundit, kanë filluar që të shiten edhe shtëpitë, do të thotë, me parat e tatimpaguesve të Kosovës, shtëpitë kanë filluar të shiten, do të thotë, ka filluar biznesi, ndërsa në pjesën e parë, më tepër mu ke përgjigjur politikisht se sa konkretisht. Po të pyes për komunitetin egjiptian sa shtëpi, jo për romë e ashkalinj se i kanë përfaqësuesit këtu. Unë kam pyetje shumë konkrete dhe desha konkretisht të më përgjigjsh.

Prandaj, cilat janë kriteret të atyre njerëzve që i shesin shtëpitë, ndërsa njerëzit tjerë jetojnë në varfëri të skajshme?

KRYETARI: Ministër, tash mund të përgjigjesh.

MINISTAR TOMIQ RADOIJA: Ministarstvo za zajednice i povratak se bori protiv ovakvih pojava. Apsolutno se slažem sa vama da postoje ovakve pojave. To nije krivica Ministarstva za zajednice i povratak, kriterijumi su određivani jasno i preko međunarodne zajednice UNCHR-a, kako i preko Evropske komisije. Ima takvih pojava gde su kuće izgrađene, gde niko u tim kućama ne živi. Politika Ministarstva po onim stvarima do sada što nije urađeno dobro, mi ćemo pokušati da se to ispravi. Kriterijumi da budu malo strožiji, kako bi u tim kućama povratnici stvarno došli da žive. Moja misija nije da uradim 100 kuća, moja je misija je da vratim 100 porodica. Ja se zaista trudim da to radim kako treba. Što se izgradnje za konkretno vašu zajednicu tiče, svi zahtevi koji su došli na adresu našeg Ministarstva, u toku je proces i verujem da će biti shodno budžetu koji imamo, sve etničke zajednice biti zadovoljne. Hvala vam još jednom!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Tjera herë ke kujdes emrin zyrtar të shtetit dhe korrigjoj ata që t'i bëjnë tekstet.

Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë me çështjen e rritjes së pagave. Pra, siç e dimë të gjithë, më datën 6 janar të vitit 2011, Qeveria e atëhershme në largim kishte marrë vendim që pagat e punonjësve në sektorin publik do të rriten për 50, 40 dhe 30%, respektivisht për kategori të caktuar.

Pagat e janarit dhe shkurtit të këtij viti nga e njëjta Qeveri u konsideruan, sipas fjalëve të ministrit të Financave, të shprehura më 1 shkurtë si paradhënie dhe se pagat me rritje punëtorët e sektorit publik do t'i marrin nga momenti i miratimit të buxhetit, ndërkohë që dallimi për janar dhe shkurt u premtua atëherë do t'u paguhet retroaktivisht.

Ditë më parë i njëjti ministër i Financave, pra zoti Bedri Hamza, nuk iu përgjigj pyetjes së gazetarëve nëse do të ketë pagesë retroaktive të rritjes për janar dhe shkurt siç ishte premtuar dhe e mohoi madje të ketë pasur premtim për një gjë të tillë. Pra e mohoi atë që e kishte thënë vetë me 1 shkurt. Pyetja ime është kështu: A do të qëndrojë Qeveria prapa vendimit dhe premtimeve të veta të dhëna më herët, pra a do të ketë pagesë retroaktive të rritjes së pagave për janar dhe për shkurt?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Ymeri, faleminderit shumë për pyetjen!

Fillimisht kur është premtuar rritja e pagave është shpenzuar shumë energji që ky premtim të tregohet i papërmbyshur dhe i paralizueshëm. Në momentin kur ky premtim u shndërrua në vendim në mbledhjen e Qeverisë të 6 janarit, kur këto vendime janë më shumë se sa premtime, ku nuk ka pasur memorandum me punëtorët shëndetësorë për rritjen e pagave, ndërsa pagat janë rritur për 30%, ku memorandum i Shërbimit Policor të Kosovës ka qenë i dizajnuar që të rriten pagat 20 plus 20, ndërsa vendimi është 40%, ku vendimi i qeverisë thotë se do të rriten pagat e gjithë punëtorëve të arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm 50%, në pagën bazë, ku ata që shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk kanë qenë pjesë e premtimeve dhe memorandumëve, ndërsa realizojnë rritjen e pagave, këto vendime të paktën kam pritur që ndoshta të përkrahen në mënyrë të heshtur, mirëpo u sulmuan në të gjitha mënyrat e mundshme. Pas aprovimit të vendimeve dhe shndërrimit të premtimeve në dokumente zyrtare është tentuar dhe u shpenzua shumë energji tregohen se këto vendime nuk do të jenë e mundshme që të jenë pjesë e buxhetit të Kosovës të vitit 2011.

Buxheti i Kosovës është vonuar për shkaqe të njohura, për shkak të zgjedhjeve dhe është aprovua në fund të marsit të vitit 2011. Rritjet u bënë pjesë e këtij buxheti, Ministria e Financave e ka propozuar buxhetin në Qeveri, me rritjen e pagave për vitin 2011. Buxheti është aprovuar në Qeveri dhe është proceduar në Kuvend.

E di që nuk ka qenë një dokument prefekt, e di që e kanë përcjell defekte të caktuara, mirëpo si rezultat i ngritjes së pagave kam pritur nga ju që ta përkrahni këtë buxhet, që ta votoni ngritjen e pagave. Ju keni votuar kundër, ju keni votuar kundër ngritjes së pagave.

Me rastin e aprovimit të buxhetit, pagat janë realizuar me rritje, dhe punëtorët i kanë marrë pagat me rritje. Ne e kemi respektuar rritjen e pagave dhe ne e kemi respektuar edhe ligjin, sepse Ligji i buxhetit është aprovuar në fund të muajit mars.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?
Urdhëro, Visar!

VISAR YMERI: Faleminderit!
Së pari, pyetja mendoj që ishte shumë konkrete e përgjigja e ministrit ishte një përgjigje kështu ose vizë politike të kësaj Qeverie. Unë konsideroj që ministri është aq inteligjent sa ta kuptojë që kundërshtimi jonë ndaj buxhetit ka qenë kundërshtim ndaj privatizimit të Postës, mënyrës së kontrabanduar privatizimit të Postës e jo ndaj rritjes së pagave. Këtë e kemi thënë edhe disa herë, po me gjasë që s'po mund ta kuptoni, e ish dashur për t'ia kryer edhe një kurs ndoshta në Bansko për t' i kuptuar këto gjëra. Pyeta edhe një herë është kështu. Ju keni premtuar që retroaktivisht do t' ju paguhen rritjet e pagave, vetë me gojën tënde ke thënë më 1 shkurt, domethënë ke thanë që po të parafrazoj tash, ke thënë që pagat për janar dhe shkurt do t' ua paguajmë punëtorëve të sektorit publik për shkak se e dimë që ata kanë vështirësi edhe nevoja financiare dhe kanë kredi për të paguar, mirëpo këto duhet kuptohen si paradhënie, kështu u ke thënë gazetarëve në konferencë për shtyp, ndërkohë që dallimi me rritje do të paguhet retroaktivisht me miratimin e buxhetit. Tash e ke ndryshuar këtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, ke përgjigje shtesë!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti Ymeri!
Besoj që kjo tabelë më së miri flet për ecurinë e pagave në Kosovë. Nëse e krahasojmë pagën në vitin 2007, të një arsimtari është 235 euro, ndërsa tani është rreth 400 euro. Paga e një motre medicinale apo një tekniku medicinal ka qenë 140 euro tash është rreth 300 euro, dhe kështu me radhë. Ne jemi tani në biseda me Fondin Monetar Ndërkombëtar, besoj që suksesshëm do të përfundohen këto biseda edhe në dobi të Kosovës, edhe në dobi të qytetarëve të Kosovës edhe në dobi të atyre që realizojnë paga përmes buxhetit të Kosovës. Nganjëherë më së miri flet grafiku më shumë se shumë fjalë, ky është një grafik që prezanton rritjen e pagave duke filluar prej vitit 2004. Unë kisha uruar edhe kisha dëshiruar që kjo rritje kaq e fuqishme e pagave që nuk ka ndodhur asnjëherë nga paslufta e deri tash, të mos jetë rekord i rritjes së pagave në Kosovë edhe për periudhat e ardhshme. Dhe, krejt në fund dhe besoj brenda kësaj, zoti Ymeri e gjeni

përgjigjen, Ministria e Financave është përgjegjëse për ekzekutimin e listës së pagave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.
Deputet, e ke fjalën!

LIBURN ALIU: Më datën 12 maj të vitit 2011, në protestën e organizuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” me rastin e vizitës së përfaqësuesit të Qeverisë së Serbisë në Prishtinë, aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” janë keqtrajtuar jo vetëm nga policia, por edhe nga punonjësit civilë të Ministrisë suaj, ku më i shquari ka qenë Kushtrim Haliti. Kushtrim Haliti, pra është punëtor civil, e kemi denoncuar përmes mediave, janë parë edhe pamjet në televizion. Mendoj që ka mjaftë dëshmi për krimin e tij ndaj aktivistit të lëvizjes “Vetëvendosje”, i cili ka qenë i lidhur nga Policia. Mendoj që ky është një skandal që do të duhej të trajtohej dhe prandaj pyetja është se çfarë masash ka ndërmarrë Policia e Kosovës ndaj personit Kushtrim Haliti, për ta ndjekur për veprën penale të sulmit fizik ndaj qytetarëve të Kosovës, por edhe çfarë masash keni ndërmarrë ju në cilësinë e punëdhënësit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Aliu,

Më lejoni të bëjë të qartë se në formulimin e pyetjes suaj është bërë një gabim në drejtim të adresimit të pyetjes, unë konsideroj si lëshim të qëllimshëm pasi që ky ka qenë një veprim spontan dhe izoluar i një zyrtari të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si i tillë rasti mbetet i izoluar.

Ministria e Punëve të Brendshme si institucion të cilit i përket zyrtari në fjalë, i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në drejtim të procedurës disiplinore të paraparë me Ligjin për shërbyesit civilë në Republikën e Kosovës. Zyrtari tanimë është i nënshtruar procedura të Komisionit disiplinor, bazuar në legjislacionin në fuqi. Zyra e sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si organ kompetent ka iniciuar procedurën e nevojshme disiplinore, rasti është në trajtim e sipër.

Njësia e Hetimeve Rajonale në Prishtinë, në konsultim me prokurorin e Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë, menjëherë ka filluar hetimet. Unë kam kërkuar nga Policia e Kosovës që të bëjë një hetim të detajuar lidhur me incidente të ditës kur është mbajtur protesta e lëvizjes “Vetëvendosje”. Policia e Kosovës duke u bazuar në xhirimet e siguruara, intervistimet e dëshmitarëve do të procedojë me kallëzime penale për të gjithë pjesëmarrësit do të kualifikohen si iniciues apo pjesëmarrës në ushtrimin e dhunës gjatë protestës.

Policia e Kosovës në koordinim me Prokurorinë Publike dhe mandatin e saj do t'i ndërmarrë të gjitha masat ligjore ndaj të gjitha atyre personave që kanë qenë shkaktarë të dhunës gjatë protestës, duke mos përjashtuar as pjesëtarët e lëvizjes "Vetëvendosje". Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?
Regjia fjalën deputetit.

LIBURN ALIU: Na intereson sa do të ketë afat për këtë punë, me qenë se dëshmitë kanë qenë jashtëzakonisht të qarta, kanë qenë incizimet dhe shihet qartë, ai person është person civil dhe punonjës në Ministri dhe keqtrajtimin e aktivistit e ka bërë në prezencën e policisë, me lejen e policëve. Prandaj, nuk mund të quhet i rast i izoluar, por mua po më intereson sidoqoftë se këtë punë po ia lemë tash hetimit, faktet janë, është parë në televizion shumë qartë ajo punë, është identifikuar edhe personi- A ka afate për këtë punë, apo ne do të presim me muaj, sepse duke pasur parasysh që faktet janë të qarta, arrestimi do të duhej të ndodhte menjëherë, sidomos për faktin që i ka indinjuar të gjithë, pamjet e tilla që i kemi parë në media.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Sa për njoftim unë nuk jam punëdhënës i drejtpërdrejtë, shërbyesit civil shkojnë nëpër procedura të konkursit dhe për ta merren masa konform Ligjit për shërbim civil dhe sa do të zgjatë është punë e tyre. Unë nuk interferoj me këto gjëra dhe hetuesia e bën punën e vet, po ashtu nuk ndërhy në punët e hetuesisë.

Por, dua të them se ata e bëjnë punën në bazë të incizimeve, për të gjithë ata që kanë shkaktuar dhunë, dhe dua edhe publikisht edhe një herë t'ju kërkoj edhe nga "Vetëvendosja" që të gjithë kur bëjnë protesta ose demonstrata, duhet t'i nënshtrohen Ligjit për tubime publike, në mënyrë të rregullt të marrin lejen ose nëse u refuzohet ose ju caktohet vendi dhe në të ardhmen janë rregulla të sakta qysh do të prevenohet, pengimi i lëvizjes së lirë, dëmtimi i pronës, rrezikshmëria e individëve, prandaj, ajo do të vlejë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputeti Agim Kuleta, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Nuk do ta bësh pyetjen. Faleminderit!
Deputeti, Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri s'është këtu a do ta bësh pyetje Afrim?

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!
Dhe pres përgjigje me gojë nga ministri kur do të vijë në seancën e radhës.
Në bazë të Ligjit të punës në Kosovë orari i plotë i punës zgjat 40 orë në javë. Në nenin 23, paragrafi 1 i Ligjit të punës thotë se në rastet e jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punës dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori

duhet të punojë më gjatë se orari i punës, puna jashtë orarit për më së shumti deri në 8 orë në javë. E në anën tjetër një punëtor krahu në firmën Behctel& Enka punon minimum 10 orë në ditë , apo 70 orë në javë dhe paguhet vetëm rreth 70 centë për orë dhe ka pushim një herë në dy javë ose dy ditë brenda muajit. Po ashtu punëtorët e ndërmarrjes “Viteks” SHPK i kanë refuzuar para dy javësh kontratat e ofruara nga punëdhënësi për shkak të pakënaqësisë së tyre me orarin e punës dhe po ashtu me mos pagesën e punës gjatë ditëve të festës. Pyetja ime është kështu: -Kush e mbikëqyr zbatimin e ligjit 03/L-212 të punës dhe çfarë masash sanksionuese keni ndërmarrë me rastet e identifikuara të shkeljes së tij”? Faleminderit! Pra edhe një herë pres përgjigje me gojë.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Danush Ademi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq, ministri s’është. Regjia, fjalën deputetit Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse nuk është ministri besoj që do t’ju hyjnë në punë edhe zëvendëskryeministrit edhe ministrave të tjerë. Do t’ju njoftoj që me datën 20.5.2011, në ndërtesën kolektive në Kampin e Plemetinit, komuna e Obiliqit 38 familje të komunitetit ashkalinj, romë dhe egjiptas kanë lëshuar ndërtesën për shkaqet e sigurisë, pasi që ndërtesa nuk i plotëson kushtet për banim dhe është afër rrënimit. Por deri më tani askush nga organet komunale dhe qeveritare nuk u ka bërë asnjë vizitë këtyre familjeve dhe nuk është marrë asnjë hap për të ju dalë në ndihmë. Këto 38 familje aktualisht jetojnë në qiellin e hapur në tenda të najlonit, andaj, me qenë se s’është ministri ju drejtohem ministrave, a keni ndërmarrë ndonjë hap konkret për këto 38 familje t’i strehoni diku apo t’u siguron kulm mbi kokë apo t’i leni në mëshirën e Zotit dhe në qiellin e hapur, njerëz të sëmur, fëmijë të vegjël dhe njerëz të varfër?

Po më lejoni që të shpreh edhe një herë brengën time për rastin në fjalë pasi që ky rast nuk është përcjell as nga mediat dhe unë shpreh keqardhjen që ashkalinjtë si komunitet po diskriminohen në përfaqësim medial.

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 të Rregullores së Kuvendit.

Në sallë janë 62 deputetë, kështu që mund të vazhdojmë punën.

Pika e tretë:

3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 12 dhe 19 maj 2011

Pyes, a keni vërejtje në këto procesverbale?

Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 12 dhe 19 maj 2011.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Në vend të zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuqi, në emër të Qeverisë fjalën e ka ministri Mahir Yagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Drejtësisë, t'ia paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim Projektligjin për ndihmë juridike falas, i cili del si rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj, pasi që legjislacioni aktual që e rregullon këtë fushë nuk e mbulon në nivel të duhur dhe ka zbrazëtira të shumta ligjore.

Ky projektligj ka për synim parësor forcimin e një baze ligjore me qëllim të krijojë një sistem funksional për ndihmë juridike falas në çështjet civile, administrative dhe penale me anë të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Me këtë projektligj bëhet sistematizimi më i mirë dhe më i qartë i materies që e mbulon duke e përcaktuar dhe rregulluar më qartë: kuptimin, llojet, shtrirjen, shfrytëzuesit dhe ofruesit e ndihmës juridike falas, kompetencat, procedurat dhe kushtet për realizimin e ndihmës juridike falas dhe financimi i ndihmës juridike falas.

Me këtë projektligj themelohet Këshilli për ndihmë juridike falas, si institucion themelor i cili kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet e tjera publike dhe pa udhëzime dhe ndërhyrje nga asnjë person, si dhe ushtron mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Agjencisë për ndihmë juridike falas. Projektligji themelon edhe Agjencinë për ndihmë juridike falas, si institucion i pavarur publik, i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë ligj. Ky Projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë dhe në bashkëpunim me ekspertët e shquar të brendshëm dhe ndërkombëtarë me qëllim të krijimit të një sistemi të pavarur dhe funksional, duke synuar sigurimin e një sistemi të integruar profesional dhe të paanshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sigurimin e qasjes efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare dhe garantimin që sistemi i drejtësisë në Kosovë të jetë në zbatim të përpiktë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e saj.

Me përfshirjen e këtij Projektligji në sistemin juridik të Kosovës do të arrihen qëllime të shumta, ndër ta më të rëndësishëm janë: krijimi i një sistemi funksional për ndihmë

juridike falas për çështjet penale , civile dhe administrative, me anë të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Për më tepër, ky Projektligji zëvendëson dhe shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/36.

Të nderuar deputetë,

Jam i bindur se miratimi i këtij Ligji në Kuvendin e Republikës së Kosovës është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe të avancimit të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut.

Ju faleminderit!

KRYTARI: ju faleminderit, ministër!

Kryetari i Komisionit nuk është këtu. Atëherë, shkojmë sipas grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

KRYTARI: Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Në emër të komisionit, kryetar!

Në emër të Komisionit për Legjislacion. Në emër të Grupit parlamentar, profesor Arsimi flet.

KRYETARI: Mirë, atëherë në emër të Komisionit, deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores të Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 23 maj 2011, e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndihmë juridike falas dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R A P O R T

Komisioni për Legjislacion, në cilësi të komisionit funksional raportues, i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, në pajtim me nenin 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 23 maj, e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndihmë juridike, vlerësoi se Projektligji në aspektin përmbajtësor i plotëson kushtet e përcaktuara me rregullat e hartimit të legjislacionit, po ashtu edhe kushtet e caktuara me Rregulloren e Kuvendit, për t'u proceduar për shqyrtim dhe miratim, në parim. Prandaj, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë rekomandimin që të shqyrtohet dhe të miratohet në parim Projektligji për ndihmë juridike. Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Arsim Bajrami, e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë Projektligj dhe i jep përkrahje parimore, duke e vlerësuar si një ligj të domosdoshëm për faktin që Kosova është një shtet social dhe përkon edhe me politikat sociale.

Ligji, në fakt, krijon bazën legale, bazën juridike për ofrimin e ndihmës falas për kategoritë sociale dhe mendoj se është edhe në pajtim me qasjen ndaj të drejtave të njeriut. Ofrimi i ndihmës juridike falas është shumë dimensional. Këtu paraqiten kryesisht katër fusha: fusha civile penale; fusha administrative dhe kundërvajtëse dhe mendojmë se ndihma juridike falas duhet të ofrohet edhe në fushat tjera jo vetëm në procedurat gjyqësore, por edhe jashtë procedurave gjyqësore, në mënyrë që kategoritë e caktuara të qytetarëve që gjendje të vështirë materiale, sidomos ata që janë të përfshirë me skema sociale të kenë mundësi, të kenë qasje në drejtësi. Përgjithësisht, Ligji është hartuar mirë, por Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike shtron tri çështje për diskutim me rastin leximit të dytë dhe mendojë që në leximin e dytë komisioni funksional, Komisioni i ligjeve duhet të ndalet në disa segmente: e para, Ligji kërkon formimin e disa organeve, përpos Këshillit për ndihmën juridike falas, kërkon edhe themelimin e një agjencie për ndihmën juridike falas dhe krijimin e disa zyrave rajonale për ofrimin e ndihmës falas, pra do të kemi një strukturë të re dhe ne mendojmë, në këtë drejtim duhet ta racionalizojmë këtë strukturë, në mënyrë që mos ta shtojmë aparatin shtetëror. Të shohim mundësinë se mund këtë mision ta kryejë vetëm agjencia, apo duhet të kemi edhe këshillin, edhe agjencinë, edhe zyrat rajonale dhe kjo është çështje që duhet të diskutohet.

Çështja e dytë, është kualiteti i ndihmës juridike falas. Duke qenë se ne i kemi në funksionim avokaturën, si një institucion i pavarur, duhet të bëhet përpjekje që kjo ndihmë juridike, jo vetëm të jetë falas, por të jetë edhe kualitative, mos të jetë vetëm një deklaram apo gatishmëri e shtetit për të mbrojtur kategoritë sociale, por të jetë një institucion që vërtet ofron edhe ndihmë falas, edhe ndihmë kualitative, sepse na kujtohet në të kaluarën, ne kemi pasur Institucionin e Avokatit Publik, Avokatit Publik të Kosovës dhe avokatëve publikë të komunave. Ky organ shpeshherë nuk ka pasur edhe fare punë, tani të kemi kujdes që kjo ndihmë juridike falas të jetë kualitative, të jetë e mbështetur nga buxheti i shtetit, nga buxheti i komunave, në mënyrë që të jetë konkurrenente me sektorin privat, duke qenë se sektori privat është mjaft tërheqës dhe mjaft komercial, duhet të shtohet cilësia e ndihmës juridike falas.

Dhe çështja e tretë, na duhet krahas këtij ligji të zhvillojmë edhe një informim të qytetarëve, që qytetarët të informohen se atyre brenda zyrave rajonale apo brenda Agjencisë u ofrohet kjo ndihmë juridike dhe në implementim të këtij ligji na duhet edhe një fushatë informuese, në mënyrë që kategoritë e caktuara të qytetarëve, sidomos kategoritë e varura të informohen se ekziston ky institucion dhe ata përmes këtij institucioni mund të kenë qasje në drejtësi.

Marrë në përgjithësi, mendojmë se Ligji është një bazë e mirë dhe me rastin e leximit të dytë, ai mund të plotësohet dhe të ndryshohet dhe ne propozojmë miratimin e këtij ligji, në parim.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës, ish kolegë,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes dhe vëmendje Projektligjin për ndihmë juridike falas dhe në parim e përkrah procedimin dhe aprovimin e tij. Mirëpo, në të njëjtën kohë propozon që të bëhen disa ndryshime konkrete, respektivisht të evitohen disa lëshime të cilat aktualisht i përmban ky draftligj.

Më konkretisht, në nenin 7 të këtij drafti, në të cilin përcaktohen llojet e ndihmës juridike falas, ndër të tjera përendet ndihma primare dhe ndihma sekondare. Mirëpo, në paragrafin e dytë të këtij neni, do të thotë te nenit 7, si ndihmë primare përcaktohen disa shërbime juridike të cilat i numëron taksativisht prej nënparagrafit 2.1 deri në nënparagrafin 2.6. Ndërsa, një paragraf më poshtë, respektivisht në paragrafin e tretë, përcaktohet si ndihmë juridike sekondare se janë, citoj: “shërbimet të cilat janë paraparë në nënparagrafin 2.2 dhe 2.3 të paragrafit 2”.

Nga një rregullim i tillë i kësaj çështjeje, nuk është krejtësisht e qartë se çka konsiderohet ndihmë juridike primare dhe çka konsiderohet ndihmë juridike sekondare.

Duhet theksuar se ky përkufizim i ndihmës juridike primare dhe ndihmë juridike sekondare nuk është një përkufizim thjeshtë formal, por në esencë është përkufizim përmbajtësor, gjë që shihet me nenin 10, ku në paragrafin 2, përcaktohet se ndihmë juridike primare ju ofrohet apo mund të marrin personat që marrin ndihmë sociale, kurse ndihmën sekondare mund të marrin personat të cilët kanë të ardhura më të vogla se sa të ardhurat mesatare familjare.

Andaj, kërkoj që në të ardhmen, në fazën tjetër të shikimit të këtij draft-ligji, të qartësohet saktë se çka është ndihmë primare e çka është ndihmë sekondare juridike falas.

Më pastaj, në nenin 10 të paragrafit 3, përcaktohet kriteri për fitimin e ndihmës sekondare, e ai sipas këtij draft-ligji, citoj, është: “të ardhurat mesatare familjare”. Përcaktimi në këtë mënyrë i këtij kriteri është mjaft i përgjithësuar, andaj jam i mendimit se me këtë ligj duhet të qartësohet, respektivisht të saktësohet më mirë ky kriter, në mënyrë që t’i lehtësohet zbatuesit të ligjit në të ardhshmen, që më lehtë të vlerësojë kriterin e këtillë në praktikë.

Sugjerimi tjetër i yni është i lidhur me nenin 8, respektivisht nenin 11 të këtij draftligji. Kështu, sipas nenit 8, ndihma juridike falas ju ofrohet të gjithë personave që i plotësojnë këto tri kriterë: kriterin kualifikues, kriterin financiar dhe kriterin juridik. Sipas kësaj dispozite, nënkuptohet që një person duhet t'i plotësojë në mënyrë kumulative të tri këto kriterë për të fituar ndihmën juridike falas. Por, kur analizohet neni 11, respektivisht kriteri juridik, atëherë shihet se është vështirë që qytetari të fitojë ndihmë juridike falas, sepse këto kriterë janë më shumë të karakterit hipotetik, se sa të atij faktik. Kështu, për shembull, si kriter, citoj, theksohet: “Mundësia e suksesit të kërkesës” apo si kriter theksohet: “fuqia argumentuese e provave”. Vetvetiu shtrohet pyetja: sa është reale që dikujt t'i ofrohet ndihma juridike në bazë të mundësisë të suksesit të kërkesës në fillim të procedurës, kur është e ditur se asnjë person nuk fillon ndonjë procedurë pa qenë i bindur se kërkesa e tij do të fitojë në procedurë.

Një çështje tjetër është më shumë e karakterit teknik, në paragrafin 4 të nenit 13, ekziston një lëshim i tillë. Kështu, përmendet nënparagrafi 2.1 deri në 2.6 të paragrafi 2, e në të vërtetë duhet të jenë nënparagrafët 3.1 deri 3.6 të paragrafit të 3-të.

Një çështje tjetër është në nenin 16, ku përcaktohen kushtet për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, ndërsa nënparagrafi i pestë i këtij neni përcakton se si kusht i posaçëm është që: “kandidati mos të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale”, gjë që nënkupton se si anëtar i Këshillit mund të zgjidhet personi i cili ka qenë i dënuar apo është i dënuar me vendim të Gjykatës së shkallës së parë. Duke pasur parasysh se ky komision është një komision tejet i rëndësishëm, mendoj që duhet të bëhet një riformulim i këtij kushti dhe të theksohet “që kandidati mos të jetë nën hetim për ndonjë vepër penale që ndiqet eks officio”. E njëjta vërejtje duhet inkorporuar edhe në nenin 19, nënparagrafi 1.2 dhe në nenin 23, nënparagrafi 2.6.

Më tutje, në nenin 20, paragrafi 3, duhet të fshihet në tërësi, sepse është i panevojshëm pasi që përmbajtja e tij është konsumuar në dy paragrafët paraprake të po këtij neni. Ndërsa, në nenin 34, paragrafi 3 dhe 4, haset shprehja: “lejimi i kërkesës”, e cila duhet zëvendësuar me shprehjen “aprovimi i kërkesës”, pasi që ne e dimë se kërkesat aprovohen e nuk lejohen.

Dhe, krejtësisht në fund, në nenin 36, trajtohet çështja e ankesës kundër ofruesit të ndihmës juridike falas, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni, përcakton rastet dhe veprimet kur ankesa e palës së pakënaqur aprovohet. Mirëpo, as në këtë nen, e as në draft ligjin në tërësi, nuk trajtohen rastet kur ankesa refuzohet apo hedhet poshtë, respektivisht nuk është rregulluar fare çështja se a ka të drejtë pala e pakënaqur që të atakojë me ndonjë mjet juridik vendimin e komisionit i cili, në këtë rast, faktikisht është vendim i shkallës së parë, kurse në drejtësi, njëri prej parimeve më të rëndësishme dhe thelbësore është parimi i dy shkallshmërisë.

Dhe, krejt në fund, një vërejtje e karakterit të përgjithshëm që ka të bëjë me gabimet gramatikore-gjuhësore të draft-ligjit, për çka rekomandoj një korrektim, respektivisht një lekturë nga ndonjë lektor profesional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit!

Projektligji për ndihmën juridike falas e plotëson zbrazëtirën juridike që ka ekzistuar në Kosovë, sepse deri më tani ndihma juridike falas është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut.

Sa i përket këtij projektligji, përveç vërejtjeve që i tha parafolësi, ne konsiderojmë që duhet të bëhet përpjekje që të përmirësohet kualiteti i ndihmës juridike falas dhe të mos jetë se si ka qenë deri më tani dhe se duhet më mirë të specifikohet ndihma juridike në rastet penale, sepse mbrojtja në rastet penale garantohej edhe me dispozitat e legjislacionit penal, pra të mos të vijë deri te konfuzioni në mes tyre. Pra, në parim ne do të votojmë në favor të këtij projektligji, pasi që konsiderojmë që ky projektligj pasuron kornizën ligjore në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën kush e donë? Kimete, nuk të ka dal emri këtu.

KYMETE BAJRAKTARI: I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht, Projektligji për ndihmë juridike falas është një akt ligjor më i avancuar në krahasim me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/36 mbi ndihmën juridike, ku ka qenë e rregulluar kjo çështje më parë, duke parë strukturën dhe dispozitat e qarta për dallim nga Rregullorja që kishte mjaft paqartësi, gjëra të tepërta dhe konfuze.

Megjithatë, në këtë projektligj është e nevojshme të bëhen sqarime dhe rekomandime të cilat janë të nevojshme të inkorporohen në ligj. Parimisht, projektligji përmbush kriteret formale, përkatësisht pritjet e atyre që u dedikohet, ofruesve dhe kërkuesve të ndihmës juridike falas në Kosovë, si në aspektin struktural të themelimit të Këshillit dhe Agjencionit, ashtu edhe në aspektin e spektrit të ndihmës juridike që parashihet të ofrohet.

Projektligji konstituon Këshillin dhe Agjencionin për ndihmë juridike falas, si organe të pavarura publike, çka mendoj se është kontradiktore, nga se në kuadër të funksionimit të ndihmës juridike falas, si shërbim, efikasiteti i këtyre organeve do të duhej të rregullohej në atë mënyrë që Agjencioni t'i koordinojë punët me Këshillin, si organ më i lartë, sepse në të kundërtën të dy këto organe do të jenë në kolizion. Sa i përket pavarësisë së organeve të pavarura juridike, pa një strukturë hierarkike dhe atë administrative, propozoj ndryshimin e nenit 21, alineja 2, ku në vend që Agjencioni të quhet Institut i Pavarur Publik, ky agjencion të quhet Institut Profesional Publik.

Edhe pse ky projektligj ka kaluar në procedurat për pajtueshmëri me dispozitat e legjislacionit të BE-së, nga Ministria e Integritimit Evropian dhe në harmoni me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, mendoj se sa i përket kriterëve të përcaktuara në projektligj, për përfituesit e ndihmës juridike falas, duhet të shtohet edhe një kriter shtesë. Përveç atij kualifikues, financiar dhe juridik që janë të paraparë me ligj, duhet të shtohet edhe kriteri i cënueshmërisë, ku do të përfshiheshin kërkuesit e ndihmës juridike, siç janë viktimat e dhunës, e që mund të jenë të llojeve të ndryshme, e që në këtë Projektligj është përmendur sipërfaqësisht në nenin 33, alineja 4, personat e cënuar nga trafikimi, të moshuarit pa mbikëqyrje, personat me aftësi të kufizuara, të pastrehët, gratë e pambrojtura, të ekspozuara dhunës në familje e tjera. Kjo do të plotësonte kriteret e parapara në këtë projektligj, ngase kriteri juridik është konfuz dhe i paqartë.

Në dispozitat kalimtare të projektligjit të precizohet edhe bartja e kompetencave dhe e buxhetit për çështje të ndihmës juridike falas në lëmin penale, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë tek Agjencioni i ndihmës juridike falas. Në këto rrethana, kostoja financiare me rastin e implementimit të këtij ligji, pas miratimit do të ishin lehtësisht të përballueshme.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do ta votojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Amir Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, ne e përshëndesim Projektligjin për ndihmën juridike falas, duke pasur parasysh se një komision i tillë për ndihmë juridike ka ekzistuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/36 dhe rregullimi i kësaj fushë veprimtarie me ligj nënkupton fuqizimin e kësaj norme ose të ndihmës juridike falas, duke u themeluar Këshilli dhe Agjencia për këtë çështje.

Meqenëse shumë prej kolegëve i përmendën disa prej sugjerimeve të tyre, edhe ne do të japim një kontribut, por duke mos i përsëritur ato. E para, duke u bazuar në nenin 30, më falni nenin 33, për iniciimin e procedurës, ku flitet përse procedura për realizimin e ndihmës juridike falas, iniciohet me paraqitjen e kërkesës në zyrën më të aftët për ndihmë juridike. Duke pasur parasysh këtë dhe mos informimin e qytetarëve të Kosovës, konsiderojmë se Ministria e Drejtësisë është mirë që të bëjë një fushatë promovuese senzibilizuese për qytetarët e Kosovës se ekziston një organ i tillë për ndihmë juridike falas si dhe të tregohen vendet se ku ata do t'ju drejtohen për t'ju ofruar këtë ndihmë juridike falas, e cila do të jetë e mirëseardhur për shumë qytetarë të Kosovës të cilët nuk kanë mundësi që të kenë avokat personal.

E dyta, te neni 11, kriteri juridik, ne konsiderojmë se neni 33, 34 dhe 35 tregon për procedurën, vendimin e lejimit apo aprovimin, si dhe të refuzimit të ndihmës juridike.

Në këtë rast ne konsiderojmë se në nenin 11, tri pikat e kritereve për ndihmë juridike, ju mungon një kornizë orientuese për komisionin se si do ta japin apo do ta aprovojnë këtë ndihmë juridike.

Neni 11, pika 1.2 thotë: “ fuqia komentuese e provave të prezantuara nga kërkuesi, të jetë kriter”. Ne konsiderojmë se këtu mungon korniza orientuese për komisionin se cili do të jetë kriteri i fuqisë argumentuese për t’ia lejuar apo aprovuar ndihmën juridike dhe 1.3, mundësia e suksesit të kërkesës, prapë edhe këtu mungon një kornizë orientuese, sepse kush janë ata ose në çfarë baze do të konsiderojnë të suksesshme apo të pasuksesshme mundësinë e kërkesës.

Po ashtu, te neni 20 kemi edhe një vërejtje, ku flitet për pagesën e anëtarëve të Këshillit drejtues, të Këshillit për ndihmë juridike falas. Në këtë rast konsiderojmë se dispozitat e brendshme të Kuvendit të ndryshohen për hir të pagesës të anëtarëve të Këshillit nga dispozitat e brendshme të Kuvendit për shkak të kualitetit të ndihmës juridike, e cila mund të kontestohet në këtë rast. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputetja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem! Sa aspekta sadržajnog i formalnog ispunjavanja uslova, ovaj Nacrt zakona a ispunjava sve te uslove. Ne želimo da ponavljamo sve ono što su moje kolege istakle, želimo samo da kažemo da je namera, opšta namera ovim zakonom je da se vršenje usluge o pružanju besplatne pravne pomoći podigne na jedan viši nivo, te s toga Parlamentarna grupa SLS će podržati Nacrt ovog zakona. Hvala.

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsjedavajući,

Poštovani poslanici,

Nacrt zakona za besplatnu pravni pomoć je neophodno potreban. Ovaj Nacrt zakona predviđa novu jasnu sistematizaciju materije u koju pokriva nova rešenja i stvara bolju zakonsku strukturu.

Ovaj zakon ima za cilj stvaranje sistema i pružanje besplatne pravne pomoći u građanskom upravnom i krivičnom postupku, kojim se obezbeđuje bolji pristup pravdi i za građane koji nemaju dovoljno finansijska sredstva, s toga, Parlamentarna grupa „6+“ podržava u načelu ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Konsideroj se grupet parlamentare janë deklaruar. Tani sipas paraqitjes, deputetët, është paraqitur deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Meqenëse shumica e vërejtjeve sa i përket mbajtjes të projektligjit, u përmendem, nuk do të ndalem te ato, mirëpo dua ta shpreh një shqetësim që më erdhi keq që nuk e përmendi asnjë nga grupet parlamentare, kjo ka të bëjë me ndikimin buxhetor të këtij ligji. Kostoja e zbatimit të këtij ligji nuk është paraparë në koston afatmesme të shpenzimeve 2011-2013, e as në buxhetin e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, prandaj edhe në deklaratën financiare të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa kjo Ministri rekomandon që mos të miratohet ky projektligj, pra nuk është pajtuar me formën e tanishme të Projektligjit. Në deklaratën financiare janë identifikuar një numër paqartësish dhe rreziqesh fiskale, prandaj ky ligj është vlerësuar me ndikime të larta dhe negative, siç thashë, të cilat nuk janë përfshirë në buxhetin e Kosovës.

Ne po e shohim që në një anë Ministria e Drejtësisë e përkrah këtë ligj, ndërkah ajo e Financave është kundër miratimit të këtij ligji. Kjo edhe një herë tregon për mungesën e koordinimit mes dikastereve të Qeverisë, por mbi të gjitha për planifikimin e keq buxhetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjë që e kemi përmendur shumica e grupeve parlamentare edhe me rastin e miratimit të buxhetit, mirëpo është tejet shqetësuese që një ligj kaq me rëndësi, siç është ky që ofron ndihmë juridike falas qytetarëve të Republikës së Kosovës, të mos ketë mbulim buxhetor, prandaj i bëjë thirrje Qeverisë që vërtetë t'i gjejë mjetet për zbatimin këtij ligji, që mos të mbetet edhe një nga ligjet e shumta në sirtarët tona dhe qytetarët të mos kenë mundësi që t'i zbatojnë të drejtat që ju takojnë me këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju, faleminderit!

Shpresoj se me amendamentimin e ligjit, edhe kjo çështje duhet të rregullohet. Jam dakord me atë. Nuk ka të tjerë të paraqitur. Në emër të Qeverisë nuk ka të paraqitur për ligjin, atëherë vazhdojmë deklarinimin me votim për miratimin, në parim, të Projektligjit për ndihmë juridike.

Në sallë janë 73 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani:

Konstatoj që me 73 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndihmë juridike falas. Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandim, për shqyrtim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, ministrin e ngarkuar, zotin Mahir Yagcilar, që ta arsyetojë Projektligjin.

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, i nderuari nenkryetar i Parlamentit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t'ia paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës, për miratim, Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili del si rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj.

Në fillim, dua të theksoj se dispozitat e këtij Projektligji janë në harmoni të plotë me dispozitat e Acquis-communitaire të Bashkimit Evropian. Ky Projektligj ka për qëllim krijimin dhe forcimin e një baze ligjore që do të mundësojë krijimin e mekanizmave ligjore për sigurimin e masave të posaçme, të përkohshme dhe të jashtëzakonshme, mënyrën dhe procedurat e mbrojtjes të dëshmitarëve, si dhe organizimin, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, vlerësimin, miratimin, zgjatjen dhe zbatimin e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Në këtë projektligj themelohet Komisioni për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili është përgjegjës për përfshirjen e personit të rrezikuar në program, për zgjatjen e qëndrimit në program, si dhe rreth përfundimit të programit. Gjithashtu, me dispozitat ligjore këtij projektligji themelohet edhe Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve, si organ i specializuar brenda Policisë së Kosovës, e cila është përgjegjëse për zbatimin e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Vlen të theksohet se dispozitat ligjore të këtij projektligji rregullojnë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare. Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertët e shquar të brendshëm dhe ndërkombëtarë, me qëllim të krijimit të një sistemi të pavarur të drejtësisë, duke synuar sigurimin e një sistemi të integruar profesional dhe të paanshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve, sigurimit të qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe garantimin që sistemi i drejtësisë në Kosovë të jetë në zbatim të përpiktë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë. Andaj, më lejoni ju, të nderuar deputetë, që të ftoj për miratimin e këtij projektligji, i cili është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe të avancimit të standardeve më të larta të drejtave të njeriut, si dhe eliminimi i një sfide që është paraparë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. Edhe një herë, ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju, faleminderit!

Tani po vazhdojmë me kryetarët ose me përfaqësuesi e partive politike. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Ju faleminderit, nenkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Shumë të nderuar deputetët,

Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, po vjen në një kohë shumë të përshtatshme për përmbylljen e legjislacionit penalo-juridik kundër krimit të organizuar.

Është kërkesë e kamotshme që të kemi Ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve, është nevojë e përditshme operationale dhe e Drejtësisë së Kosovës që ta kemi këtë Ligj. Vonesat mund të jenë për arsye se mbrojtja e dëshmitarëve ishte kompetencë e rezervuar e drejtësisë ndërkombëtare dhe Policisë ndërkombëtare. Sidoqoftë, me këtë ligj po plotësohet njëra nga kërkesat themelore të drejtësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Gjithashtu, më lejon t'ju them se po plotësohet edhe një kërkesë e Raportit të progresit që, në dy raportet e fundit vazhdon të përsëritet në kuadër të kërkesave për sundimin e ligjit.

Meqë po diskutojmë parimisht, parimisht edhe ne si Grup Parlamentar e mbështesim draftligjin dhe njëkohësisht i kemi disa vërejtje parimore. Ne mendojmë se me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve duhet të përlicijet edhe situata para penale. Nëse e shikoni ligjin, do ta shihni se programi i mbrojtjes së dëshmitarëve legjitimohet gjatë dhe pas procedurës, ndërkohë që kërkohet që të ketë legalitet edhe situata parapenale, kur janë në pyetje dëshmitarët. E dyta, mendojmë dhe kjo është prapë vërejtje parimore të cilën shpresoj që edhe deputetët të tjerë do ta artikulojnë me amendamente pastaj në procedurat e mëtutjeshme. Po, e dyta është me rëndësi edhe të qartësohet fondi financiar shumë i rëndësishëm, sidomos mbikëqyrja e fondit dhe shfrytëzimi i fondit financiar, që kërkohet të jetë një zë i veçantë dhe një mënyrë specifike e mbikëqyrjes së fondit, sepse nga mënyra e shfrytëzimit të fondit, mund të cenohet ajo që quhet fshehtësi e lartë në këto lloj punësh të cilat i nevojiten drejtësisë.

Gjithashtu, mendojmë se duhet t'i kushtohet një vëmendje më e veçantë aplikimit të këtij lloj programi. Unë mendoj që parimisht me rregullat aktuale të këtij ligji, mbrohem edhe nga të ashtuquajturit dëshmitarë përfitues, të cilët mund ta shndërrojnë dëshminë në biznes, prandaj ky ligj, në mënyrën se si është artikuluar na mbron edhe nga ata lloj dëshmitarësh të cilët janë dukuri edhe në sistemet juridiko-penale të shteteve tjera.

Prandaj, në parim, ne pajtohemi ta aprovojmë këtë draftligj, ndërkohë që inkurajojmë edhe deputetët e tjerë që në çështjet parimore të cilat i ngritëm, të paraqesin edhe amendamente të veçanta. Natyrisht, Ligji ka një kosto të lartë, por të gjithë jemi dëshmitarë që kostoja e krimit të organizuar është shumë më e lartë, prandaj ia vlen që të shpenzohet në luftimin e krimit të organizuar. Është edhe një çështje tjetër, të cilën mbase sot parimisht, kurse në fazën e rishikimit të draftit edhe konkretisht, mendoj se me ligj nuk mbrohen dëshmitarët në luftën kundër korrupsionit. Në ligj thuhet se për veprat penale, edhe për veprat penale, përveç veprave tjera, edhe për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vjet. Mirëpo, ne e kemi në Ligjin penal ryshfetin, marrjen dhe dhënien e ryshfetit, të cilat sanksionohen deri në 5 vjet, përkatësisht deri në 3 vjet ai që jep.

Ne e dimë që korrupsioni edhe nuk e ka shumë definicionin e ngjashëm me të krimit të organizuar dhe nuk nevojitet organizim i madh për një nënshkrim të një kontrate nga e cila ke përfitime shumë, e për luftën e korrupsionit të tillë nevojiten dëshmitarë. Prandaj, edhe këtu mendojmë se ka vend që dëshmitarët e luftës kundër korrupsionit duhet të mbrohen po ashtu nga këto programe dhe me këtë, përveç që sigurojmë procedurë të shëndetshme për ta luftuar korrupsionin, e përmbushim edhe një kërkesë që e ka Konventa ndërkombëtare kundër korrupsionit, e cila insiston që dëshmitarët e luftës kundër korrupsionit të kenë po ashtu mbrojtje të veçantë nga shteti.

Këto janë disa prej vërejtjeve parimore, inkurajoj miratimin e drafatligjit dhe njëkohësisht inkurajoj dhe njëkohësisht inkurajoj edhe përkushtim, sidomos juristëve, që çështjet të cilat parimisht i ngritëm, t'i paraqesim konkretisht në formë të amendamenteve. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Selimi!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Pajtohem në veçanti me këtë koment të fundit të kolegut Selimi, edhe pse nuk është çudi aspak pse Qeveria në këtë draft nuk i ka përfshirë edhe mbrojtjen e dëshmitarëve që do të dëshmonin kundër korrupsionit. Ne si Grup Parlamentar i LDK-së e kemi analizuar këtë projektligj dhe duke pasur parasysh se është një ligj i domosdoshëm dhe një nga kërkesat në procesin e integritetit evropian, në veçanti që është përmendur në Raportin e Progresit, që e përmendi edhe ministri, ne e kuptojmë rëndësinë e miratimit të tij. Natyrisht që duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky ligj në sferën e sundimit të ligjit dhe të luftimit të krimit, në veçanti të krimit të organizuar, Grupi ynë Parlamentar do ta përkrahë atë në parim me qëllim që ligji që do të miratohet, përfundimisht në Parlament të reflektojë praktikatat më të mira dhe, mbi të gjitha, të jetë më lehtë i zbatueshëm në praktikë.

Ne do t'i paraqesim vërejtjet tona edhe në komisionet funksionale, por e shohim të arsyeshme që në këtë seancë të përmenden disa prej tyre, që shpresojmë do të merren parasysh edhe përfundimisht nga ky Kuvend. Në radhë të parë, siç e përmenda edhe për Ligjin mbi ndihmën juridike, kjo nuk s'ka të bëjë me përmbajtjen e ligjit, ka të bëjë me atë si do ta implementojmë këtë ligj kur nuk ka para për ta implementuar. Njëjtë si për Ligjin për ndihmë juridike, edhe për këtë ligj nuk është paraparë asnjë cent.

Në qoftë se duam ta miratojmë edhe të mbetet në fiokat tona, është tjetër çka, mirëpo në qoftë se duam të zbatohet, atëherë Qeveria duhet të përkujdeset qysh tash që diku t'i gjejë mjetet. Unë nuk e di ku ka për t'i gjetur, unë jam e sigurt që as Qeveria nuk e di ku ka për t'i gjetur këto mjete, megjithatë inkurajojmë që të bëjmë përpjekje. Siç e keni parë, MEF-i deklaroi se më shumë është përqendruar në vlerësim të kostove administrative se sa në vlerësimin e kostove të programit për mbrojtjen e të dëshmitarëve, i cili si rregull ka koston shumë më të madhe. Besoj, e keni parë, i parasheh operacionet plastike për dëshmitarët, parasheh ndërrimin e vendbanimit të tyre, pagesën, gjetjen e punës e shumë kosto tjera. Prandaj, siç konkludon edhe Ministria për Ekonomi dhe Financa, ky

është më shumë një vlerësim konservativ, se sa real, por çka është më brengosëse, është fakti se kemi të bëjmë me një projektligj, zbatimin e të cilit kërkon mjete shtesë, që nuk janë pjesë e kornizës afatmesme të shpenzimeve deri në 2013 dhe as pjesë e buxhetit që është miratuar nga ky Kuvend, pra është një ligj i kushtueshëm dhe edhe Ministria për Ekonomi dhe Financa sugjeron trajtim dhe kujdes të veçantë në fazat e ardhshme të aprovimit, që nënkupton procedurat në këtë Kuvend.

Së dyti, është më se e qartë se Qeveria duhet të miratojë programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ky ligj është vetëm pjesë, një pjesë e vogël e këtij programi. Pa miratimin e programit konkret, i cili pastaj do t'i specifikonte edhe faktorët e nevojshëm që përmenden në deklaratën për ndikime buxhetore, ky ligj do të mbetet një dokument vështirë i zbatueshëm.

Siç e dini, Raporti i progresit i viti 2010, qartë i referohet kornizës për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe kjo nuk nënkupton vetëm kornizën ligjore, por kornizën e plotë programore që duhet të parashihet në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, që duhet të miratohet nga Qeveria e Kosovës.

Së treti, hyrja në fuqi e ligjit vetëm pas një viti, me siguri e keni parë atë të dispozitat përfundimtare, dhe fillimi i zbatimit të tij pas dy vitesh, së paku, nënkupton që do të kalojnë edhe disa vite derisa mbrojtja e dëshmitarëve do të fillojë të prodhojë efekte, që do të kenë ndikim në luftimin e krimit. Kjo po ashtu nënkupton se edhe në vitin 2012, edhe vitin 2013, së paku kjo çështje do të përmendet në Raportin e progresit, sepse kritika në Raportin e progresit nuk ka pasur të bëjmë me një dokument, me një ligj që mungon, po ka pasur të bëjë me mungesën efektive të mbrojtjes së dëshmitarëve.

E katërta, vërejtja tjetër ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e disa prej masave të parapara me këtë ligj, në veçanti zhvendosjen e dëshmitarëve, të mbrojturit jashtë territorit të Kosovës. Neni 27 parasheh se baza për këtë bashkëpunim janë marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale. Por këto marrëveshje ndërlidhen me një aprovim nga ana e komisionit, i cili po themelohet me këtë ligj. Nëse çështja e aprovimit të marrëveshjeve të tilla i lidhet komisionit, i cili nuk do të themelohet para vitit 2013, kjo do të çojë edhe në vonesa më të mëdha. Është e rëndësishme që këto marrëveshje të fillojnë të negociohen dhe miratohen menjëherë pas miratimit të këtij ligji në Kuvend, në mënyrë që kur të fillojë zbatimi i ligjit, mekanizmat implementues, duke përfshirë edhe Kornizën e bashkëpunimit ndërkombëtarë, të jenë të miratuar dhe funksional.

Kemi edhe disa vërejtje tjera, në veçanti në nenin 9.5, 11, 13, 15 dhe disa dispozita të tjera, të gjitha do të paraqiten në komisionet përkatëse.

Ne si grup parlamentar do ta mbështesim këtë ligj në parim, por i bëjmë thirrje Qeverisë edhe një herë që të sigurojë mjete buxhetore për zbatimin e këtij ligji kaq të rëndësishëm për ndërtimin e shtetit ligjor dhe luftimin e krimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, deputetja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve do të duhej të ishte një hapë më tej drejtë përmirësimit të sistemit të drejtësisë në vend, pasi që si i tillë ka munguar deri më tani. Ky projektligj sado i qëlluar që është, nuk do të mund të implementohet si i vetëm, si dhe nuk do të mund të implementohet pa qartësimin dhe ndarjen e plotë të pushteteve edhe në praktikë. Mirëpo, në arritjen e qëllimit të tij, ky projektligj duhet plotësuar edhe më tej, sepse si i tillë është ende i mangët.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, dëshmitari dhe anëtarët e familjes kanë të drejtë në cilën do fazë të procedurës t’i paraqesin gjyqtarit kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet, kur ka rrezik serioz.

Kurse në Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve nuk parashihen masat mbrojtëse ndaj familjes së dëshmitarit të mbrojtur, pra kur dihet fakti se familja është pjesë e personit në cilësinë e dëshmitarit, pra në një farë mënyre do të rrezikohet edhe familja.

Ky projektligj nuk i parasheh masat urgjente të mirëfillta, ku për rastet e natyrës së shpejtë me pëlqimin e dëshmitarit do të autorizohet edhe Drejtoria policore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe pa pasur nevojë që çështja e tillë të kalojë në komision. E meta e radhës së këtij projektligji qëndron edhe në faktin, ku sipas nenit 26, nuk është parashikuar mundësia e përfundimit të programit për mbrojtjen e dëshmitarëve, në rastet kur marrëveshja për mbrojtjen e dëshmitarit është absolutisht nule, për arsye se një person për motive të caktuara mund të detyrohet me dhunë ose kanosje për përfshirjen e tij në mbrojtjen e dëshmitarëve.

Po ashtu, mendojmë që ligji duhet të jetë më i qartë në lidhje me atë se kush i lidhë marrëveshjet me shtetet tjera për relokimin e dëshmitarëve dhe se kësaj duhet t’i kushtohet rëndësi më e madhe, sepse nuk mendojmë se relokimi i dëshmitarëve brenda Kosovës mund t’i prodhojë efektet e duhura. Përveç mangësive të lartcekura, pra është shqetësuese edhe kostoja buxhetore, sikurse që nuk u parapa edhe në Projektligjin e mëparshëm dhe se nuk dihet se ku do t’i marrin mjetet. Ndoshta kësaj here do të privatizojnë diçka tjetër.

Dhe, së fundi, ne do ta votojmë në parim këtë Projektligj dhe vërejtjet tona do t’i adresojmë në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju, faleminderit, zonja deputete!

Fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, zot kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve është një ndër ligjet më të rëndësishme që i ka munguar Kosovës.

Mbrojtja e dëshmitarëve nga kërcënimet apo frikësimet ka qenë dhe mbetet njëra nga sfidat më të mëdha për sistemin gjyqësor në Kosovë. Kjo çështje është ngritur vazhdimisht edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare mbi drejtësinë, e posaçërisht vlen të theksohet Raporti i progresit të Komisionit Evropian.

Fatkeqësisht, deri tani ky ligj ka qëndruar në sirtarë, duke u arsyetuar për shkak të kostos së lartë financiare, por megjithatë Kosova ka nevojë për një ligj të tillë për arsye se mbi çdo gjë, duhet të kemi parasysh ligjin dhe zbatimin e tij.

Në përgjithësi, është pretenduar të jetë një ligj i draftuar me standarde, por mbetet sfida zbatimi i tij, duke pasur parasysh specifikat e Kosovës dhe strukturën sociale të saj dhe për këtë arsye, frika për zhvendosjen e dëshmitarëve jashtë Kosovës, që shpeshherë ka ndodhur edhe me manipulime, është mënyrë e cila mund të dëmtojë edhe mundësinë e zbatimit të këtij ligji. Ky ligj parashihet të hyjë në fuqi një vit pas miratimit, neni 32. Ministria e Punëve të Brendshme është e obliguar që brenda 6 muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligj. Pra, kemi të bëjmë me një periudhë minimale prej 18 muajsh që ky ligj të japë rezultatet e para në fushën e parandalimit dhe të luftimit të të gjitha llojeve të krimeve të rënda.

Gjithashtu, pengesë e zbatimit të Ligjit është dualizmi i cili paraqitet në mes institucioneve të vendit dhe, në këtë rast, misionit të EULEX-it, sipas dispozitave kalimtare të këtij ligji.

Në përfundim, ne mendojmë se duhet të punohet në amendamentim të kujdesshëm për shkak të specifikave që u përmendën, por sidomos për koston financiare që i kushton këtij ligji. Prandaj, mendojmë si grup parlamentar ta aprovojmë këtë ligj në parim, por që në amendamentim duhet të ketë shumë kujdes, sepse është një ligj shumë i rëndësishëm dhe që mund të sjellë deri te mosrealizimi në praktikë i këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju, faleminderit, zoti Isufi!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Suzana Novobrdali.

SUZAN NOVOBRDALI: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëritje për të gjithë!

Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah në parim Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Mendojmë se ka vend për ndryshime në disa nene. Pa i përsëritur parafolësit e mi, dëshiroj ta theksoj një vërejtje që kemi të bëjmë tek neni 2, tek përkufizimet, pika 1.3, ku thotë: “Personi i mbrojtur, është personi me të cilën është vendosur marrëveshja e mbrojtjes” e në fakt kemi të bëjmë me dëshmitarët. Në këtë rast, do të thotë, edhe në nenet e mëvonshme kemi një paqartësi sa u përket dëshmitarëve, se a kemi të bëjmë me dëshmitarët e rastit, kemi të bëjmë me dëshmitarët të cilët janë bashkëkryerës në një vepër penale, nxitës apo ndihmës, apo kemi të bëjmë me dëshmitarë të cilët rastësisht apo si kalimtar mund të jenë dëshmitarë të rastit gjatë kryerjes së veprës penale.

Mendojmë se kjo çështje duhet të konkretizohet. Gjithashtu, i kemi edhe disa vërejtje që është tek neni 19, e kemi edhe një vërejtje tek neni 20, mirëpo ne këto vërejtje do t'i paraqesim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet përkatëse. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju, faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputetja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem!

Nacrt zakona o zaštiti svedoka je vrsta zakona koji zahteva posebnu pažnju i angažovanje svih onih kako u samom Nacrtu zakona, tako i u primeni tog zakona. Da bi svoj doprinos dali u narednim fazama usvajanja ovog zakona, parlamentarna grupa SLS će podržati Nacrt ovog zakona. Hvala!

KRYESUESI: Ju, faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nakon analize Nacrta zakona o zaštiti svedoka, članovi Parlamentarne grupe „6+“ su saglasni da ga podrže u načelu, jer određuje mere zaštite za garantovanje bezbednosti i dobrobiti svedoka i drugih lica u vezi sa krivičnim postupkom i uspostavljanje načina za primenu tih zaštitnih mera, uz obaveznu korekciju pojedinih članova. Zakon smatramo potrebnim iz razloga što je dosadašnje zakonodavstvo u ovoj oblasti nepotpuno i nekompletno. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju, faleminderit!

Konstatohet që paraqitja e grupeve parlamentare është kryer. Të paraqitur janë tani deputetët. Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Padyshim se ky Ligj është i rëndësishëm së veçantë, u tha edhe nga parafolësit, është një kërkesë e kamotshme për ngritjen e standardeve të mbrojtjes juridiko-penale dhe jo vetëm raporti i progresit, por edhe raportet e shumë agjencive ndërkombëtare kanë kritikuar vazhdimisht Kosovën për mungesën e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Pa dyshim, ky ligj ofron këtë bazë të mirë ligjore, e plotëson kuadrin ligjor të së drejtës penale dhe mendoj se ligji ka plotësuar standardet ndërkombëtare që kërkojnë në lëmin e të drejtës ndërkombëtare penale.

Përgjithësisht është rregulluar mirë materia, është dizajnuar mirë programi i mbrojtjes së dëshmitarëve, janë paraparë të gjitha mekanizmat në mënyrë që dëshmitarët e mbrojtur të jenë pjesë e zbulimit të së vërtetës materiale në prokurën penale. Megjithatë, unë do të shëroj katër çështje parimore për diskutim, të cilat duhet të diskutohen me rastin leximit të dytë dhe të përgatitjes së amendamentimit nga komisionet funksionale. Fillimisht, statusi i dëshmitarit të mbrojtur duhet të zbërthehet mirë dhe ligji duhet të përkufizojë në mënyrë të qartë kush konsiderohet dëshmitar i mbrojtur. Duhet në

mënyrë takstative të thuhet kush është dëshmitari i mbrojtur, sepse në praktikat a penale jo rrallë statusin e dëshmitarëve të mbrojtur e marrin edhe personat që vete janë të inkriminuar në çështjen konkrete penale dhe ligji plotësisht duhet të jetë decidiv për të treguar se si dëshmitar i mbrojtur mund të jetë vetëm personi që ka fakte relevante në çështjen penale dhe nuk ka asnjë lidhje me çështjen penale që është objekt i ndjekjes penale.

Çështja e dytë, statusi i dëshmitarit të mbrojtur, duhet të vlejë në të gjitha fazat e procedurës penale, jo vetëm me rastin e fazës penale, por edhe në fazën para penale, kur krijohen indiciet për ekzistimin e veprës penale dhe kur fillon hartimi i kallëzimit penal dhe ky status duhet vlejë në të gjitha proceset, jo vetëm në procesin e gjykimit në shkallë të parë, por do të doja ky status duhet të mbrohet derisa vendimi i gjykatës apo aktgjykimi i gjykatës merr formë të prerë, bile edhe në rast të apelimit, me mjete të jashtëzakonshme juridike, statusi i dëshmitarëve të mbrojtur duhet të ekzistojë dhe duhet të mbrohet.

Një çështje tjetër që duhet të rregullohet me ligj, duhet në mënyrë decideve përmes dispozitave ligjore të ketë dispozita që ndalojnë keqpërdorimin e statusit të dëshmitarit të mbrojtur, sepse jo rrallë, dëshmitarët e mbrojtur janë pjesë vet e kriimit në forma të ndryshme, në formë të bashkëpunimit, në formë të ngjytjes dhe Ligji në mënyrë decideve duhet të rregullojë situatën në të cilën humbë statusi i dëshmitarit të mbrojtur, sepse praktikat te disa raste penale, që janë zhvilluar apo po zhvillohen në Kosovën, tregohet që shpeshherë instituti i dëshmitarit të mbrojtur është keqpërdorë, është keqpërdorë bile është keqpërdorë edhe për inkriminime, edhe për fushatë mediave, edhe për tendenca që nuk kanë qenë të pastra penale dhe mendoj se këto nuk janë standarde ndërkombëtare, nuk është qëllimi i këtij ligji që t'i amnistojë kryesit duke i shpallë dëshmitarë bashkëpunues, por ideja e këtij ligji është që të mundësojë vërtet zbulimin e të vërtetës materiale në çështjet sensitive, në çështjet që ndiqen eks oficio. Për këtë arsye, ligji duhet të jetë i plotë dhe duhet të parasheh edhe situatat e ndalimit të keqpërdorimit të statusit të dëshmitarit të mbrojtur, si dhe institucionin e marrjes së statusit të dëshmitarit të mbrojtur në rastet kur shihet se ky institut nuk përdoret për qëllimin për të cilin e ka përcaktuar ligji, por përkundrazi keqpërdoret për qëllime tjera. Marrë në tërësi, ligji i plotëson këto standarde të të drejtës ndërkombëtare penale të legjislacionit ndërkombëtar dhe mendoj se miratimi i këtij ligji është edhe një fakt që Kosova plotëson të gjitha kushtet për të marrë përsipër të gjitha obligimet ndërkombëtare dhe janë krejtësisht të pabaza raportet e ndryshme që dëgjojmë, duke përfshirë edhe raportin e Dick Martit që Kosova nuk e ka të plotë kornizën ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe me këtë ne po japim edhe një kontribut sistemit tonë gjyqësor dhe funksionimit të tij të pavarur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë në parim e përkrah procedimin dhe miratimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, si një ligj me të cilin do të vendoset një kornizë adekuate ligjore me të cilin do të mbrohen të drejtat e dëshmitarëve që ftohen dhe paraqiten në procedurë penale.

Mirëpo, lidhur me këtë Projektligj, unë do të shtroja katër çështje:

Nën një, në nenin 4, përcaktohen llojet e masave mbrojtëse që mund të zbatohen ndaj dëshmitarëve, në mesin e të cilave parashihet edhe masa, ndryshimi i pamjes fizike, përfshirë edhe operacionin plastik. Kjo masë është paraparë në paragrafin 2.6 të nenit 4. Ç'është e vërteta, në paragrafin 3 të nenit 4, thuhet që masat mbrojtëse në përgjithësi mund të zbatohen vetëm me pëlqimin e personit të rrezikuar, që do të thotë, sipas këtij paragrafi, një personit nuk mund t'i ndryshohet pamja fizike, as t'i kryhet operacioni plastik po qe se ai nuk e jap pëlqimin.

Mirëpo, një paragraf më poshtë, konkretisht te paragrafi 4, të nenit 4, rregullohet caktimi i masave mbrojtëse, kur personi nuk është në gjendje të jep pëlqimin për shkak të gjendjes fizike apo mendore të tij dhe deicidivisht thuhet: "Masat mbrojtëse urdhërohen dhe zbatohen deri në ndryshimin e rrethanave kur personi i mbrojtur do të jetë në gjendje të jap pëlqimin e tij për mbrojtje. Sipas kësaj dispozite, del se personit mund t'i ndërrohet pamja e tij fizike, mund t'i bëhet operacionit plastik gjatë kohës kur për shkak të gjendjes së tij fizike dhe psikike nuk është një gjendje të jap pëlqimin për masën e tillë, gjë që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 26, alinenë 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës të Kosovës, ku thuhet që secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij që përfshinë:

- a) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e tij apo të saj në pajtim me ligjin;
- b) të drejtën që mos t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij; dhe
- c) të drejtën që mos të marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore pa pëlqimin paraprak të tij apo të saj.

Andaj, propozoj që paragrafi 4, i nenit 4 të riformulohet në atë mënyrë që të përjashtohet mundësia e masës mbrojtëse të paraparë, që ishte ndryshimi i pamjes fizike personave për shkak të gjendjes së tyre fizike apo mendore, kur nuk janë në gjendje që të japin pëlqimin e tillë.

Si çështje e dytë, është çështja e afatit të vendosjes së kërkesës, apo të vendosjes mbi kërkesën për përfshirjen në program për mbrojtjen e dëshmitarëve. Sipas këtij drafti, afati për vendosjen është diku mbi 63 ditë, që do të thotë se mund të zhagitet, mund të prolongohet prej drejtorit të kryeprokurori, prej kryeprokurori të komisioni.

Më duket se ky është një afat mjaft i gjatë kohor për të vendosur për një kërkesë, që në raste të caktuara ka të bëjë me mbrojtjen e personit, i cili e ka jetën në rrezik. Andaj, mirë është që këto afate të shkurtohen, respektivisht që në nenin 23 të përcaktohet ndonjë afat kohor brenda të cilit komisioni duhet dhe mund të vendosë mbi masat urgjente.

Si çështje e tretë, që do të theksoj lidhur me këtë drafatligj, është kreu V, në të cilin rregullohet me dispozita ligjore zbatimi i programit të mbrojtjes, pastaj procedurat për përfshirjen në program, kërkesat, kushtet, kriteret, afatet, organet vendimmarrëse dhe vazhdimi i programit, por në këtë kapitull, e as në tërë draftligjin nuk ka ndonjë dispozitë me të cilën rregullohet situata kur komisioni vendos negativisht për kërkesën në përfshirje në program dhe vetvetiu vjen pyetja: a thua komisioni mund të jetë gjithmonë i pagabueshëm dhe gjithmonë objektiv? Pse ushtruesi i kërkesës mos të ketë të drejtë ankese ndaj vendimit të tillë? Mendoj se një zgjidhje e këtillë paraqet zbrazësi juridike të këtij draftligji.

Dhe çështja e katërt, në nenin 25, paragrafi 2.6 ekziston një formulim tejet i përgjithësuar, i cili edhe në rastet e caktuara mund të keqpërdoret, sepse thuhet, citoj: “Të gjitha veprimet e ndërmarra nga zyrtarët e drejtorisë dhe komisionit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, nuk mund të jenë bazë për padi dhe nuk i nënshtrohen përgjegjësisë ligjore”.

Në interpretim gjuhësor të kësaj dispozite, do të thotë që zyrtarët e drejtorisë mund të kryejnë çfarëdo veprimi ndaj dëshmitarit të mbrojtur gjatë zbatimit të programit dhe mos t’i nënshtrohen përgjegjësisë ligjore. Andaj, mirë është që të riformulohet ky pasus, në mënyrë që të përcaktohet se cilat janë veprimet që mund t’i ndërmarrin këto organe kompetente në raste të tilla. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Blerim Shala.

BLELRIM SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Të gjithë ne që deri tash debatua për Projektligjin në fjalë, theksua rëndësinë e tij të madhe dhe s’do mend që pa miratimin dhe zbatimin këtij ligji, është iluzore të besohet që do të jemi të suksesshëm në luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Sidoqoftë, janë disa vërejtje parimore të cilat do t’i përmendi me këtë rast, para së gjithash në vetë kreun apo titullin e këtij ligji nuk është e qartë se a përfshinë ky ligj edhe dëshmitarët bashkëpunues, apo a janë edhe ata dëshmitarë të mbrojtur.

Sa për ilustrim, në Ligjin e Shqipërisë që e mbulon këtë çështje, saktësohet qartë në vetë titullin e tij, Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, ndërsa në nenin 2 po të këtij ligji të Shqipërisë qartësohet domethënia e dëshmitarit të drejtësisë dhe të bashkëpunëtorit të drejtësisë, ku ky i dyti mund të jetë edhe një i pandehur, apo madje edhe i dënuar në procedurën penale.

Përafërsisht i njëjti përkufizim është edhe tek neni 4 i Ligjit të Malit të Zi për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili përndryshe është marrë si njëri prej shembujve në përpilimin e ligjit tonë. Që diçka nuk është në rregull në këtë aspekt, na thotë edhe neni 25 i draftligjit tonë, i titulluar: Marrëveshja për mbrojtje, ku në nenin 2.2.3, thuhet që marrëveshja nënkupton edhe moskryerjen e ndonjë vepre penale. A do të thotë kjo që të mos kryhet vepra penale tash e tutje apo në të kaluarën? Nuk ... natyrisht vepër penale, nëse je në këtë program.

Vërejtja e dytë ka të bëjë me kreun V, me nenin 15, propozimi dhe kërkesa për përfshirjen në program apo vendimarrja në rastin e kërkesës së dikujt që të bëhet dëshmitar që është i mbrojtur në këtë program.

Në nenin 19.4 Kryeprokurori i shtetit, i cili është edhe kryetar i Komisionit për mbrojtjen e dëshmitarëve, para se t'ia propozojë Komisionit trajtimin e një rasti apo një kandidati për marrjen e këtij statusi, kërkon mendimin e Drejtorisë për mbrojtjen e dëshmitarëve, që edhe në tërësi është në Polici, për shkallën e rrezikut të jetës për atë person, për atë kandidat. Mendoj që kjo duhet të jetë çështje e trajtimit të prokurorit të lëndës dhe të kryeprokurorit, sepse ata dinë shumë më mirë se është jeta e dikujt, që është kandidatë për dëshmitar të mbrojtur, e rrezikuar.

Procedura e vendimarrjes, u tha edhe prej kolegëve më herët, në përgjithësi zgjatë 63 ditë, gjatë të cilave Policia do të duhet t'i zbatonte masat urgjente të mbrojtjes ndaj këtij kandidati për të marrë këtë status, e cila gjë në një mënyrë pohohet në nenin 23, por duhet të definohet shumë më qartë sepse, në të kundërtën, askush nuk do ta kërkojë ta fitojë këtë status, duke ditur që për 63 ditë do të jetë në mëshirën e fatit se çfarë do të ndodhë me të.

Te dispozitat kalimtare, neni 31, 32 apo te hyrja në fuqi të këtij ligji, ky ligj, sipas nenit 32, hyn në fuqi një vit pas shpalljes në "Gazetën zyrtare".

Në nenin 31 theksohet që Drejtoria dhe Komisioni për mbrojtjen e dëshmitarëve, që janë instancat përgjegjëse për aplikimin e këtij ligji, për zbatimin këtij ligji, themelohen brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo do të thotë se ne do të mund të kemi realisht mbrojtje të dëshmitarëve apo zbatim të këtij ligji diku në vjeshtën e vonë të vitit 2013, e jo më herët. Në ndërkohë, do të varemi plotësisht nga EULEX-i dhe nga gatishmëria e tij të jetë pjesë përbërëse e këtij programi shumë të rëndësishëm.

Në përgjithësi, me këtë dinamikë të zbatimit të këtij ligji, do ta kemi vështirë ta luftojmë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Së fundi, sa i përket kostos të zbatimit të këtij ligji, në segmentin e drejtpërdrejtë ose ndërtimit të programit për mbrojtjen e dëshmitarëve, është paraparë një shumë vjetore prej diku 160.000 eurove, siç është supozuar për 4 raste të dëshmitareve të mbrojtur dhe familjeve të tyre brenda një viti. Kjo gjithsesi nuk është shumë serioze për një ligj kaq të rëndësishëm. Ju faleminderit!

KRYEUSESI: Ju Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Fatmir Gjelili.

FATMIR GJELILI: Përshëndetje, kryesues!

Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve është një ligj që i ka munguar Kosovës, edhe pse shumica e çështjeve procedurale kanë qenë të trajtuara në Kodin e Procedurës Penale. Mirëpo, Qeveria e Kosovës faktikisht e ka planifikuar një dinamikë të

realizimit edhe të kornizës ligjore, por edhe të instrumenteve të zbatimit të këtij ligji, kështu që besoj që jemi në hap me kohën dhe është duke u punuar në atë drejtim.

Policia e Kosovës ka filluar formimin e Njesisë për mbrojtjen e dëshmitarëve, njësi që do të thoshte njësi e edukuar dhe e trajnuar prej ekspertëve dhe profesionistëve ndërkombëtarë dhe do të jetë e ndihmuar në edukim dhe trajnim edhe prej njesisë për mbrojtjen e dëshmitarëve të Policisë së EULEX-it, gjë që është një përparësi e madhe për të mos pasur ndonjë kosto të lartë buxhetore edukimi dhe trajtimi i Njesisë për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Sa i përket mungesës së Njesisë për mbrojtjen e dëshmitarëve, faktikisht na duhet të jemi real se një Njësi e tillë funksionon, funksionon në kuadër të EULEX-it dhe faktikisht dalëngadalë ajo do t'i transferojë kompetencat te Njësia për mbrojtjen e dëshmitarëve të Kosovës konform përgatitjes dhe cilësisë së punës të edukimit të pjesëtarëve të kësaj njësie. Kostoja buxhetore po flitet, me të vërtetë kostoja buxhetore është shumë e lartë, mirëpo programi për mbrojtjen e dëshmitarëve do të bazohet faktikisht në programet e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe detyrimisht do të hymë në marrëveshje bilaterale me shtetet që janë anëtare të programit për mbrojtjen e dëshmitarëve për atë arsye se Kosova është shumë territor i vogël dhe numri i banorëve e pamundëson faktikisht në mbrojtje adekuate dëshmitarëve vetëm në territorin e Kosovës, e ndoshta edhe të Maqedonisë dhe të Shqipërisë, se po del që një farë mënyre lehtë po bëhet dekonspirimi i dëshmitarëve për të dëshmuar aktet jo ligjore dhe veprat e ndryshme që tërheqin sanksionime penale me kohëzgjatje mbi 5 vjet.

Besoj që programet të cilat i aplikojnë shtetet e ndryshme do të mundësojnë që të bëjmë këmbimin e dëshmitarëve me shtetet të cilat i kanë këto programe të zhvilluara dhe të cilat kanë shprehur gatishmëri dhe dëshirë për të na ndihmuar në këtë drejtim.

Ligji në fjalë në mënyrë adekuate dhe në mënyrë konkrete i përcakton çështjet ligjore, detyrimet dhe obligimet ndaj dëshmitarit, por edhe detyrimet e dëshmitarëve ndaj shtetit, gjegjësisht ndaj drejtësisë të jetë në dorën e kryesuesve të komisionit bashkë me ekipin vlerësues të rrezikshmërisë për dëshmitarin për t'u përcaktuar në cilat faza të dëshmisë do të jetë ai dëshmitar i mbrojtur, duke e pasur të drejtën çdo herë në çdo kohë për t'u tërheq prej programit për dëshmitarët.

Besoj që votimi në parim edhe puna në definimin e disa detaleve në këtë ligj Kosovën do ta bëjë me një ligj cilësor për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

Duke përshëndetur ju, më lejoni që të përshëndes sjelljen në Kuvend të këtij ligji të rëndësishëm, siç u tha, edhe karshi kërkesave të partnerëve ndërkombëtarë, edhe të

Raportit të progresit, por edhe si nevojë, një nevojë e përpjekjes për sundim të ligjit dhe për rend në vend.

Besoj që gjithkund kur është në pyetje nevoja për të siguruar instrumentet ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve në funksion të ligjit, nuk ka kontestim dhe kjo është mirë. Por ajo që, mendoj, do parë me kujdes, është fakti që u theksua në një mënyrë edhe përpara, ligji nuk e sqaron sa duhet qartë ç'është dëshmitari i mbrojtur. Dhe kjo lejon mundësi pastaj edhe për keqpërdorime.

Ne kemi miratuar edhe një ligj për dëshmitarët bashkëpunues dhe mendoj që do harmonizuar ky ligj me ligjin e miratuar.

Për më tepër, ligji nuk e sqaron mirë, edhe pse thotë se është paraparë mbrojtja e dëshmitarëve gjatë procedurës hetuese dhe gjyqësore, por vetë çështja është vendosur në drejtorinë e policisë, në strukturat e policisë, kurse bartëse e gjithë procesit pastaj është Ministria e Brendshme dhe mendoj që edhe kjo mund ta trajtojë çështjen si, thjeshtë, policore në procesin hetimor dhe mendoj që kjo mund pastaj të prodhojë përsëri ndërlikime e probleme.

Ajo që do të doja ta nënvizoj veçanërisht, është fakti, edhe një vërejtje e kësaj natyre është, shihet atje, parashihet se mund të përfshihen në këtë program të mbrojtjes vetëm ata që nuk kanë qenë të dënuar, kurse një nen më vonë thuhet – dëshmitarët e mbrojtur që janë në vuajtje të dënimit duhet të kenë këtë trajtim, e tjera. Njëra përjashton tjetrën dhe mendoj që në procedurën e mëvonshme duhet të korrigjohet, por ajo që do të dëshiroja veçanërisht është specifika e realitetit kosovar.

Ka qenë një fenomen shumë i përhapur, pra fenomeni i dëshmitarëve të rrejshëm, i dëshmitarëve të porositur. Për fat të keq, e kemi këtë fenomen edhe tani, e dëshmitarëve politikë, si ta them. Dhe mendoj ligji duhet të parandalojë keqpërdorimin e tij nga këto pirje, për fat të keq, ende të pranishme në realitetin tonë. Dhe ligji nuk e parandalon këtë. Ka një fjalë në popullin tonë, thuhet “dy të pa shpirt, një pa krye”. Nëse jo pa krye, te ne ende mund të jetë “dy të pa shpirt, një pa liri”. Dhe fenomene të tilla kemi sa të duash. Merrni parasysh vetëm atë që po ndodh në vende të ndryshme perëndimore. Janë me qindra, me mijëra që kërkojnë azil politik edhe tash, qytetarë nga Kosova që kërkojnë azil me pretekste të rrejshme se gjoja janë të kërcënuar, janë të rrezikuar e tjera. Të gjithë ata potencialisht mund të jenë edhe dëshmitarë të porositur në procese të porositura nga qendra të ndryshme politike dhe ne jemi të vetëdijshëm se këto qendra politike ekzistojnë dhe punojnë dhe ne ballafaqohemi përditë me këtë fenomen. Angazhohem, prandaj, që këto të parandalohen, sepse po të lejohet, nuk do të ketë mundësi, i gjithë buxheti jonë nuk do të mjaftojë për t'i hequr shpenzimet aq sa do të kishte të gatshëm për t'u rekrutuar dhe për të pranuar që të rekrutohen në funksione të tilla. Besoj se gjatë shqyrtimit të dytë do të korrigjohen këto anomali dhe si të tillë ligjin do ta miratojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Ligji që sot po e trajtojmë është një ligj i rëndësishëm së veçantë për shkak se si objektiv primar të vetin ka luftimin e krimit të organizuar dhe praktikave kriminale në aspektin e rrezikshmërisë, edhe individuale, edhe kolektive.

Në këtë kuptim mendoj se serioziteti dhe qasja e Qeverisë është një qasje e gabuar, duke filluar qysh në elaborimin e saj, sepse kemi elaborimin e ligjit jashtëzakonisht të rëndësishëm nga një person jashtëzakonisht jo kompetent.

Propozimi jashtëzakonisht jo kompetent, trajtimi jashtëzakonisht jo dinjitoz dhe mënyra e arsyetimit jashtëzakonisht e pa arsyeshme.

Prandaj, në këtë situatë krijohet një situatë e tillë, ku ministri ose zëvendëskryeministri, ministër përgjegjës për këtë fushë nuk merr pjesë në seancë dhe as ministri i Punëve të Brendshme, që ndoshta do të ishte më relevant për të folur për këtë çështje nuk merr pjesë në seancë dhe dalim dhe trajtojmë një ligj i cili realisht është shumë i rëndësishëm. Dhe këtu kemi një situatë ku japim edhe një mesazh politik dhe një mesazh teknik tek njerëzit. Mesazhi politik është që vullneti i Qeverisë për të zbatuar këtë ligj mungon, mungon kur shohim edhe qasje teknike që janë në ligj. Në ligj thuhet që ky do të hyjë në fuqi mbas një viti, ndërsa po ashtu mungojnë burimet financiare të cilat pritet që të garantohen pas vitit 2014 dhe i bie që realisht ky ligj është i pa zbatueshëm.

Vullneti politik i kësaj qeverie për të zbatuar një ligj të tillë mungon dhe kjo arsyetohet dhe shihet edhe në faktin se nuk ka garantuar asnjë mjet buxhetor mbi bazën e të cilit do të duhej të funksiononte ky ligj.

Ky ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm për luftimin e krimit të organizuar dhe të strukturave jo formale që ekzistojnë në shoqërinë kosovare.

Prandaj, unë mendoj se vetë koha e cila është përcaktuar për hyrjen e këtij ligji në fuqi është e gabuar. Mungesa e burimeve financiare është e qëllimshme dhe mungesa e përfaqësuesve politikë kompetent për zbatimin e këtij ligji ose propozues direkt të këtij ligji është një mesazh politik dhe një mesazh i qëllimshëm i cili dërgohet te qytetarët e Kosovës.

Kjo, po t'i shtojmë edhe disa elemente tjera praktike negative në të kaluarën, që e kemi ku dëshmitarët edhe janë kërcënuar edhe janë eliminuar fizikisht. Prandaj, jemi në një situatë ku realisht mungon vullneti i Qeverisë që të zbatohet një ligj ose të aprovohet dhe të binden qytetarët e Kosovës dhe të binden në bazën e parë, të binden deputetët e Parlamentit të Kosovës se ky ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm për luftimin e krimit të organizuar, sepse subjekte të rrezikuara në këtë rast janë individë të cilët e deklarojnë se kanë qenë pjesë ose kanë informacione mbi krimin e organizuar ose grupet kriminale të cilat ekzistojnë, kanë ekzistuar ose do të mund të ekzistojnë në të ardhmen në shoqërinë kosovare.

Prandaj, unë mendoj se qasja e Qeverisë është e gabueshme, në aspektin teknik ligji në pjesën e draftimit është në rregull, por në aspektin teknik të hyrjes në fuqi dhe në aspektin financiar është i papranueshëm sepse planifikohet që të hyjë në fuqi në vitin 2014, çka do

të ndodhë deri në vitin 2014 kur të njëjtën kohë ne kërkojmë që EULEX-i duhet të shkojë, që institucionet e Kosovës të jenë të pavarura dhe duhet të kryejnë vetë funksionet e veta, realisht Qeveria e Kosovës nuk ka vullnet që ta zbatojë këtë ligj, prandaj mendoj se nuk duhet të bëjmë shou politik dhe shou mediatik dhe t'i nënshtrohemi një presioni i cili ka ardhur kryesisht për ta aprovuar këtë ligj nga Bashkimi Evropian dhe jo si vullnet i kësaj qeverie për të zbatuar një ligj dhe për të mbrojtur interesat e qytetarëve mbi bazën e luftimit të krimit të organizuar dhe të bandave kriminale që mund të ekzistojnë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj se si kryetar i Komisionit që jeni, do ta ftoni ministrin dhe do t'u sqarojë lidhur me ligjin dhe unë prita që po na jepni ndonjë vlerësim për ligjin dhe jo deklarata politike. Zoti Yagcillar e ka fjalën!

MAHIR YAGCILLAR: Vërtet unë nuk jam me profesion jurist, por lexoj ligje dhe lexoj rregullore, besoj se edhe ju zoti Arben e keni lexuar Rregulloren, që një ministri mundet me paraqet ose të zëvendësojë një ministër tjetër në prezantimin e një ligji. Sa i përket ligjit, besoj që në komisionet dhe procedurat parlamentare do të përmirësohet dhe është vërtet një ligj i nevojshëm për Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Replikë, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit! Unë nuk po i qes në pyetje kredencialet e juaja personale, por po e qes në pyetje angazhimin dhe vullnetin politik të Qeverisë për të zbatuar dhe për ta shqyrtuar një ligj jashtëzakonisht të rëndësishëm, një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm siç është Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, do të duhej t'i jepnin rëndësi dhe trajtim jashtëzakonisht të veçantë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse këtu jepet një mesazh direkt edhe politik edhe një mesazh i vullnetit të angazhimit të institucioneve të Kosovës për të luftuar krimin e organizuar dhe bandat kriminale, prandaj mendoj se do të duhej të ishte një qasje më e fuqishme në aspektin e deklaramit nga ministrinë adekuate të cilat merren konkretisht me luftimin e krimit të organizuar dhe me luftimin dhe me mbrojtjen e dëshmitarëve për të krijuar një klimë se institucionet e Kosovës kanë vërtet vullnet që të luftojnë krimin dhe të luftojnë bandat të cilat ekzistojnë në territorin e Kosovës. Prandaj, mendoj se ne si Parlament dhe si Qeveri duhet t'i japim një mesazh shumë të qartë se bandat kriminale këtu nuk kanë vend dhe dëshmitarët të cilët deklarojnë apo dëshmojnë për veprimet kriminale të cilat mund të jenë realizuar në territorin e Kosovës ose jashtë saj do të jenë të mbrojtur. Faleminderit!

KRYESUESI: Të drejtë s'ke, por hajde merre, një minutë e ke!

MAHIR YAGCILLAR: Jo, unë replikoj vërtet, sepse ju e keni thënë personi jo kompetent. Unë jam personi kompetent të prezantoj ligjin, sa i përket çështjeve tjera, zotëri zëvendëskryeministër sot....

(Reagim)

...Zotëri zëvendëskryeministër Kuçi sot ka angazhime tjera me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian. Unë, sa i përket Rregullores, kam të drejtë të prezantoj një ligj pa marrë parasysh i cilit dikaster.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë desha që të lidhem me çështjet që po i diskutojmë dhe me ligjin nga një këndvështrim i imi. Ne po flasim për dëshmitarët e mbrojtur dhe mirë është që ta kemi këtë ligj dhe jam plotësisht dakord me ato që u diskutuan këtu lidhur me atë që dëshmitarët e mbrojtur duhet të jenë edhe ata të luftës kundër korrupsionit dhe të luftës e cila interesat e vendit tonë i përshpejton drejt integriteteve evropiane, por siç e dimë të gjithë këtu, çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrohet dhe kam një mendim që nuk po flasim për dëshmitarët e rrejshëm dhe mendoj që ky ligj duhet në veçanti me një pikë, me një nen të veçantë ta trajtojë çështjen e dëshmitarëve të rrejshëm dhe të mos e lidhë me Ligjin penal i cili parasheh dënim me gjobë të vogël, sepse ky ligj po bëhet për t'i trajtuar krimet e rënda dhe këto krime të rënda nënkuptojnë që njerëzit duhet të dënohen shumë.

Unë të paktën i di saktë dy deri tre raste me dëshmi që kanë dëshmuar njerëzit rrejshëm dhe...

(Reagim)

...të lutem, kur flas unë, unë jam duke folur, ti rri në vendin tënd. E di unë prokurorinë, e di unë ku është prokuroria dhe s'ka të më tregosh ti prej vendit hiq. OK. Të lutem, mos më pengo, rri në vendin tënd.

Kemi disa lloj dëshmitarësh dhe tani po ju zbërthej, dëshmitarët që kërkojnë azil, që i përmendi Hydayet Hyseni, janë dëshmitarë të cilët paraqiten me kombësi të rrejshme dhe janë shqiptarë, një pjesë e tyre. S'po i përmendi kombësitë, pjesëtarët e të cilave kombësi dhe kemi pjesëtarë të kombësive të tjera të cilët thonë se kemi presion psikik, fizik dhe jemi të rrezikuar me jetë në Kosovë dhe këta njerëz kërkojnë azil politik nëpër vende të Evropës Perëndimore.

Domethënë lidhur me këtë, në këtë drejtim, ne duhet të përshpejtojmë kontaktet me qeveritë përkatëse dhe të informojmë reciprokisht përmes institucioneve përkatëse tonat të cilat i rrëzojnë poshtë këto dëshmi të rrejshme të tyre, të cilat e komprometojnë Kosovën.

Kemi dëshmitarë të cilët paraqiten për përfitime personale. Çka janë këto? Normalisht se ju garantohet, po themi dëshmitarë i mbrojtur, por del rren ai në gjyq për iksin ose ipsilonin, pa marrë parasysh kush është ai dhe po u dashka të ketë ai përfitime në mbrojtje të familjes, në largim nga Kosova dhe ta çojnë diku për t'ia ndërruar identitetin dhe dikush i pafajshëm mund të dënohet pse një njeri, një fukara i shkret, i cili s'ka pasur kah t'ia mbaj me gjendjen ekonomike që e kemi dhe ka dëshmuar në gjyq për iksin ose ipsilonin dhe tani në emër të rrezikshmërisë së jetës së tij ne po u dashka të interesohemi me buxhetin e Kosovës dhe t'ia garantojmë edhe jetën atij shtesë për dëshminë e rrejshme që e ka bërë.

Kemi shumë dëshmitarë, uroj që të mos jenë në sallë këtu, që për interesa politike kanë rrejt dhe kanë dëshmuar në institucione të ndryshme, duke përfshirë të gjithë ata që kanë qenë këtu në Kosovë për protagonistë të caktuar, duke përfshirë këtu edhe deputetë në këtë Kuvend dhe kanë dalë dëshmitarë të rrejshëm, kanë rrejt. Për interesa, dëshmitarët të cilët po vijnë dhe po dëshmojnë për interesa të një shteti tjetër... Tani, cili... Unë po dua ta ngrit një pyetje: cili komision, kush vendos për atë se cila dëshmi është e saktë, a është e rrejshme a s'është e rrejshme?

Në qoftë se një dëshmitar dëshmon dhe dëshmia e tij e dënon dikë me 10 vjet, 20 vjet heqje lirie dhe në fund del si dëshmi e rrejshme, ky dëshmitar nuk guxon, nuk do të duhej të dënohej me 100 euro dënim dhe as me 30 ditë dënim pse dëshmoi ose nuk dëshmoi, por duhet të dënohet me dënim me burgim të rëndë, sepse ka dëshmuar rrejshëm dhe dikush është dënuar shumë.

Ashtu siç mendoj, edhe komisioni i cili përcakton besueshmërinë e dëshmisë, do të duhej që përmes këtij ligji të ketë penalitet dhe penalitet të rëndë dhe jo penalitet të lehtë ose të mos jep kurrfarë llogarie pse e ka marrë ose e ka përcaktuar një dëshmi të rrejshme.

Kemi mjaft delikt droge nëpër Evropë, të burgosur të cilët realisht e kanë komprometuar Kosovën me deklaratat e tyre para gjyqit atje dhe ata kanë shfrytëzuar konsullatat dhe ambasadat e Jugosllavisë, respektivisht të Serbisë të cilët kanë pasur të drejtë t'i vizitojnë këta qytetarë të Kosovës të cilët shumica e tyre kanë qenë të pajisur me pasaporta të Serbisë dhe e drejta, e drejta e këtyre ambasadave është që t'i vizitojnë "dëshmitarët" e tyre dhe t'i udhëzojnë me një udhëzues të veçantë, e të thonë që po, kemi shitur drogë për ta financuar UÇK-në. Thuane, bëne këtë deklaratë, sepse gjyqi do t'ju ketë parasysh që t'ju zbus dënimin.

Dhe, ana tjetër, këta të papërgjegjshëm do t'i quaja, të mos i fyej tani nga mundësia që e kam, e kanë dëmtuar aq rëndë imazhin e vendit të vet, imazhin e familjes së tyre, sa sot në të gjitha raportet të cilat po i lexojmë krijohet përshtypja që krejt Kosova ushqehet me drogë dhe krejt Kosova në vend të ujit pi gjak. Andaj, mendoj se institucionet përkatëse, duke përfshirë edhe EULEX-in, i cili është në ndihmë të luftës së organizuar dhe krimeve të ndryshme, duhet ta ketë parasysh gjendjen e rëndë ekonomike që e ka Kosova dhe ta vlerësojë saktë dëshminë e atyre që donë t'i përdorin nëpër gjykatat, qoftë në Kosovë, qoftë jashtë saj. Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Behar Selimi!

BEHAR SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë vetëm desha të sqaroj, me rastin e paraqitjes së diskutimit në emër të Grupit Parlamentar, unë pata qëndrim parimor, por mes tjerash e propozova edhe një diçka që do ta artikulojmë si amendament.

Nuk është mungesa e institutit juridik në kuadër të këtij ligji, e institutit për dëshmitarin në luftë kundër korrupsionit, nuk është se mungon vullneti i ekzekutivit, por në asnjë ligj të këtij karakteri dhe të kësaj natyre nuk ekziston ajo çka ne propozuam.

Ajo çka ne propozuam është që dëshmitarët në luftë kundër korrupsionit të rregullohen edhe me këtë ligj, si një dëshmi që jemi të përkushtuar në luftë kundër korrupsionit, përndryshe në ligjet tjera nuk ekziston. Pra, është një institut juridik i ri, që ne e propozuam, dhe jo se mungon vullneti i ekzekutivit.

Për më tepër, më duhet të sqaroj edhe diçka tjetër dhe pa pretenduar për të qenë, për të luajtur rolin e përfaqësuesit të ekzekutivit, por meqë kam qenë deri në vitin e kaluar në krye të Policisë, e di që vonesat për këtë çështje nuk janë se neve, si vend, si shtet, si shoqëri nuk kemi dashur, por nga që drejtësia ndërkombëtare dhe policia ndërkombëtare nuk iu kanë besuar institucioneve tona të drejtësisë dhe të policisë, prandaj është vonuar dhe prandaj mendoj edhe vonesa për efektet e para të ligjit deri në vitin e ardhshëm janë të karakterit operacional. Njësia duhet të trajnohet së paku një vit, është standard, është njësi shumë elite, prandaj të gjitha këto janë nga pozitat e dikujt që e ka iniciuar njësinë në kuadër të policisë dhe e ka aprovuar edhe strukturën për herë të parë në vitin e kaluar, paralel me draftimin e këtij ligji. Desha të sqarohem për hir të korrektësisë dhe të vërtetës, pa pasur dëshirë për të politizuar, se kjo është çështja që ndoshta më së pakti do të duhej ta politizojmë, është çështje që ka të bëjë me drejtësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të kabinetit,

Deputetë,

Tanimë në fakt u sqaruan edhe disa çështje që kanë të bëjnë ndoshta edhe me vetë prezantimin nga ana e Qeverisë së këtij projektligji, pra ka të drejtë ligjore edhe me Rregullore, me kompetencë të plotë të mungesës së ministrit përkatës një ministër tjetër i deleguar nga kryeministri, ju besoj tashmë e dini të gjithë këtë, në vend, sot në kohën kur zonja Ashton është në takim me një pjesë të madhe të kabinetit qeveritar, me disa përfaqësues të kabinetit qeveritar, unë mendoj që është sinjali më i mirë që sot e kemi në trajtim edhe këtë projektligj. U tha nga përfaqësues edhe të gjitha partive, por edhe nga shumë deputetë që për nevojën e madhe që e ka vendi ynë për aprovimin sa më të shpejtë të këtij projektligji, u thanë edhe disa elemente që kanë të bëjnë jo vetëm me nevojën kryesore që është luftimi i krimit të organizuar, por edhe në disa shqetësime që kanë të bëjnë me kredibilitetin e dëshmive dhe të dëshmitarëve.

Unë dëshiroj t'ju them që jo vetëm për arsye që u thanë këtu nga disa deputetë për dëshmitë e rrejshme, në fakt për të arsyetuar këtë kemi pasur edhe të burgosur edhe nga vendet tjera që kanë ofruar dëshmi edhe për krimet serbe. Në fakt, kjo e qet në pah nevojën e madhe që ka vendi ynë për ta pasur ligjin i cili është adekuat edhe në përputhje me rrethanat tona.

Unë shpresoj se komisioni përkatës ka për t'i marrë parasysh edhe disa prej vërejtjeve serioze që u thanë këtu dhe sa më shpejt ta kemi ligjin në zbatim. Për sa i përket buxhetit, ka edhe disa ligje që i kemi aprovuar dhe që kanë qenë me vështirësi të realizimit për shkak të buxhetit dhe jemi marrë vesh ose ka pasur një proces gradual të zbatimit të këtyre ligjeve. Unë mendoj se është mirë që tash po e çojmë përpara, mendoj se do të

ketë vullnet politik nga të gjithë faktorët politikë që ta bëjmë më të mirë ligjin dhe ta aprovojmë sa më shpejt dhe t'i japim drejtësisë në dorë mundësinë që ta kenë këtë ligj dhe po ashtu do ta marrim edhe një gatishmëri që është edhe e partnerëve ndërkombëtarë që të na ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji, qoftë nga aspekti i ekspertizës, qoftë nga nevoja e buxhetit ose nga ana financiare që e kemi. Faleminderit!

KRYESUESUESI: Faleminderit! Arben, e ke kryer diskutimin.

(Reagim)

Jo, u krye! Edhe në emër të Grupit është kryer!

(Reagim)

Tani të paraqitur të tjerë nuk ka. Kërkojmë deklarinë me votim për miratimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në mbledhje janë prezent 85 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj që me 79 vota me kartelë, 1 pa kartelë, pra 80 deputetë “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për eficiencën elektrike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotin Beqaj, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të propozojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Beqaj, e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush të paraqes për miratim Projektligjin për eficiencë të energjisë.

Ky projektligj parashikohet nga Strategjia e energjisë për periudhën 2009-2018 dhe është i bazuar në kërkesën e nenit 9 të Ligjit për energjinë, numër 03-L-184.

Për më tepër, domosdoshmëria për këtë projektligj është edhe kërkesa e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, pjesë e së cilës është edhe Republika e Kosovës me të drejtat e barabarta si kur vendet tjera në rajon.

Qëllimi i këtij projektligji është që të hartojë dhe të harmonizojë legjislacionin vendor me një numër të caktuar direktivash të Bashkimit Evropian, të cilat janë të domosdoshme për eficiencën e energjisë.

Këto direktiva janë, Direktiva 2006/32 e Komisionit Evropian mbi promovimin e eficiencës së energjisë të konsumatorëve fundorë dhe shërbimet e energjisë; Direktiva 2010/31 e Komisionit Evropian mbi performancën energjetike të ndërtesave; dhe Direktiva 2010/30 e Komisionit Evropian për etiketimin e pajisjeve që shpenzojnë energji.

Bazuar në këto tri direktiva të lartpërmendura, si dhe duke pasur në konsideratë 3 standardet e Bashkimit Evropian që deri në vitin 2020 të arrihet dhe të rritet efienca e energjisë për 20%, të bëhet reduktimi i gazrave serë 20% dhe të ketë pjesëmarrje të burimeve të ripërtëritshme të energjive për 20% në konsumin total të energjisë. Kosova ka hartuar planin kombëtar të eficiencës së energjisë, ku ka marrë detyrim që të rrisë eficiencën e përdorimit të energjisë në masë prej 9% deri në fund të vitit 2018 duke i referuar konsumit total të energjisë dhe atë për këtë periudhë 9 vjeçare. Pra, mesatarisht 1% në vit.

Kjo përbën për vendin tonë njësi jo të vogël, tejkalimi i së cilës kërkon marrjen e një vargu masash ligjore, institucionale dhe rregullatore, si dhe zbatimin e programeve dhe projekteve që do të mundësojnë arritjen e këtij caku ambicioz, por edhe të domosdoshëm.

Qëllimi i Projektligjit për eficiencën e energjisë është që të rregullojë infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe institucionale për eficiencën e energjisë në Kosovë.

Ky projektligj synon promovimin e eficiencës së energjisë, përgatitjen dhe aprovimin e planeve të eficiencës së energjisë, ndërmarrjen e masave për eficiencë energjetike dhe obligimin e sektorit publik për të bërë shembull në përmirësimin e eficiencës së energjisë.

Bazuar në këtë projektligj do të ndihmohet edhe implementimi i masave të eficiencës së energjisë si dhe mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet stimulimit të reduktimit të konsumit në nivel qendror dhe atë në nivel komunal në Republikën e Kosovës.

Projektligji për eficiencën e energjisë parashikon themelimi ne Agjencisë së Kosovës për Eficiencën e Energjisë e cila do të jetë në krye të zbatimit të programit nacional për eficiencë program ky që e kemi përgatitur në pajtim me strategjinë energjetike dhe kërkesat e traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky projektligj vendos një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore në përputhje me direktivat dhe praktikatat e legjislacionit evropian dhe këtë e dëshmon edhe ekspertiza ligjore e Ministrisë

së Integrimit Evropian e cila përkujdeset për harmonizimin dhe përafrimin e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, ligji nuk ka kosto të lartë, prandaj edhe e njëjta shihet në deklaratën financiare të lëshuar nga Ministria e Financave.

Projektligji ka marrë pëlqimin edhe nga Sekretariati i Traktatit për Komunitetin e Energjisë.

Projektligji përbëhet nga 5 krerë, gjithsej 16 nene, duke filluar nga titujt e neve konkret dhe dispozitat e përgjithshme shpjeguese, dispozitat përcjellëse dhe dispozitat kalimtare dhe ato përfundimtare.

Prandaj, i nderuar kryesues, të nderuar deputetë,
Duke pasur parasysh rëndësinë e rregullimit juridik institucional dhe promovues në fushën e eficiencës së energjisë, ju rekomandoj që këtë projektligj ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqaj!

Tani sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Pajaziti e ka fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 17.5.2011 shqyrtoi në parim Projektligjin numër 4/L-16 për eficiencën e energjisë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqes rekomandimin që të miratohet në parim ky projektligj.

Komisioni ka vlerësuar se Projektligji i plotëson kushtet e parapara të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala e ka fjalën!

SALA BERISHA SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje, ministra prezentë!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Që në fillim po theksojmë se e mbështesim, në parim. Qëllimin e këtij projektligji veç se e ceku ministri. Ky ligj është në ndërvlerë me pakon e ligjeve bazike të energjisë, të cilat janë në fuqi, në njëfarë forme ky veç e përplotëson pakon ligjore të fushës së energjisë,

vendos një kornizë gjithëpërfshirëse e cila do të jetë në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian dhe standardet e caktuara evropiane.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji i ka nxjerrë edhe disa rekomandime të cilat do t'ia ofroj komisionit parlamentar funksional gjatë fazës së amendamentimit.

Vlen të përmendet se në Projektligj parashihet zbatimi dhe përfillja e legjislacionit evropian për çështje të shfrytëzimit racional të energjisë pa përcaktuar instrumentet ligjore, kështu që duhet të përcaktohem në ligj, thellësisht për mënyrën e procedurën e adoptimit të këtyre konventave. Për këto çështje që janë të parapara, duhet të plotësohen neni 4 dhe 13 i Projektligjit.

Mandej, duhet të përcaktohet në ligj edhe raporti dhe plani i Kosovës për efikasitet të energjisë, se kush duhet ta dorëzojë në komunitetin e energjisë, agjencia, ministria apo qeveria. Sigurisht se do të përcaktohet me ligj gjatë fazës së amendamentimit, si dhe çështjet tjera për të cilat mendojmë si grup parlamentar të japim kontributin tonë në komisionin funksional gjatë fazës së amendamentimit. E mbështesim në parim dhe i ftojme të gjithë deputetët që ta mbështesin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, zoti Zharku e ka fjalën, se ma kanë dhënë një emër tjetër.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së në parim e përkrah projektligjin, përkundër asaj që kemi disa vërejtje konkrete sa i përket projektligjit. Vërejtja e parë shkon në atë se me aq sa kuptohet, projektligji ka të bëjë vetëm me sektorin publik, kurse sektori privat nuk është i përfshirë në këtë projektligj. Nisemi nga ajo se raporti i vitit 2010 i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, ku i përcakton konsumin e energjisë në vendin tonë, sektori publik përfshin vetëm 0.4%, kurse 99.6% janë sektori i amvisërisë, sektori komercial dhe sektori i industrisë, kështu që shohim, jemi skeptik në arritjen e parametrave të caktuar në kursimin e energjisë nëse ky ligj ka të bëjë vetëm me 0.4% të konsumit të energjisë në Kosovë.

Çështja tjetër ka të bëjë me formimin, krijimin e institucioneve të reja. Ligji parasheh krijimin e Agjencionit për Efikasitet të Energjisë në kuadër të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik. Ne shprehim rezerva në themelimin e kësaj agjencie, ashtu siç edhe Ministria e Financave që ka paraparë rezervat e veta, në kuptimin e asaj se a kemi nevojë themelimin e agjencionit të tillë me 5 apo 6 të punësuar, apo mundet divizioni aktual për efikasitet të energjisë, që është në kuadër të Ministrisë, të ngritet niveli i tij në nivel të departamentit apo thjeshtë të një drejtorie.

Në anën tjetër, kemi komisionin për certifikim të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë. Nuk është e qartë puna e këtij komisioni, nuk është e qartë se me ligj së paku

nuk kemi diçka shumë më tepër në lidhje me këtë komision se cilat do të jenë kompetencat, mënyra e organizimit të këtij komisioni dhe puna e tij. Po ashtu, në ligj përmenden zyrat komunale për energji. Sipas strukturës aktuale, nëpër komuna nuk kemi zyra komunale për energji, por ligji nuk e përcakton në mënyrë decitive se a duhet të themelohen ato komuna apo është çështje e vetme e komunave.

Në anën tjetër, te planet komunale që i përpilojnë e hartojnë komunit dhe i dorëzojnë Agjencionit për Eficiencë të Energjisë nuk parashihen masa të caktuara apo procedurë e caktuar nëse po e marrim një komunë nuk e përpilon planin, nuk ia dorëzon agjencionit, çka më tutje, përpos edhe ligji e përcakton që edhe dorëzohet në Agjencionin për Eficiencë të Energjisë dhe asgjë më tutje.

Në parim, na mendojmë se ndoshta kishte mund kjo çështje të rregullohet më lehtë me një udhëzim administrativ në nivel Qeverie, por megjithatë nëse Qeveria mendon se është dashur të jetë Projektligji ashtu si thash në fillim, ne e përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Ligjin për eficiencën e energjisë dhe e përkrahim në parim këtë ligj për shkak se, ose një ligj të tillë, për shkak se konsiderojmë që kjo është një fushë tejet e rëndësishme për sa i përket përmirësimit të furnizimit me energji elektrike dhe mënyrës se si e përdorim ne energjinë elektrike këtu në Kosovë. Natyrisht që efikasiteti apo eficaenca e përdorimit të energjisë elektrike në Kosovë është mjaft e dobët për shkak të shumë arsyeve tjera, dhe konsiderojmë që ky ligj në njëfarë mënyre dështon në mbulimin dhe rregullimin se çfarë i duhet situatës aktuale për sa i përket kësaj fushe në Kosovë. Pra, është ligj i cili përkundër rëndësisë së fushës të cilën e mbulon, mbetet një ligj i cili përshkohet apo përcillet me probleme të shumta. Një nga kryesorët do kisha thënë, është edhe vetë pështjellimi i qëllimit të fushëveprimit të ligjit, ku nuk definohet qartë se eficaenca ka të bëjë me tërë sektorët e ekonomisë dhe me përgjegjësinë e shumicës së ministrive përkatëse, e jo vetëm si çështje publike, siç është paraparë këtu në ligj. Pra, siç u përmend edhe nga parafolësi, neni 10 i këtij ligji e obligon vetëm sektorin publik që ta shfrytëzojë energjinë në mënyrë eficaence, po jo edhe sektorin privat dhe kjo pra e lë një pjesë të madhe të përdoruesve të energjisë elektrike të pambuluar nga ligji apo të pa obliguar nga ligji.

Një çështje tjetër që është shumë e rëndësishme për sa i përket ligjit, e që ka të bëjë, domethënë, me zbatueshmërinë e ligjit, është po ashtu edhe fondi për subvencionimin apo financimin e eficaencës së rritjes së eficaencës së energjisë elektrike. Ne e dimë që një çështje e tillë është vështirë të zbatohet nëse nuk ka një fond përcjellës, i cili e mbulon në pjesë të kostos për këtë çështje dhe e dimë po ashtu që për sa i përket diskutimeve edhe brenda Ministrisë dhe brenda Qeverisë së Kosovës, për një kohë të gjatë është shtyrë pikërisht procedimi i këtij ligji për shkak të pranisë së një fondi në të dhe për shkak të barrës buxhetore që ai mund të paraqet dhe ligji të cilin e kemi përpara nuk flet në asnjë

mënyrë as nuk e përmend fare domosdonë për themelimin e një fondi të tillë dhe konsideroj që mungesa e këtij fondi e bën goxha të vështirë të zbatueshëm ligjin, pra e shndërron këtë ligj në një ligj të cilin do ta kemi në “Gazetën zyrtare” vetëm sa për të thënë që kemi ligj për eficiencën e energjisë, pa pasur kurrfarë efekti pozitiv në terren që vjen nga ky ligj.

Po ashtu, është e rëndësishme që ky ligj i krijon disa institucione të reja në Kosovë, si agjencinë dhe komisionin, mirëpo konsideroj që për sa i përket Agjencisë për Eficiencën e Energjisë Elektrike shihet qartë se në detyrat dhe përgjegjësitë që kjo agjenci do t’i ketë, ajo goxha shumë shndërrohet në një agjenci e cila më shumë këshillon dhe propozon, se sa që ka fuqi obligative dhe në këtë mënyrë prapë po mbetet që e tërë çështja e eficiencës së energjisë elektrike të mbetet në vullnetin e Ministrisë së Energjisë.

Dhe, një vërejtje e fundit për sa i përket ligjit, është se ky ligj nuk i parasheh përgjegjësitë apo nuk i definon qartë përgjegjësitë e ministrive tjera përkatëse, pra është e kuptueshme që Ministria e Energjisë, që tash nuk ekziston në Qeverinë e Kosovës, do të duhej të ishte referenca e po ashtu do të duhej të kihet parasysh që të gjitha ministrinë duhet t’i kenë përgjegjësitë e veta në fushat e përgjegjësiave sipas sektorëve ku zbatohet eficientia e energjisë.

Pra, edhe një herë, Lëvizja “Vetëvendosje” do ta miratojë në parim këtë projektligj dhe natyrisht që do të jemi aktivë me rekomandimet tona në komisionin funksional përkatës që merret me ligjin, por po ashtu tërheqim vërejtjen që ky ka shumë mundësi që të jetë edhe një prej shumë ligjeve në Kosovë të cilat nuk gjejnë zbatueshmëri për shkak të mungesave obligative që nuk i ka ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti ministër,

Fillimisht dua t’ju them që sikur edhe grupet tjera, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës me kujdes e ka shqyrtuar projektligjin, po merrni vesh çka po ju them, sikur ju tjerët!

Kemi pritur, zakonisht presim që kur prezantohet një projektligj prej Qeverisë së Kosovës, fillimisht të tregohet gjendja për shkak se ligjet të cilat vinë para nesh, synojnë ta ndryshojnë gjendjen, të kalojnë prej një gjendje në një gjendje tjetër. Do të thotë, flasim se ku gjendemi, atëherë të flasim për synimin, çka synojmë ose ku synojmë të arrijmë pas aprovimit të ligjit dhe detyrës në fuqi dhe ndërkohë të flitet për mundësitë, për masat e mundësitë dhe masat, që definitivisht fillojnë të shpjegojnë sa mjete na duhen për të arritur prej gjendjes *a* në gjendjen *b*, sa kohë na duhet, çfarë mjete tjera i duhen shtetit për të arritur prej gjendjes *a* në gjendjen *b*.

Gjendja, meqenëse ministri nuk e shpjegoi, po provoj pak, është e tillë që kemi me qindra mijëra shtëpi të pa suvatuara, të pa izoluar, kemi vetura që shpenzojnë jashtë proporcionalisht me rrugën që e bëjnë, e do të kthehem te veturat pak më vonë, kemi rrjet

elektrik të viteve '70, kemi shprehi të shpenzimit pa asnjë nevojë. Për këtë shprehi të shpenzimit për një kohë sa kam jetuar jashtë dhe kam studiuar, kam mund të shoh një vend shumë të pasur, shumë të pasur, të shoh shtëpi të cilat kanë nga një ose dy llamba në darkë të ndezura, aty ku lexohet dhe diku ku gatuhet, për deri sa te ne edhe në shtëpitë më të varfra ka shumë llamba të ndezura dhe me siguri se duhet pasur kujdes në të ardhmen edhe Qeveria dhe të gjithë ne që të fillojmë të punojmë në atë mënyrë, që të fillojmë të mendojmë se duhet kursyer jo vetëm për hir të xhepit tonë, por edhe për diçka më gjerë.

Tani po provoj të kthehem te ligji pak. Ky ligj e shpjegon karakterin qeverisës, sikur edhe shumë ligje tjera, domethënë një karakter shumë interesant qeverisës. Për shembull, Qeveria e Kosovës, e njëjta Qeveri ka provuar ta rrisë afatin e vjetërsisë së veturave të importuara dhe në të njëjtën kohë na sjell para nesh Ligjin për eficiency e energjisë. Në të njëjtën Qeveri, do të thotë, të njëjtit njerëz, në të njëjtën tavolinë i bëjnë dy punë që janë në kolizion me njëra tjetrën për shkak se eficiency e energjisë nuk ka të bëjë vetëm me energjinë elektrike, ka të bëjë edhe me energji tjera, me forma tjera të energjisë, energjinë fosile, derivatet e naftës, energji janë ato. Do të thotë, prapë është qëllimi çka po synohet, çka ka synuar Qeveria kur e ka sjellë këtë ligj par anesh? A ka dashur vetëm ta ngarkojë Kuvendin e Kosovës, të na bëhen nja 120, 130 ligje përpara nesh, duke e ditur që nuk ka shans të funksionojë, që nuk ka shans të implementohet hiq, apo çka është synimi. Qysh mundet Qeveria në të njëjtën kohë të synojë eficiency të energjisë dhe të njëjtën kohë të marrë veprime konkrete të cilat janë absolutisht kundër cilësdo formë të arritjes së eficiency së energjisë.

Çështje tjetër që tregon karakter qeverisës është puna pa strategji, do të thotë puna totalisht e pa koordinuar. Qe po ju tregoj pse.

Këtu thuhet se duhet të ndërtohet një agjenci, agjenci për eficiency e energjisë. Është punë e mirë, në rregull, edhe ne pajtohemi që ajo agjenci të themelohet, mirëpo kurrkund nuk thotë kur, edhe nuk mundet të thotë kur se në buxhet të këtij viti nuk është paraparë. Do të thotë, Qeveria e sjell një grumbull të ligjeve dhe nuk i merr masat tjera që e mbështesin aprovimin e atij ligji. Do të thotë, po supozojmë që nesër në mëngjes ky ligj ka për të qenë i aprovuar në parim, mbas nja një muaji aprovohet në lexim të dytë, e nënshkruan presidentja jonë e dashur, hyn në fuqi. Kur implementohet, kur këtë vit nuk është paraparë buxheti për këtë ligj. Domethënë, kjo strategji që quhet strategji legislative nuk është hiq strategji, është një grumbull i ligjeve që na vjen neve dhe na quhet strategji. Edhe unë duhet t'i pyes deputetët e Kuvendit të Kosovës, e di që disa mërkiten shpesh t'i pyesim, a është kjo mënyra qysh udhëhiqet një shtet normal, modern? Kurrkush nuk e di çka po vjen në Kuvend. Kurrkush nuk e pyet njëri - tjetrin a keni mund të koordinoheni, a kemi mund të bini dakord ne të udhëheqim shtet, që nuk është bash lehtë dhe prapë vi te ajo pika, të them - po ndoshta s'po dinë të udhëheqin shtet hiq, se krejt çka vjen, është në kolizion me diçka tjetër që ka ardhur, kurrgjë nuk është e koordinuar dhe na lodhemi këtu, djersitemi duke kaluar ligje, na bëhen 100 e sa ligje, nuk mundemi t'i përmbysim ose ta përmbushim agjendën legislative për shkak se Qeveria veç na i bien ligjet dhe vetë e di që nuk mundet t'i implementojë. E, mo zo më keq, nëse e di që s'mundet t'i implementojë, domethënë s'ka proces të menduarit fare.

E thashë, vetëm kërkohet themelimi i agjencisë, kurrkund nuk shkruan kur mundet të themelohet, kur të donë. Flet për rolin e komunave në efikasitet të energjisë, me siguri që kanë rol komunat, por ajo duhet të jetë pjesë e strategjisë e jo e ligjit. Më së pakti komunat mund të merren me një çështje që është puro nacionale, për shkak se nëse komunave, 30 e sa komunave në Kosovë, iu lihet mundësia për t'u marrë veç e veç me elemente të strategjisë së efikasitetit të energjisë, mund ta marrin me mend që ka për të pasur dallime shumë të mëdha në Kosovë dhe kjo për shembull e prishë në njëfarë forme gati solidaritetin, se diku duhet për të dhënë më shumë mjete e diku duhet dhënë më pak mjete.

Thuhet që nuk ka kosto! Veç po ju them unë diçka për punë të kosto. Janë diku nga 500.000 shtëpi në Kosovë që duhet t'u ndërrohen dritaret, për shkak se janë dritaret e viteve '60 dhe '70. Çfarë efikasiteti flasim na nëse nuk duam t'i ndërrojmë dritaret. Janë diku nga 300.000 shtëpi të pa suvatuara. Ajo është kosto nacionale. Jemi kah flasim për rrjet elektrik që duhet të ndërrohet, edhe ajo është çështje nacionale. Do të thotë, po flasim për një kosto e cila nuk do të thotë eminent që të jetë kosto buxhetore. Është një kosto nacionale. Edhe dikush mund të thotë, po këto punë vijnë, ok, vijnë, por ne duhet ta dimë kur implementohet ligji. Ku jemi, cili është synimi, sa vjet na duhen neve për t'u përafuar, të paktën, me standarde të Unionit Evropian.

Dikush duhet për të thënë, nëse nuk shkruan në ligj, atëherë ne duhet të shohim prej Qeverisë që ministri kur të dalë para nesh, ka menduar, na tregon gjendjen, na tregon vizionin ku do të mbërrijë dhe qysh dhe kur. Ne nuk po i dëgjojmë asnjëherë këto.

U tha, edhe e fundit, u tha reduktimi i shpenzimit të energjisë. Tani prapë ne duhet të dëgjojmë se po flasim për reduktim relativ të energjisë, se reduktimi absolut është gabim. Ne absolutisht duhet ta rrisim shfrytëzimin e energjisë për shkak se s'kemi industri. Paramendoni ju nëse ne duam ta rrisim punësimin në Kosovë, duam të hapim fabrika, uzina tjera të cilat kanë për të punuar dhe kanë për të punësuar njerëzit. Qysh të reduktohet shpenzimi i energjisë, domethënë, shpenzimi i energjisë ka për t'u rritur në Kosovë, e shpenzimi relativ për të cilin po flasim, do të thotë shpenzimi për aut-put, shpenzimi qoftë për 100 kilometra udhë që e bën një veturë, qoftë për ngrohjen e një shtëpie normale për kokë banori, e patëm regjistrimin, njerëzit frikoheshin edhe të tregojnë sa metra katrorë i kanë, duke kujtuar se mos po u lypin taksat. Këtë shpenzimin relativ, për ta reduktuar, ky ligj nuk po na ofron neve diçka konkrete të prekshme, që ne ta kuptojmë që po arrijmë deri aty, dhe në të njëjtën kohë për shkak se ligji ka ardhur në këtë kohë, për shkak se ligji ka ardhur absolutisht i pa harmonizuar me aspektet tjera legjislative në Kosovë, me buxhetin e Kosovës, me planin afatmesëm të shpenzimeve, me kurrfarë plani nuk është i harmonizuar, neve na bën të kuptojmë se ky ligj ka ardhur vetëm sa për t'u plotësuar një kriter, i cili kriter vetëm në fillim të vitit tjetër dikush ka për t'i thënë prapë Qeverisë së Kosovës, ju po e plotësoni një kriter, po e hartoni një ligj, po e kaloni një ligj në Kuvend të Kosovës, po ai ligj nuk ka shans të implementohet se nuk keni bërë kurrgjë tjetër që i ndihmon plotësimin të këtij ligji.

Sidoqoftë, për shkak se ne nuk dëshirojmë që të jemi pengesë në nisjen e këtij procesi të rritjes së efijencës së shpenzimit të energjisë në Kosovë, ne do ta aprovojmë ligjin, në parim, me siguri që do të provoim edhe në komision funksional dhe në komisione tjera që do ta shqyrtojnë, që të japim kontributin tonë, ama bindja fillestare është se kjo, ky ligj, kjo mënyrë tregon se për çfarë botëkuptimi kemi të bëjmë, për çfarë qeverisje kemi të bëjmë dhe për çfarë kulture të kalimit prej një gjendje në gjendjen tjetër, domethënë është njëfarë forme prapë se prapë kamuflim dhe kurrjë më tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për dy ministrat dhe të gjithë të pranishmit që janë sot në sallë!

Duke marrë parasysh se Projektligji për efijencën e energjisë ka qenë edhe në mandatin e kaluar, por për arsye politike të cilat ndodhën, ngeli në komisionin parlamentar. Mund të themi se projektligji është në vazhdimësi të projektligjeve të pakos së energjisë, e cila duhet të kompletohet për arsye të marrëveshjes së Traktatit të energjisë dhe duhet t'i plotësojmë konditat në të cilat BE-ja do që Kosova t'i ketë në zhvillimin e sektorit të energjisë.

Është më se e qartë se kemi probleme në aspektin e sektorit të energjisë dhe është shumë e qartë se do të jetë edhe problem implementimi i Projektligjit për efijencën e energjisë, kur dihet se vetëm konditat e BE-së janë që të kemi 20% të efijencës së energjisë, mirëpo duke marrë parasysh se Kosova është në fazën e zhvillimit ekonomik, ajo shkon në bazë të zhvillimit të një shteti, mund të arrihen edhe konditat për efijencë të energjisë.

Në Grupin Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re është shqyrtuar Projektligji për efijencën e energjisë dhe duke marrë parasysh se është një nga konditat, thashë edhe pak më parë, që duhet të plotësojë Kosova për këtë projektligj, mund të them se kemi vërejtjet si grup parlamentar, kemi vërejtjet dhe sugjerimet tona në këtë projektligj dhe do të japim mundësinë më të madhe që gjatë amendamentimit të projektligjit të merren parasysh rekomandimet tona, ndërsa çështja e Agjencionit të Efijencës së Energjisë në shumë vende të rajonit këto janë edhe agjencione të pavarura, do të thotë mund të jenë brenda ministrisë, por mund të jenë edhe jashtë ministrisë, për arsye se mund të financohen edhe prej donacioneve të BE-së, mirëpo edhe një herë potencoj që në bazë të zhvillimit ekonomik të një shteti shkojnë edhe konditat për efijencë të energjisë.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah në parim projektligjin dhe shpreson që gjatë amendamentimit të gjitha sugjerimet do të merren parasysh. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poslanička grupa Samostalne liberalne Stranke razmatrala je Nacrt zakona o efikasnosti energije i u načelu će podržati Nacrt zakona, sa napomenom da se određeni nedostaci

otkloniti u daljem radu funkcionalnih komisija, kao i radnih grupa koje će Nacrt zakona finalizirati i kasnije nadamo se da će se zakon primeniti u praksi. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Enis Kervan!

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuar nenkryetar!

Yasa Tasarısının amacı enerjinin verimliliğini artırmayı hedefleyen vasal ve kurumsal enfastrüktürünün belirlenmesi ve pratikte uygulamasını sağlamaktır. Bu yönde Avrupa Birliğinin önceliklerinden birisi ülkenin kalıcı iç enerji piyasasını sağlamaktır. Bundan başka Avrupa Birliğinin sedefi enerji sektöründe pıkası rekabetinin uygulanması, tüketicilere rekabetli fiyatların teklif edilmesi, saf enerji pretiminin körüklenmesi, güvenli, tedarik ve enerji verimliliğinin artırılmasıdır.

Taslağı uyarırken bir de uyarımız mevcuttur. Kosova Hükümetinin Çalışma Grubunda maalesef topluluk sıralarından hiçbir üyenin olmayışı, yine gündemdedir, dolayısıyla bu durumun tekrarlanmamasını talep eder ilerde de diğer yasalarda aynı sorunla karşı karşıya gelmemeyi ümit ediyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare u deklaruan të gjithë. Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Justina Pula. Mikrofonin, regjia, deputetes Pula!

JUSTINA PULA: I nderuar kryesues,
Ministra,

Të nderuar deputetë,

Efiçienca e energjisë nuk mund të lihet si proces kombëtar. Është koha që Kosova të ketë një ligj, kornizë për fushën e efiçiensës, ashtu siç e kanë të gjitha vendet për rreth dhe shumica e vendeve të BE-së.

Rritja e efiçiensës së energjisë është një domosdoshmëri për ekonominë dhe sipas disa caqeve të caktuara, është edhe një obligim ndërkombëtar që rrjedh nga Traktati për komunitetin e energjisë.

Ky ligj synon të krijohet infrastruktura e nevojshme ligjore dhe institucionale për caktimin dhe përmbushjen e caqeve nacionale për përmirësimin e efiçiensës së energjisë në Kosovë.

Elementet më të rëndësishme të këtij ligji janë krijimi i Agjencionit të Kosovës për efiçiençën e energjisë dhe caktimi i detyrave dhe obligimeve të institucioneve relevante qeveritare dhe komunale.

Ky ligj parasheh edhe formimin e zyrave komunale për energji, siç ato tashmë janë të definuara në planin nacional për eficiencën e energjisë.

Sa për informim, nga Komisioni Evropian dhe zyrat e ndryshme të ambasadave janë bërë trajnime të ndryshme në zyrat komunale me stafin përkatës që do të kontribuojë në formimin e këtyre zyrave.

Ligji rregullon edhe themelimin e profesionit dhe shërbimeve të auditimit të energjisë, të domosdoshme këto për t'i identifikuar masat më ekonomike që duhet të zbatohen konkretisht në secilin objekt për të kryer apo kursyer energjinë.

Ligji obligon vendosjen e bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel qendror dhe lokal, parakusht ky për të zhvilluar eficiencën dhe arritur caqet e parapara për eficiencën e energjisë për të cilat jemi të obligueshëm edhe nga Bashkimi Evropian në kuadër të traktatit për komunitetin e energjisë.

Ky draft ligj do të ishte më i plotë nëse në të do të përfshihet edhe fondi për eficiencën e energjisë, ashtu siç e kanë shumica e vendeve në rajon. Prandaj propozoj të gjenden mundësitë dhe përkrahja financiare që fondi për eficiencën e energjisë të parashihet në këtë ligj.

Ky ligj është mjaft i rëndësishëm jo vetëm për efikasitet dhe kursim të energjisë elektrike por edhe për zhvillim ekonomik në tërësi dhe si të tillë duhet të përkrahet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqenëse po flasim për këtë, shpresoj se ministria përkatëse dhe bordet përkatëse do ta kenë parasysh eko-sistemin e Kosovës, sepse nuk është në pyetje vetëm shfrytëzimi i pasurive për të prodhuar energji elektrike, por ka edhe tjera çështje që duhet t'i kemi parasysh edhe këto standardet e komunitetit evropian. Domethënë, unë di disa raste që në emër të prodhimit të energjisë është duke u shkatërruar eko-sistemi. Në vende të caktuara, për ta shfrytëzuar janë prishur resurse turistike shumë të rëndësishme, të karakterit shumë të rëndësishëm në Kosovë, prandaj mendoj që para se të revoltohen ata që duhet të revoltohen për këto ngjarje, duhet që ministritë përkatëse ta kenë parasysh këtë dhe të mos lejojnë që turizmi, që eko-sistemi në Kosovë të shkatërrohet për shkak se dikush u dashka fituar pak para me prodhimin e një ose dy megavateve energji elektrike. Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni t'i falënderoj të gjithëve për sugjerimet dhe komentet të cilat i keni dhënë. Siç u tha edhe më herët ky ligj ka qenë edhe më herët në Kuvend dhe nuk ka kaluar për shkak se është ndryshuar struktura, është bërë leximi i parë një herë, ku janë paraqitur shumë rekomandime të cilat unë i ftoj grupet parlamentare dhe komisionet funksionale që të japin vlerësimet e tyre në mënyrë që të pasurojmë ligjin, që ligji të jetë konform standardeve tona, por gjithmonë në harmoni... Unë nuk e thash rastësisht harmonizimin dhe përafrimin me legjislacionin evropian sepse kur flasim për harmonizim është diçka

tjetër, kur flasim për përafrim është diçka tjetër dhe ligji tenton të përafrojë legjislacionin tonë me atë të Unionit Evropian.

Ligji është harmonizuar me të gjitha ligjet tjera. Nuk ka asnjë kolizion me asnjë ligj qoftë në nivel vendor qoftë në nivel ndërkombëtar. Ligji është analizuar mirë edhe me traktatin e energjisë dhe është një model ligji qysh e kanë vendet tjera të rajoneve tjera, normalisht secilin ligj e përcjellin akte të tjera nënligjore që rregullojnë çështje konkrete. U përmend çështja e agjencisë se kur do të aktivizohet. Ligji thotë, do të hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit dhe realisht agjencioni kërkon angazhim të drejtpërdrejtë, pra parashihet edhe me ligj kur funksionon dhe nëse e kemi shikuar në shpjegim të ligjit, në memorandum shpjegues që e kemi dërguar, do të thotë aspektet financiare të këtij ligji ndërlidhet me atë se është marrë obligim nga departamenti ekzistues dhe nga institucionet brenda për brenda të punësohen njerëzit, pra nuk ka pasur qëllime punësimi ashtu qysh nganjëherë po pretendohen për të kaluar.

Unë me të vërtetë i mirëpres njerëzit që pretendoj në që kanë njohuri nga të gjitha fushat por kisha dashur që ta lidhim një ligj dhe ai ligj është për eficiencën e energjisë. Nuk flasim për prodhim të energjisë, nuk flasim pra as për distribuim, as për gjenerim, por flasim për eficiencë të energjisë dhe të shfrytëzimit. Dhe duhet ta dimë dallimin tash këtu, kur flasim për sektorin privat, kur flasim për shtëpia, për izolime, për dritare, për vetura. Po them, unë i admiroj të gjithë ata të cilët pretendojnë që të jenë ekspertë të gjitha lëmive por ju kisha ftuar që të jemi konkretë për gjëra të cilat i flasim. Prandaj, në këtë drejtim ligji si ligj është në harmoni me të gjitha standardet dhe i mirëpresim të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet të cilat përmirësojnë cilësinë e ligjit dhe përmirësojnë edhe plotësimin e kushteve tona të cilat neve i kemi marrë si obligim nga traktati i energjisë dhe normalisht duke qenë pjesë e komunitetit të energjisë në nivel të rajonit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur të tjerë. Pas ministrit, jo! Aha, replikë! Në paç replikë, po! Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Fola me qëllimin më të mirë. Definitivisht, se si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe si kryetar i Grupit Parlamentar kam mundësi të flas çka dua dhe s'ka kush të më kallëzojë çka të flas. Dhe tjetra, kam edhe edukim formal për këtë punë, t'ia përkujtoj ministrit dhe, e treta, nëse eficiencë nuk është racionalizimi i asaj që prodhohet dhe asaj që shpenzohet për të arritur një çështje që do të thotë edhe izolim, edhe dritare, edhe rrjet, edhe vetura të këqija, e kisha lutur ministrin, meqenëse është super-ekspert, të dalë e të na shpjegojë çka do të thotë eficiencë atëherë, për çka e ka fjalën, nëse nuk është kjo për çka fola unë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Unë prapë e admiroj, do të thotë edhe referimin në referenca profesionale, do të thotë, kisha dashur të di cili është edukimi formal i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë e adreson çështjen e eficiencës. Unë po flas me kompetencë si ministër, si

krijues i kësaj politike, në fushën e eficiencës së energjisë dhe ajo nënkupton përdorim racional të energjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Vazhdojmë deklarinimin me votim për miratimin në parim të Projektligjit për eficiencën e energjisë. Në mbledhje janë prezentë 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj se me 60 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë “abstenim”, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për eficiencën e energjisë elektrike.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Pauzë për drekë kemi deri në orën 14:30, apo deri në 15:00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë e deputete,
Po vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës, që është:

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Qeveria e Kosovës ia ka parashtruar Kuvendit Propozim-vendimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni funksional për Legjislacion e ka shqyrtuar Propozim-vendimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është! Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, nëse dëshiron të deklarohe lidhur me propozimin e Qeverisë. Fjalën, deputetit Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Propozim-vendimin dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë, sepse kandidati i propozuar ka punuar edhe më herët në Institutin Gjyqësor dhe i është propozuar Kuvendit që t’i vazhdohet mandati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani sipas radhës, kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, sikur edhe Komisioni, ka vlerësuar shkallën e arsimimit, performancën e tij në punën e deritashme dhe pajtohet që t'i vazhdohet edhe në këtë mandat kandidatit të propozuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj! Nuk është! Atëherë, kush e do fjalën, Arbeni, Lutfia...? Arben Gashi e merr fjalën!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet kandidaturën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar i AAK-së, nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet kandidaturën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Parlamentarna grupa SLS podržava isto kandidaturu kandidata.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "6+", nuk ka të paraqitur. Deputetë tjerë nuk ka.

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Propozim-vendimit për emërimin e zotit Bedri Bahtiri, anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Atëherë, vazhdojmë debatin për ligjin tjetër. Nuk kemi kuorum të duhur, po i debatojmë edhe pikat tjera, pastaj votojmë në fund nëse bëhen deputetët.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010

Komisioni funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Idriz Vehapi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62 pika 1, 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datën 11.05.2011, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2010.

Komisioni ka vlerësuar se raporti vjetor i punës i parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Komisioni për Buxhet? Nuk e dëshiron fjalën!

Tani kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve. Në emër të PDK-së, prapë Idriz, a e do ti fjalën, apo dikush tjetër? Atëherë, deputetja Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të bëjë një analizë të këtij raporti, ndjej obligim që si deputete dhe anëtare e këtij komisioni të përgëzoj hartuesit e këtij raporti për një punë profesionale dhe një hartim objektiv të këtij raporti, me çka ne si deputetë na bëjnë të mundur të njihemi shumë më objektivisht rreth punës së tyre.

Raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010, pasqyron gjendjen reale në Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Ky raport paraqet shumë qartë të arriturat dhe sfidat në Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur ka qenë në nivelin e kryerjes së detyrave që i ka në mandatin e tij, me përqendrim të theksuar në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civilë, aplikuesve për punësim në Shërbimin Civil dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Po ashtu, Këshilli ka pasur angazhim dhe përkujdesje të shtuar në sforcimin e idesë për një shërbim civil të pa ndikuar, të pa anshëm, profesional, të përgjegjshëm, me qëllim të krijimit të një administrate funksionale dhe efikase.

Raporti paraqet progresin e dukshëm në zbatimin e legjislacionit të ri për shërbimin civil, por edhe dinamikën e ngadaltë të nxjerrjes së akteve përcjellëse në zbatim të këtij ligji nga ana e MAP-it – Ministrisë së Administratës Publike.

Edhe pse gjatë vitit 2010, me mbështetje të misionit të OSBE-së në Kosovë ka mbajtur 11 seminare informative në 11 komuna të Kosovës, mungesa shihet tek sensibilizimi i organeve të punësimit dhe nëpunësve civilë lidhur me Ligjin për shërbimin civil të

Kosovës dhe zbatimin në praktikë të tij, e veçanërisht ka mungesë informacioni për punën dhe përgjegjësitë e këtij këshilli.

Këshilli për herë të parë ka organizuar një konferencë për të shënuar ditën ndërkombëtare të Shërbimit Civil në Kosovë, ngjarje e cila është e përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-ës.

Të nderuar deputetë,

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në vitin 2010 ka pranuar 290 ankesa, ndërsa ka shqyrtuar dhe vendosur 384 ankesa, që do të thotë 94 ankesa nga viti i kaluar. Por, problemi qëndron te mos ekzekutimi i disa vendimeve të Këshillit nga ana e disa organeve të punësimit, përkundër që kanë obligim ligjor ta bëjnë një gjë të tillë, institucioneve të cilave u janë dërguar rekomandime kanë treguar neglizhencë dhe pa përgjegjësi në zbatimin e tyre por edhe njoftimin mbi zbatimin e tyre.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky këshill duhet të përkrahet nga ne si Kuvend, duke vëzhguar kryesisht procesin e implementimit të vendimeve të tij deri në fund.

Në raport vërehet se Këshilli ka mungesë të hapësirës adekuate dhe buxhet të pamjaftueshëm për të stimuluar efektshëm anëtarët e tij dhe besoj se këtu duhet ne të fokusohemi tek përkrahja e tyre.

Raporti është i hartuar në formë dhe përmbajtjen që përfshin realitetin e shërbimit civil të Kosovës por sfida më e madhe mbetet mosekzekutimi i vendimeve, pra në vitin 2010 kanë mbetur pa u ekzekutuar 38% të vendimeve të tij.

Këtu vërejtja nga Këshilli adresohet në shumicën e rasteve gjykatave supreme të cilat duke e shpallur veten jo kompetente këto vendime i procedojnë në gjykatat komunale.

Duke dashur që vërtetë ky institucion të mbetet siguri i një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të pa anshëm, me vërejtjet që i kemi dhënë në Grup, ne si Grup Parlamentar në Komision, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike vlerëson pozitivisht përkushtimin e tij në këtë fazë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ne në Grupin Parlamentar të LDK-së po edhe në shqyrtimet paraprake edhe në komisionin funksional e vlerësojmë që ky raport dëshmon rritjen e intensitetit të punës pranë këtij këshilli me vetë faktin e shqyrtimit të 290 lëndëve të aplikuara në vitin 2010 dhe 94 lëndë nga viti paraprak, por inkurajojmë vetë Komisionin që të zhvillojë një transparencë më të fuqishme në rritjen e besueshmërisë në raport me institucionet për të

dëshmuar se ky këshill punon në mënyrë profesionale dhe ka një qasje objektive në trajtimin e lëndëve.

Ajo çka është shqetësuese, duke marrë parasysh se vendimet e Këshillit janë të obligueshme që të zbatohen nga organet punëdhënëse në shërbimin civil, konform nenit 13 të Ligjit Numër 03/192 dhe duke marrë parasysh se vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë, ndërsa po të shikojmë në faqe 27 figura numër 9 ku del – pasqyrohet se diku rreth 40% të lëndëve nuk janë implementuar, është shqetësuese.

Unë mendoj se të gjithë duhet të angazhohemi që diçka të bëhet në atë drejtim ose që ajo të azhurohet dhe gjithë përgjegjësit duke filluar nga kryeministri, ministritë, komunat, agjencionet që të kryejnë obligimet e tyre që lëndët të implementohen ndërsa të gjitha palët e interesuara që nga kontesti administrativ të kalojnë në procedura gjyqësore ato mund të bëhet, por nuk mund të shtyhet implementimi i vendimit, ose nëse vërehet që kjo fushë nuk po rregullohet mirë kështu siç është sepse kjo është shifër alarmante atëherë duhet të draftohet ligji dhe të parashikohen sanksione shumë konkrete për ata që nuk i zbatojnë. Dhe unë kam një bindje se vetë ky fakt që nuk po implementohen këto lëndë dhe palët janë në situata shumë të vështira që pas vendimit të Këshillit shëtitën me muaj të tanë poshtë e lartë duke i shqetësuar edhe familjet e tyre dhe duke krijuar një imixh jo të mirë për punën e institucioneve detyrohen që të vazhdojnë me procedura gjyqësore me muaj të tanë, mos të them ndoshta edhe me vite për ta fituar një të drejtë që veç e ka fituar në shkallën paraprake. Dhe sigurisht kjo ndikon që nga 384 lëndë vetëm 139 janë hedhur poshtë, pra janë vlerësuar pozitivisht 116 pjesërisht 15 dhe shtrohet pyetja që pse është një numër kaq i madh i lëndëve që aplikohen, pra që 290 lëndë brenda një viti është shumë që nënkupton se ose nëpër komuna, nëpër institucione, nuk është zhvilluar mirë performanca e zyrtarëve dhe pastaj ata i nënshtrohen një vendimi ad-hoc aty për aty të eprorëve të tyre duke marrë parasysh se akoma thuaja në shumicën e institucioneve nuk kemi të zhvilluar as gjysmën e indikatorëve të performancës apo eventualisht duke pa këtë gjendje edhe zyrtarët mund të mos përfillin obligimet dhe përgjegjësitë.

Prandaj, jemi të mendimit që ne për këtë fazë të përkrahim këtë raport si të tillë por njëkohësisht kërkohet nga ky këshill që sipas detyrës zyrtare ta zhvillojë një koncept shumë më të fuqishëm në parandalimin e gjitha këtyre dukurive që ata momentalisht i kanë gjet në raportin e tyre.

Shpresojmë se herën tjetër të gjithë pra, ata që kanë obligime në bazë të këtyre vendimeve por edhe vetë Këshilli do të na e dërgojnë një raport i cili do të shënojë një progres shumë më të fuqishëm të Kosovës në këtë fushë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” deputeti Afrim Kasolli, më duket!

AFRIM KASOLLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar me vëmendje raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe si të tillë kjo lëvizje e përkrah

në parim këtë raport. Megjithatë, kjo lëvizje ndan disa shqetësime serioze në lidhje me aspektet përmbajtjesore të këtij raporti dhe çështje që raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës adreson.

Fillimisht, raporti konstaton se nëpunësit civilë nuk rekrutohen gjithherë sipas procedurave të ndershme dhe meritës, avancimi nuk bëhet sipas meritës dhe procedurave, vlerësimet e performancës vjetore nuk bëhen gjithherë në mënyrë objektive, kontratat e punës, shkresë emërimi nuk lëshohen dhe përtërihen në kohëzgjatje në pajtim me ligjin.

Mendoj dhe konsideroj se pikërisht ky konstatim në mënyrë të qartë madje e demanton edhe përgjigjen e mëhershme të ministrit të Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, kur iu përgjigj deputetit Liburn Aliu se ai nuk është përgjegjës për shërbyesin civil Kushtrim Haliti pasi kjo çështje, sipas tij, nuk është kompetencë e organeve të tjera, sepse vetë raporti në fjalë tregon pikërisht të kundërtën, se rekrutimi i shërbyesve civilë në Kosovë në vend të meritokracisë bëhet mbi logjikën e partitokracisë, familjarizimit, nepotizmit dhe kështu i shndërron institucionet tona në bastione të klanizmit.

Po ashtu, në Këshill thuhet, ndonëse është obligim ligjor që me rastin e zgjedhjes së këtyre drejtorëve të marrin pjesë si vëzhgues anëtarët e Këshillit, ka institucione të cilat nuk e kanë respektuar bazën ligjore dhe kanë bërë zgjedhjen e nëpunësve civilë drejtues pa pjesëmarrjen e Këshillit, të kësaj natyre dhe ka raste për mosgatishmërinë për bashkëpunim nga ana e zyrtarëve të nivelit të lartë drejtues.

Megjithatë, raporti ndoshta këtu ka një hendikep se nuk tregon me shifra sa herë nuk janë lejuar që përfaqësuesit e Këshillit të vëzhgojnë procedurat e zgjedhjes së nëpunësve të nivelit drejtues pa pjesëmarrjen e Këshillit, sepse ai tregon vetëm sa herë janë lejuar, për shembull zyra e kryeministrit një herë, dhe besoj se gjatë gjithë vitit 2010 nuk ka ndodhur vetëm një emërim i shërbyesve civilë në zyrën e kryeministrit. Pra, vetëm në këtë mënyrë kur tregohet edhe sa herë nuk janë lejuar, vetëm mbi këtë bazë do të mund të krijohej një gjykim objektiv për abuzimet dhe jo transparencën e këtij procesi.

Paradoksalisht, po ashtu ky këshill informon edhe kryeministrin edhe Kuvendin e Kosovës lidhur me mos zbatimin e vendimeve të Këshillit për secilin institucion veç e veç që nuk i zbaton vendimet e tij, por çuditërisht reagimet mungojnë.

Përfundimisht, ne ndajmë brengën me sfidat që i adreson Këshilli, ku si çështje kryesore mbetet mos ekzekutimi i vendimeve të Këshillit. Prandaj, në parim e përkrahim raportin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar AAK, deputetja Time Kadrijaj. Urdhëroni, kush? A, Teuta Haxhiu. Atëherë, më falni, nuk e vëreja. Po, paraqituni me shkrim, në emër të Grupit, të paktën njerëzit që duhet.

TEUTA HAXHIU: Ka nevojë për t'i deponuar më herët, ndoshta!

Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht, edhe ne si Grup e përshëndesim ekipin që ka punuar në këtë raport, mirëpo se ka shumë gjëra për t'u diskutuar lidhur me këtë raport, do të shohim që me pak fjalë i kemi përmbledhur edhe ne këtu.

Është një thënie në fillim, një shërbim civil i pavarur profesional dhe i qëndrueshëm është garanci e fuqishme e funksionimit të shtetit, pavarësisht rrethanave dhe situatave të ndryshme. Kjo do të duhej të ishte, por se nuk është, e tregon edhe vetë raporti.

Këshilli gjatë kryerjes së funksioneve të tij për periudhën raportuese përmes shërbimit të ankesave dhe të nëpunësit civil dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil ka konstatuar se ende nuk është arritur profesionalizmi i duhur, pa anshmëria, respektimi i kodit etik, si dhe respektimi i procedurave të ligjit.

Nga shqyrtimi i ankesave të nëpunësve civilë, të aplikuesve për punësim konstatohet se nëpunësit civilë nuk rekrutojnë gjithherë, avancimi nuk bëhet sipas meritës dhe procedurave, vlerësimet e performancës vjetore nuk bëhen në mënyrë objektive, kontratat e punës nuk lëshohen dhe përtërihen me kohëzgjatje në pajtim me ligjin.

Në raport konstatohet se zyrtarët e lartë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit kanë treguar neglizhencë dhe pa përgjegjësi në zbatimin e vendimeve të Ligjit, gjë që në pajtim me nenin 15 paragrafi 1 dhe paragrafi 5 i po këtij neni, vetë Këshilli ka raportuar rregullisht edhe te kryeministri edhe në Kuvendin e Kosovës, por pa përgjigje.

Gjatë vitit 2010, në Këshill kanë arritur 290 ankesa, ashtu sikur e thanë edhe parafolësit dhe këto ankesa, unë po i përmend vetëm në ndërprerje të kontratës të punës janë gjithsej 86 ankesa ose 29.65%. Për fat të keq, në këtë raport vërehet shumë qartë se numri më i madh i ankesave vijnë nga Ministria e Drejtësisë, nga një ministri e cila do të duhej të reflektonte një drejtësi dhe pikërisht aty janë ankesat më të mëdha që paraqiten tek ministrinë.

Në raport konstatohet se nuk janë ekzekutuar 61 vendime të Këshillit nga 152 ankesa të aprovuara. Athua, vendimet e Këshillit nëse nuk aprovohen, ku do të drejtohen vetë shërbyesit civilë kur kanë pse të ankohen. Vendimet e Këshillit janë të obligueshme të ekzekutohen nga organet punëdhënëse në Shërbim civil të Kosovës që në bazë të nenit 13 të Ligjit për Këshillin vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë.

Sipas nenit 13 të Ligjit për Këshillin, përgjegjës për zbatimin e vendimeve janë sekretarët e përhershëm të ministrive, kryeshefat ekzekutivë të agjencioneve dhe institucioneve të pavarura, kryetarët e komunave dhe përgjegjësit kryesorë të organit punëdhënës të punësimit.

Kur jemi te vlerësimi i ligjit, Këshilli ushtron funksion mbikëqyrës në bazë të nenit 10, paragrafi 3 dhe neni 7 të Ligjit për Këshillin, duke u bazuar në parimet e Ligjit për shërbimin civil të Kosovës.

Këshilli gjatë vitit 2010, nga vizitat në institucionet lokale, duke pasur parasysh se Ligji për shërbimin civil të Kosovës ka hyrë në fuqi në korrik 2010, lidhur me zbatimin e tij ka dhënë disa rekomandime. Shumica e institucioneve qendrore dhe lokale nuk kanë zbatuar plotësisht obligimin ligjor. Komisionet e rekrutimit nuk janë në përbërje të nivelit për postin e publikuar, rekrutohen kandidatë në kundërshtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të konkursit dhe të parimit të meritës, me rastin e rishpalljes së konkurseve shpesh ndryshohen kushtet e konkursit, që do të thotë iu përshtaten kandidatëve të caktuar, që parqet shkelje të parimeve udhëheqëse të shërbimit civil.

Gjatë monitorimit gjithashtu është konstatuar se pothuaj të gjitha organet e punësimit nuk kanë përfillur zëvendësimin e kontratave të punës me shkresë emërim, në pajtim me nenet 96 dhe 97 të Ligjit mbi shërbyesit civilë.

Në raport thuhet se shkak të mos zbatimit të ligjit kanë qenë paqartësitë e sponzoruesit, se a duhet me të vërtetë të zbatohet ligji para se të nxirren aktet nënligjore.

Një gjë që është shumë me rëndësi tek sfidat e së ardhmes, vetë Këshilli parasheh që në të ardhmen do të përballlet me shumë sfida pasi që në vitin 2010 është miratuar Ligji për shërbimin civil, i cili sigurisht do të ketë vështirësi ashtu sikur e parashohin edhe vetë shkruesit e këtij raporti, ngase kjo për shkakun e dinamikës së ngadaltë të nxjerrjes së akteve përcjellëse në zbatim të ligjit nga ana e Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal, në njërën anë, dhe mungesës së sensibilizimit të organit punëdhënës, nga ana tjetër.

Dhe, krejt në fund, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta përkrah në parim këtë ligj për vetë faktin se ky raport tregon një gjendje reale të shërbyesve civilë në Kosovë, por e ka një pyetje të madhe, a thua do të duhej të funksionojë ky këshill ashtu siç duhet apo duhet të diskutohet edhe një herë se a duhet të ekzistojë si këshill apo nuk duhet të ekzistojë për vetë faktin se diku 40% e vendimeve të këtij këshilli nuk janë ekzekutuar dhe atë e përmenda pak më herët, një numër i madh i tyre nga një ministri e drejtësisë që duhet të reflektojë drejtësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Raportin vjetor të vitit 2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe njëkohësisht ne e mbështesim këtë raport dhe kërkojmë që vendimet e Këshillit të ekzekutohen.

Gjithashtu, kërkojmë që të merren masa për institucionet që nuk i ekzekutojnë vendimet e Këshillit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!
Samostalna liberalna stranka će podržati godišnji izveštaj Nezavisnog nadzornog saveta za civilnu službu Kosova za 2010. godinu.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+” nuk ka! Atëherë, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Duke u nisur nga fakti se Shërbimi Civil i Kosovës si institucion shtetëror është i paraparë me Kushtetutën e Kosovës dhe është kompletuar legjislacioni me anë të të cilit është themeluar korniza ligjore sa i përket funksionimit të shërbimit civil të Kosovës.

Duke shqyrtuar raportin e tij për vitin 2010, mund të konsiderojmë se përkundër të arriturave të këtij institucioni shtetëror, ka mjaft ngecje sa i përket respektimit të Ligjit mbi shërbimin civil të Kosovës, e sidomos nga organet shtetërore të pushtetit, pra Qeverisë dhe komunave të Kosovës.

Nga vetë raporti shihet se këto organe, ministritë dhe komunat, nuk respektojnë vendimet që merren nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës duke ditur se këto vendime janë vendime administrative të formës së prerë dhe njëherësh janë të zbatueshme dhe se organet e përmendura janë të obliguara sipas ligjit t’i aplikojnë.

Në qoftë se qeveritarët, pra ministritë dhe komunat janë përplot gojë se duhet të respektohet ligji, atëherë duke u nisur nga faktet e theksuara në raport, mund të konstatojmë se pikërisht këto ministri dhe komuna janë përgjegjëse për mos respektimin e ligjeve në fuqi sa i përket respektimit të rendit ligjor në Republikën e Kosovës.

Mendoj se përgjegjësit që janë kompetentë për aplikimin e vendimeve të Këshillit, qofshin sekretarë permanentë, kryeshefa ekzekutivë, kryetarë të komunave, duhet të marrin obligimet dhe përgjegjësitë që u takojnë me rregullat e shërbimit civil, e në mosbindjen ndaj respektimit të ligjit, të merren masa të duhura lidhur me ndëshkimet e tyre sipas ligjit. Atëherë, shtrohet pyetja, nëse nuk respektohen vendimet e këtij këshilli, pse na duhet ky këshill. Pra, ky Kuvend ka për obligim që të kujdeset për ligjshmërinë në shërbimin civil në bazë të kompetencave që i janë dhënë me ligj.

Sipas raportit del se Këshilli me kohë ka njoftuar Kuvendin e Kosovës për moszbatimin e vendimeve të tij nga institucionet që duhet t’i aplikojnë ato, mirëpo si paraqitej situata, kjo gjendje po përsëritet çdo vit dhe vendimet e Këshillit nuk po zbatohen. Ky është një shqetësim për ne, si deputetë, dhe se vetë Kuvendi, sipas kompetencave ligjore të përcaktuara, nuk është i interesuar që të respektohet ligji ndaj atyre që u janë dedikuar vendimet e Këshillit.

Krejt në fund, do të doja të propozoja formimin e një komisioni ad hoc për gjendjen dhe masat që duhet të ndërmerren nga Kuvendi në mënyrë që vendimet e Këshillit të zbatohen plotësisht, në mënyrë që në të ardhmen të kemi një shërbim civil, ku vendimet e tyre të obligohen për të gjitha institucionet shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Janë disa çështje që lidhen me këtë organ. Duhet ta kuptojmë se KPM-ja e ka një lloj roli të dytësorit për shërbyes civilë. Është autoriteti më i lartë, është autoriteti final, i cili zgjidh problemet në raport me të drejtat e shërbyesve civilë si punëmarrës dhe punëdhënës, natyrisht, është organ që e ka miratuar Kuvendi, e ka emëruar Kuvendi përmes një procesi të fshehtë zgjedhor dhe organ i cili ka nevojë të ketë mbështetjen më të madhe të Kuvendit.

Moszbatimi i këtij vendimi dhe injorimi që i bëhet vendimeve të këtij organi është shqetësuese në Kosovë. Ose duhet t'i ndërtojmë kapacitetet monitoruese si Kuvend, në mënyrë që ta ruajmë pavarësinë e organit tonë dhe ta ndihmojmë zbatimin, ose duhet ta gjejmë një rrugë tjetër duke ndërtuar mekanizmat zbatues. Nëse autoriteti më i lartë është kryeministri, i cili duhet t'i detyrojë ministrinë e linjës dhe organizatat tjera buxhetore në kompetencë të këtij organi, atëherë sekretari shtetëror, sekretari i Qeverisë do të duhej seriozisht të qëndrojë prapa kësaj, në mënyrë që vendimet të jenë të zbatueshme.

Nuk është vetëm sektori i drejtësisë ose sektori i arsimit, sektori i shëndetësisë që ka probleme serioze dhe sektori i shërbimeve civile në nivel komunal. Largimet nga puna, suspendimet pa kurrfarë mbështetje ligjore kanë çuar në konstatim se ky organ se është shkelë e drejta e punëtorëve. Në këtë rast kemi punësime të dyfishuara, rritet kostoja buxhetore e Qeverisë, e buxhetit të Kosovës. Praktikisht bëhen komplikime të panevojshme në kuadër të moszbatimit të ligjit. Atëherë, edhe unë jam i mendimit që KPM-ja duhet të mbështetet më shumë, Kuvendi duhet t'i jep mbështetje, duhet ta monitorojë zbatimin e vendimeve në organizata buxhetore, ta rritë kujdesin dhe ta detyrojë zbatimin e vendimit dhe të kërkojë nga Qeveria që përmes sekretarit shtetëror vërtet të zbatohen vendimet e të mos lejohet që në rast se konstatohet që ka shkelje, të mos kthehet ligji në vend. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, të tjerë të paraqitur s'ka. Po meqenëse ka tani deputetë mjaft, në fillim po procedoj me votimin e pikës 7 të rendit të ditës, që është: - Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe pastaj me pikën 8.

Pra, në sallë janë 79 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj që me 73 vota "për", 2 abstenime, 2 "kundër", Kuvendi miratoi Vendimin për emërimin e zotit Bedri Bahtiri, anëtar i Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Vazhdojmë me votimin për pikën 8 të rendit të ditës, që është: - Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010.

Konstatoj që në sallë janë 79 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj që me 70 vota “për”, 4 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2010.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës, që është:

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Sipas radhës dhe Rregullores, ftoj kryetarin e komisionit funksional, zotin Zenun Pajaziti, për arsyetimin e Raportit me rekomandime. Deputetët Pajaziti, fjalën!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3.5.2011, shqyrtoi Raportin vjetor të punës, për vitin 2010, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe vendosi që t'i paraqesë këtë rekomandim Kuvendit që të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2010, i kësaj agjencie dhe kjo në pajtim me nenin 20 të Ligjit Numër 3/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Pra, Komisioni ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Komisioni për Buxhet e Financa, nuk ka të paraqitur. Kryetarët ose komisionet, ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zoti kryesues!

E kemi në dorë raportin vjetor të kësaj agjencie. Mund të thuhet që në mënyrë kualitative janë prezantuar të arriturat, angazhimet e këtij agjencioni. Po ashtu, dëshiroj të them që edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në një takim të radhës ka trajtuar, ka shqyrtuar këtë raport, i ka shqyrtuar në imtësi disa çështje që janë të ndjeshme edhe me procesin e privatizimit, funksionimin e kësaj agjencie, sfidat që paraqiten këtu, sfidat tjera në rrethanat e sotme e tjerë. Kryesisht nga ky raport mund të konkludojmë se

kemi një zhvillim pozitiv edhe në krahasim me aktivitetin paraprak, kur kjo agjenci ka qenë me kompetenca tjera dhe po ashtu me mandat tjetër.

Janë thënë në mënyrë të precizuar të gjitha aktivitetet. Kryesisht ajo që ne na intereson, është procesi i shitjeve, që kap vlerën mbi 500 milionë euro dhe po ashtu një proces i likuidimit me mbi 40 milionë euro, 75% të mjeteve të listës e 20% janë shpërndarë, që është po ashtu një proces pozitiv në krahasim me të kaluarën dhe zakonisht për këtë, gjithë këtë proces e kemi pasur në raportet tremujore një proces raportues të kësaj agjencie.

Ka edhe disa çështje që janë për t'u trajtuar, e që unë mendoj që deputetët veç e veç do t'i trajtojnë. Kemi pasur kryesisht shqetësimet rreth shpërndarjes së mjeteve, po ashtu krijimin e ndërmarrjeve të reja prej ndërmarrjeve shoqërore, që është një proces që kjo agjenci e ka trajtuar. Është inkurajues që është në proces pozitiv, siç thashë, shpërndarja e 20%. Ka një shkelputje të kontratës të komercializimit për shkak të shkeljes së kushteve të kontratës për disa nga ndërmarrjet dhe mendoj që ky është një proces i ri, kjo agjenci shton disiplinën dhe kryerjen e obligimeve të kompanitë përkatëse.

Sa i përket spinoofit special, është një dukuri që ka qenë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në statusin e mëhershëm ose në rrethana tjera. Tash kjo është ndërprerë dhe ka një disiplinë për kryerjen dhe marrjen e masave financiare ndëshkimore nga kjo agjenci, për vitin 2010 janë aplikuar disa raste dhe kjo është po ashtu inkurajuese dhe, siç kemi marrë informatë nga kjo agjenci, konsiderohet nga ta se do të ndikojë pozitivisht në kryerjen e detyrimeve nga disa kompani.

Po ashtu, çështje e veçantë në këtë raport është Trepça. Na i dimë rrethanat në të cilat funksionon kjo kompani. Agjencioni ka bërë një pjesë të veçantë të raportit për Trepçën, po ashtu edhe në rastet, takimet në komision i kanë treguar disa rrethana për çka është ky proces që ka ecë më ngadalë dhe një prej arsyeve kryesore që thuhet këtu, është përmendur në raport, është mungesa e Ligjit për dhomën e veçantë në Gjykatën Supreme. Mendojmë, po ashtu, e kemi trajtuar edhe si grup parlamentar, ne e mbështesim, e inkurajojmë Qeverinë që sa më shpejt ta sjell këtë ligj. Ka edhe në proces disa çështje kontestimore që e kanë penguar procesin e privatizimit dhe rrjedhimisht zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në vend. Ne konsiderojmë se ardhja sa më e shpejtë e këtij ligji do ta ndihmojë këtë agjenci dhe procesin e privatizimit në përgjithësi.

Pra, duke pasur parasysh të gjitha këto dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e kësaj agjencie në përgjithësi, duke filluar nga bordi e në përgjithësi të procesit të privatizimit, duke inkurajuar, po them edhe një herë, institucionin e Qeverisë që sa më shpejt të vijë me Ligjin për dhomën e veçantë, duke uruar që procesi të shkojë sa më shpejt në përgjithësi, ne si grup parlamentar do ta mbështesim këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Lutfi Zharku! Kryetari i Grupit ka bërë një propozim për diskutuesit dhe më kanë nxjerrë mua

tash në situatë lajthitjeje. Deputetja Teuta Sahatçija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari ministër,

Kolegë deputetë,

LDK-ja e ka analizuar Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010.

AKP-ja e themeluar më 2008 me Ligjin 03/L-067, është e obliguar sipas nenit 20.2 të sjellë në Kuvendin e Kosovës raportin vjetor për punën e saj, duke përfshirë pasqyrat financiare, llogaritë e saj, listën e ndërmarrjeve nën administrim, transaksionet e kryera gjatë vitit, ndërmarrjet e likuiduara, listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit.

Në raport huhet se viti 2010 ka qenë vit i suksesshëm për AKP-në dhe ka tejkaluar planin e biznesit.

Numri total i ndërmarrjeve deri më sot të privatizuara arrijnë 630 sosh dhe shihet se AKP-ja në bankë ka të vendosura asetet prej 500 milionë euro nga spin-offet dhe 28 milionë nga likuidimet e ndërmarrjeve, ndërsa këto asete ende qëndrojnë jashtë Kosovës dhe nuk zhvillojnë zhvillimin ekonomik të saj.

Trepça e cila vazhdon të jetë në borxhe ndaj operatorëve të rrymës, ujit e tjera, qysh nga koha e UNMIK-ut dhe është nën moratorium nga 2006, nuk lejohet shitja apo çfarëdo aktiviteti tjetër që tjetëron, por në të njëjtën kjo masë pengon edhe tërheqjen e investimeve. Presim të shohim rezultatet nga plani për ristrukturimin e Trepçës.

Në anën tjetër, Hajvalia, Badovci e Kishnica mbasin edhe sot të përmbytura në ujë dhe janë jashtë përdorimit.

AKP-ja në raport tregon veprime konkrete në lidhje me shkëputjen e kontratave të komercializimit për katër ndërmarrje dhe ndëshkime me vlerë prej 22 milionë euro për katër tjera, siç është hoteli “Grand”, Miniera e Goleshit, e Strezovcit, IDJ Tobako, për mospërbushjen e obligimeve kontraktuale për investime dhe për punësim.

Në raport përshkruhen ndërmarrjet nën administrim të drejtpërdrejtë, ku janë edhe shoqëritë aksionare të Gjakovës. Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me AKP-në ka lëshuar aktvendimin me 21 tetor 2010, për Shoqërinë aksionare “Jateks” dhe më 2 nëntor 2010, për Shoqërinë aksionare “Emin Duraku”, i cili aktvendim e ndalon AKP-në që të ndërmarrë çfarëdo veprimi për shitje apo formë tjetër për të ndryshuar pronësinë e aseteve, duke u bazuar në faktet, në lëndët që mbështesin kalimin në transformim nga ndërmarrja shoqërore, në shoqëri aksionare.

Ndërmarrjet e Gjakovës në të kaluarën kanë kontribuar në eksportin e Kosovës me rreth 100 milionë dollarë në vit. Kërkojmë që sa më shpejt të definohet dhe të respektohet statusi i shoqërive aksionare, të cilat e kanë kryer transformimin nga

ndërmarrjet shoqërore, në shoqëritë aksionare dhe të mundësohet që këto shoqëri aksionare, më në fund të funksionalizohen dhe të marrin për sipër kontributin në zhvillimi ekonomik dhe në punësimin e qytetarëve.

Kur të analizohet Raporti, nuk mund të anashkalohet edhe të flitet edhe për privatizim, sepse privatizimi nuk është shitje e thjeshtë e një pasurie, ajo në vete ngërthen elementin legal, elementin mjedisor, komercial, zhvillimor dhe atë politik.

Ky privatizim nuk ka sjellë zhvillim të pritur ekonomik, as punësim të pritur. Në qoftë se bazohemi në BSPK-në, atëherë shihet me shënimet e tyre rreth 50 mijë vende të punës janë më pak se sa që kanë qenë përpara. Sa herë të flitet për privatizimin në Kosovë, gjithashtu nuk mund të anashkalohet koha e AKM-së, e Spin-offeve speciale, e përzgjedhjes së blerësve të pa përgjegjshëm, mos pagesës së 20% me kohë e tjera.

Privatizimi i nisur nga ana e AKM-së në Kosovë, as për së afërmi nuk e ka plotësuar aspektin ekonomik, zhvillimor e as atë social të Kosovës, ndonëse AKP-ja ka funksion tjetër dhe ka tentuar eliminimin e problemeve të trashëguara.

Nga rezultati shihet që i kemi 630 ndërmarrje të privatizuara me 517 milionë euro, gjë të cilën e ka trashëguar një pjesë të madhe të problemeve dhe të punëve nga AKM-ja, numër të madh të papunëve, spin-offi special i cili ka pasur pak sukses dhe “Llamkosi” është një shembull i keq. 24 milionë janë shpërndarë si 20% për punëtorë, ndonëse me shumë vonesë, 22 milionë janë ndëshkime për ndërmarrjet të cilat nuk i kanë përmbushur kushtet e kontratës së shitblerjes për investime dhe punësim. Shihet që para AKP-së janë shumë punë dhe detyra të rëndësishme.

Rekomandojmë që të rishikohen politika e Spin-offit special, pasi shumë ndërmarrje nuk po arrijnë të realizojnë premtimet për pushim dhe investime. Kërkojmë të krijohet infrastruktura e nevojshme ligjore për kthimin e aseteve financiare në Kosovë dhe të vihet funksion të zhvillimit ekonomik vendor. Duke pasur parasysh që kthimi i këtyre mjeteve, kërkon bankë të akredituar nga agjencitë ndërkombëtare për klasifikim dhe as Ligji me letra për vlerë, i cili shpresojmë se do të dalë së shpejti, andaj korniza ligjore pamundëson kthimin e fondeve të dala nga privatizimi dhe kthimi i mjeteve të kreditorët. Prandaj, shfrytëzojmë rastin e analizës së Raportit të AKP-së për 2010, që të kërkojmë përshpejtimin e të gjitha procedurave, në mënyrë që këto mjete sa më shpejt të kthehen në Kosovë dhe të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

“Trepça” dhe plani për ristrukturim të “Trepçës” kërkojmë që të funksionalizohet, që të funksionojë ky gjigant dhe edhe ky gjithashtu të ndihmojë në funksionimin apo në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Kërkojmë prej AKP-së gjithashtu të vazhdojë me mbikëqyrjen e ndërmarrjeve që të ndikojë te ato që të jenë më funksionale dhe të ndëshkojë ato të cilat nuk i përmbahen marrëveshjes kontraktuale me ato. Kërkojmë që likuidimi i ndërmarrjeve të mos jetë një proces i cili ngecë dhe i cili nuk prodhon rezultate të duhura, por që të përshpejtohet në mënyrë të ndihmës, përsëri, të zhvillimit ekonomik. Dhe, gjithashtu, mbështesim dhe kërkojmë që sa më shpejt të silltet ligji i ri

për Dhomën e veçantë në Kuvend që të përshpejtohet puna dhe të funksionalizohet më mirë AKP-ja.

Ne do të votojmë këtë Raport, me kërkesë që këto rekomandime të cilat i përmendëm, të realizohen sa më shpejt.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Para nesh sot e kemi Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Agjenci kjo e cila mbulon një ndër fushat më të rëndësishme të jetës politike dhe ekonomike në Kosovë, sikur në secilin vend tjetër që i nënshtrohet një procesit të skajshëm të privatizimit të përshpejtuar, siç ka ndodhur në Kosovë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e fushës që mbulohet nga kjo Agjenci dhe vetë rëndësinë e kompetencave të mëdha ekzekutive menaxhuese dhe administruese ndaj pronës shoqërore të Kosovës që kjo Agjenci i ka, Raporti i dorëzuar është tejte larg nga reflektimi i kësaj rëndësie dhe përgjegjësie.

Raporti përgjithësisht informon sipërfaqësisht për punën njëvjeçare të agjencisë, pa i dhënë detajet e nevojshme për ta kuptuar nacionalitetin prapa vendimeve të shumta të agjencisë, pra është raport sa për të na hequr qafe neve qafe si deputetë dhe popullin e Kosovës, si pronarë të kësaj prone që e shet, menaxhon dhe administron kjo Agjenci. Pra, ky raport, edhe pse mund të vlerësohet nga dikush si i saktë në ato që i thotë, është jashtëzakonisht i rëndësishëm të vlerësohet në bazë të atyre që nuk i thotë, për shkak se ato që nuk i thotë, janë e vërteta e privatizimit.

Dino Hasanaj, kryetar i Bordit të kësaj Agjencie, në deklaratën e tij në cilësinë pra të kryetarit, e cila shërbeu si hyrje në raport, vlerëson vitin kalendarik 2010, si vit të suksesshëm për AKP-në. Këtu një pyetje shumë e shpejtë që duhet shtruar, është se çka quan sukses Dino Hasanaj. Nëse sukses është shitja e pamenduar dhe e pavlerësuar mirë e pronës shoqërore të Kosovës, atëherë është e vërtetë, Agjencia është një prej institucioneve më të suksesshme në Kosovë. Këtë sukses ka të ngjarë t’ia arrijë dhe ndoshta tejkalojë vetëm sivjet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e cila po ashtu ka marrë për sipër t’i shes të gjitha ndërmarrjet publike të Kosovës, prapë pa menduar fare dhe pa garantuar kurrfarë dobie që mund të vijë nga kjo shitje, si dhe pa i kalkuluar fare dëmet që këto shitje po ia sjellin ekonomisë së vendit.

Procesi i privatizimit në Kosovë, i filluar nga UNMIK-u e AKM-ja, dhe i vazhduar në formën e njëjtë dhe me ritmin e njëjtë nga Qeveria e Kosovës dhe AKP-ja, e ka dëmtuar rëndë potencialin prodhues ekonomik të vendit, si dhe e ka rritur papunësinë në vend, duke i mbyllur dhe transformuar ndërmarrjet prodhuese, në rastin më të mirë në ndërmarrje hoteliere e tregtare, ndërsa në rastin më të keq, në asete të vdekura.

Spin-offi i thjeshtë ka qenë veçanërisht i dëmshëm në këtë drejtim, për dallim duhet përmendur këtu nga Spin-offi special, i cili deri diku i ka pasur disa kushtëzime për blerësin, për shkak se Spin-offi i thjeshtë ua ka lënë duart e lira blerësve që të blejnë, që të bëjnë çfarëdo që donë me pronën e vet tashmë të blerë. Ky pra nuk ka qenë proces privatizimi, në kuptimin e privatizimit të ndërmarrjes, si ndërmarrje prodhuese, por ka qenë proces i shitjes së aseteve të ndonjë ndërmarrjeje pa kurrfarë obligimi ndaj punëtorëve dhe as ndaj shoqërisë dhe në vend që Agjencia dhe Qeveria ta bëjnë një vlerësim të privatizimit të deritashëm, të ndalen dhe ta rimendojnë procesin e privatizimit, t'i identifikojnë ndërmarrjet me interes të veçantë për ekonominë e vendit dhe të krijojnë kushte për zhvillimin e tyre, këta kanë hequr dorë madje edhe nga Spin-offi special dhe po vazhdojnë me privatizim të ngutshëm vetëm sa për t'i shitur ndërmarrjet. Askund në raport nuk arsyetohet pse është hequr dorë nga Spin-offi special, ndërkohë që gojarisht Dino Hasanaj, në mbledhjen e Komisionit tha që ky raport, më falni, ky proces, spin-offi special ka rezultuar të jetë i dështuar dhe për këtë arsye është vendosur që të hiqet dorë nga ai. Thua ti, spin-offi i thjeshtë na ka rezultuar me sukses shumë të madh.

Në raport nuk thuhet gjë për mbikëqyrjen që AKP-ja ishte dashur t'ua bëjë ndërmarrjeve të privatizuara me Spin-off special, nëse ato i plotësojnë ose i kanë plotësuar kushtet e kontratës apo jo.

Në faqen 15 dhe 16 të raportit, kur trajtohet kjo çështje, vetëm tregohet se gjatë vitit 2010, kanë qenë 18 ndërmarrje nën monitorim të AKP-së, prej të cilave 4 sosh, Bordi i ka ndëshkuar financiarisht për mospërbushje apo përmbushje të ulët të zotimeve nga ana e blerësve, 3 të tjerave ua ka vazhduar edhe për 90 ditë afatin për gjetjen e një zgjidhjeje për sanimin e gjendjes, për 3 ka vendosur t'ua zgjasë periudhën për përmbushjen e zotimeve për investime dhe punësim, e në raport nuk tregohet se sa është kjo periudhë e zgjatur, si dhe 7 të cilat janë liruar nga kushtet e marrëveshjes për zotime. Asnjë shpjegim shtesë për këto vendime, që në bazë të Raportit duken zotime jashtëzakonisht arbitrare.

Në pyetjen time për kryetarin Bordit, Dino Hasanaj, në Komisionin për Zhvillim Ekonomik se kush dhe si e vlerëson nivelin dhe shumën e investimeve në kompanitë e komercializuara, apo ato Spin-offit special, ai u përgjigj se AKP-ja nuk ka kapacitete për një gjë të tillë. Pra, në bazë të çfarë vlerësimeve këta marrin vendime. Përgjigja është sigurisht raportet e audituara financiare, e këto raporte varësisht se kush i bën dhe varësisht se si bëhet auditimi, kanë potencial apo mund të jenë tejet të pasakta në ato që paraqiten atje.

Por, natyrisht, rasti më eklatant i punës dhe raportimit të saj nga kjo agjenci për vitin 2010, është ai i "Sharrcemit". Raporti i jep jo më shumë se dhjetë rreshta hapësirë kësaj shitjeje, në ndërkohë që në raport vlerësohet që kjo të jetë shitja më e madhe që ka ndodhur në historinë e Kosovës. "Sharrcemi", siç dihet, është shitur në fund të vitit të kaluar, në kohën kur në Kosovë mbaheshin zgjedhjet e përgjithshme dhe kur opinioni publik ishte i dehur nga zgjedhjet dhe festat fund vitit, pra është bërë një formë që mund të quhet klandestine.

Ndërmarrja është shitur për 30.1 milion euro, kur ajo vetëm viteve të fundit ka pasur suksese të mëdha dhe përfitime të mëdha që kanë shkuar deri në 20 milionë euro në vit. Ko shumë e vogël e shitjes është arsyetuar nga AKP-ja me investimet e deritashme të komercializuesit. Ky arsyetim pra, natyrisht, ka ardhur përmes mediave, nuk thuhet në raport kështu, nuk përmendet fare kjo gjë, ndërkohë që edhe kontrata e nënshkruar në mes UNMIK-ut dhe komercializuesit e thotë qartë që të gjitha investimet dhe përmirësimet fizike i takojnë kompanisë pa kurrfarë obligimi apo pagese ndaj qiramarrësit. Por, një gjë e tillë nuk është paraparë as me kontratën që e ka nënshkruar UNMIK-u, ndërkohë që në formë indirekte AKP-ja ia ka marrë parasysh ato investime, si dhe zotimet për investime që i ka bërë kompania “Titan” nga Greqia që e ka blerë “Sharrcem”-in.

Po ashtu, një çështje tjetër që duhet ngrihet, është edhe shitja e “Sharrcem”-it pa kurrfarë procesi të tenderimit, gjë që e përbën edhe shkelje të vet Ligjit të privatizimit, ndërkohë që edhe një çështje tjetër që ishte dashur të kemi përgjigje nga AKP-ja, është pse i është shitur bash “Titanit” nga Greqia, pse ne u shesim pronë shoqërore afaristëve apo kompanive që vinë nga shtetet të cilat nuk na e kanë njohur pavarësinë dhe të cilat në njëfarë mënyre aktivisht veprojnë kundër kësaj pavarësie, pra kundër të drejtës tonë për të jetuar të lirë. Kjo është një pyetje, të cilën ndoshta edhe Dino Hasanaj ishte dashur t’ia shtrojë vetes, por veçanërisht publiku i Kosovës duhet t’ia shtrojë atij.

Në raport, siç u përmend këtu, u dedikohen diku dy faqe e gjysmë çështjes së Trepçës, si ndërmarrje e cila është nën administrimin e AKP-së, mirëpo aty më shumë përmenden problemet që i ka Trepça, se sa puna që ka bërë AKP-ja për t’i zgjidhur këto çështje. Aty, po ashtu përmendet se si Trepça funksionon e ndarë në menaxhmentin e jugut dhe në menaxhmentin e veriut dhe askund në raport nuk përmendet apo nuk shihet ndonjë angazhim i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për ta sanuar këtë gjendje, pra për ta bërë Trepçën një, siç edhe duhet të jetë.

Çështje tjetër, ka të bëjë edhe me kthimin e fondeve. Ne i kemi parë disa herë që Dino Hasanaj ka dalë në publik dhe ka kërkuar nga Banka Qendrore e Kosovës për t’i kthyer këto fonde dhe për të investuar në Kosovë, ndërkohë që të gjithë e dimë që është Bordi i AKP-së ai që është përgjegjës për fondin e privatizimit dhe bordi i AKP-së ka të drejtë të marrë vendime mbi këtë fond, pra ta kthejë atë në Kosovë, nëse është aq i interesuar Dino Hasanaj. Natyrisht që problemet ligjore janë të mëdha për këtë çështje, mirëpo konsiderojmë që puna e Bordit apo e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për sa i përket kësaj çështjeje, ka qenë e padukshme dhe duket e padukshme edhe në raportin vjetor të cilin e kanë prezantuar në Kuvend.

Po ashtu, një pjesë e raportit ka të bëjë me listat e punëtorëve, të cilëve u takon 20% dhe aty shihet që janë përpiluar një numër ose janë finalizuar një numër i madh i listave për 20% e punëtorëve. Kjo pra bëhet në bashkëpunim të Agjencisë, Bordit, ndërmarrjeve tashmë të privatizuara, si dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Një çështje që duhet të ngrihet këtu, është që kur shihet te menaxhimi i fondit, shihet qartë që AKP-ja, sipas raportit të vet, domethënë, ka interes të fituar në

shumën e fondit të privatizimit vetëm 20 milionë euro, nga 480 milionë euro, janë bërë në 501, që e përfshinë interesin. Kjo i bien një rritje prej diku mbi 4% të fondit, ndërkohë që kemi ne punëtorë të Kosovës të cilëve u ka takuar 20% e të cilët nuk e kanë marrë atë duke filluar ndoshta prej vitit 2004, 2005, 2006, dhe kur kihet parasysh që ajo shumë e cila u ka takuar, tashmë është dobësuar dukshëm nga inflacioni dhe është rritur fatkeqësisht nga AKP-ja për vetëm 4%. Në raport nuk thuhet asgjë se kush e merr përgjegjësinë për këtë ulje të fuqisë blerëse të punëtorëve, të cilët nuk kanë arritur t'i gëzojnë paratë e tyre në kohën kur është dashur t'i gëzojnë ato.

Lëvizja "Vetëvendosje", pas trajtimit të këtij raporti, konsideron që një raport i tillë është tejte i mangët për të na treguar qartë se çfarë pune ka bërë Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe, si të tillë, ne nuk mund ta votojmë për shkak se nuk e reflekton punën dhe nuk reflekton përgjegjësinë që kjo Agjenci duhet ta ketë ndaj qytetarëve të Kosovës, ndaj pronës së Kosovës dhe ndaj ekonomisë së Kosovës në përgjithësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN AGJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Për një kohë të gjatë kemi folur për Agjencinë Kosovare të Privatizimit në disa legjislatura, kemi folur edhe gjatë tri viteve të kaluara për çështjen e raporteve të Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kemi provuar që të flasim për gjithë punën e Agjencionit, do të thotë një aspekt i mbikëqyrjes gjithëpërfshirëse edhe kështu duhet të jetë. Edhe unë, si shef i Grupit Parlamentar, në dy legjislaturat e kaluara e kam përfaqësuar grupin dhe kam folur për të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Pronës, e jo vetëm për një regjion.

Kësaj radhe, me pajtim edhe të grupit, do të ndalem pak më shumë në atë pjesë të Kosovës prej nga vij vet, do të thotë Gjakova. Fillimisht, si hyrje duhet të them se privatizimi nuk i ka përmbushur pritjet e qytetarëve të Kosovës për afër 10 vjet, qysh se ndodhë, nuk i ka përmbushur pritjet e asnjërit prej nesh si proces, pavarësisht se kush ka qenë në Bord. E dimë që deri pas pavarësisë nuk ka qenë i mbikëqyrur drejtpërdrejt as nga Qeveria e Kosovës, e as nga Kuvendi, me një mbikëqyrje të lehtë do të themi, mirëpo pas pavarësisë është realisht nën mbikëqyrjen tonë, fillimisht të Qeverisë, për shkak se e dini ju që partnerët e koalicionit qeverisës edhe në Qeverinë e kaluar, edhe tash e mbikëqyrin përmes njerëzve të vet edhe Bordin, edhe atë që ndoshta mund ta quajmë pjesë ekzekutive ose drejtoritë e Agjencisë Kosovare të Pronës.

Ajo që është pritur për dhjetë vite, është transferuar në diçka rreth 500 milionë euro pasuri, që ende nuk e dimë se si do t'i bëhet puna në fund të fundit, ndërsa nëse ne flasim për të gjitha asetet e Kosovës, asetet më të mëdha të Kosovës që janë menaxhuar nga Agjencioni Kosovar i Pronës, dikur AKM-ja ose Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, vetëm mund të marrim me mend se a vlen që Kosova të krijojë të hyra prej të gjitha aseteve të veta 50 milionë euro në vit. Mendojmë se është nën çdo minimum të mundshëm, nëse vetëm do të ishin dhënë me qira të gjitha, me siguri se do të kishin

krijuar më tepër. Do të thotë, ky proces i cili po zgjatë shumë, nuk i ka sjellë Kosovës atë që është pritur, ka sjellë më shumë, më shumë humbje, bllokim dhe degradim të aseteve të Kosovës se sa një dalje e shpejtë nga gjendja në të cilën ka qenë, gjendje e cila ka qenë dashur të ndryshohet. Ne besojmë në Aleancë se privatizimi duhet të ndodhë, mirëpo duhet përdorur një klishe që një shkollar e ka përdorë dikur, tanimë ka ardhur koha që të themi se paradigmës tranzicion duhet t'i vijë fundi.

Privatizimi ka qenë dashur që të jetë fillimi i përfundimit të asaj paradigme në Kosovë, mirëpo nëse ende ne valvitemi ngado që na qojnë disa çështje që nuk po dua t'i kualifikoj, atëherë Kosova realisht në dhjetë vitet e fundit nuk e ka shfrytëzuar as 10% të potencialit të vet për të krijuar dhe punuar për qytetarët e Kosovës.

Tani do të kthehem pak te Gjakova. U përmend më përpara nga një kolege e imja, as në legjislaturën e kaluar, e as nga Qeveria e kaluar, as kjo Qeveri nuk po provon, nuk po bënë as minimumin për gjetur zgjidhje për një komunë që është e treta më e madhja në Kosovë, për një qytet i cili dikur i ka dhënë 11% e më tepër të bruto prodhimit të gjithmbarshëm. Domethënë, Kosova po ia lë vetit luksin fillimisht, për ta fjetur njërin prej potencialeve të veta më të mëdha. Duhet pyetur a është e drejtë që një qytet, që dikur i ka dhënë aq shumë Kosovës, jo veç vetvetes, vetvetes më pak në fakt, të mbetet kësisoj dhe pyeta a është e drejtë që të mbahet i fjetur i gjithë ai potencial, qoftë njerëzor, qoftë i tokës, qoftë i aseteve tjera, të cilat realisht i ka poseduar dikur dhe sot i posedon në masë të madhe komuna e Gjakovës.

A është e drejtë të mbahen gjakovarët, që janë qytetarë të Kosovës, t'i shohin tokat të cilat nuk mund t'i shfrytëzojnë, t'i shohin asetet të cilat nuk mundën t'i shfrytëzojnë. Unë mendoj se secili kosovar duhet të mendojë se nuk është e drejtë të ndodhë kështu, edhe kanë të drejtë ata njerëz që thonë se çka duhet bërë më tepër. Ne i kuptojmë edhe si Grup Parlamentar, por edhe njerëzit me të cilët flasim atje, i kuptojnë problemet, mirëpo mendoj se është jashtë çdo norme tanimë të mos merren vendimet, të mos shikohen për së afërmi pretendimet e udhëheqësve të ndërmarrjeve dhe punëtorëve të ndërmarrjeve. Mendojmë se vazhdimi kësisoj i mbajtjes të ngujuar të një ekonomie aq të madhe, i ka bërë dëm jashtëzakonisht Komunës së Gjakovës me të gjitha fshatrat e veta, po i ka bërë dëm të madh edhe Kosovës, po ju them me plotë bindje.

Fundi i fundit, secili prej nesh në Kuvendin e Kosovës, po edhe gjithkush në Qeverinë e Kosovës, pa marrë parasysh prej kah vinë, duhet pasur pak kujdes se, edhe një herë po them, po flasim për një ndër asetet më të mëdha që i ka pasur Kosova të paktën në 100 vitet e fundit. Edhe, në fund të fundit, ka qenë dashur të paktën të jepet përgjigje pse po ndodhë kështu dhe të ketë pjesë serioze të raportit pse po ndodhë kështu me një potencial kaq të madh dhe me disa njerëz të cilët kanë dhënë krejt çka kanë pasur për një kohë shumë të gjatë edhe deri tash, në luftë edhe deri tash.

Kjo është më shumë një pyetje edhe mendoj se, me siguri, të gjithë ata që janë në Bord të Agjencionit, edhe pjesa ekzekutive, do të kenë pak më tepër kujdes tash e tutje për shkak se, po them edhe një herë, është jashtëzakonisht e patolerueshme të vazhdohet kësisoj më.

Edhe një pyetje e fundit, shumë e drejtpërdrejtë, që nuk ka të bëjë shumë me Gjakovën, është a merr Agjencia Kosovare e Privatizimit qira prej ndërtesës së Rilindjes? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re ka shqyrtuar Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010. Duke marrë parasysh se raportet e mëparshme të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të cilat janë sjellë në këtë Kuvend të Kosovës, kanë qenë së paku raporte me të gjera, ndërsa ky raport është diç më i cektë apo më i shkurtër. Ku është arsyeja në këtë raport, unë nuk di, vetëm mund të them se nëse e krahasojmë me tri raportet e mëparshme, është raport shumë më i shkurtër.

Kthehem në raport. Gjatë shqyrtimi të raportit, mund të shihet se Agjencia Kosovare e Privatizimit është formuar në bazë të Ligjit për AKP-në apo më mirë të themi, në bazë të ligjeve të cilat kanë ardhur me pakon e presidentit Ahtisari, dhe qysh shihet, gjatë kalimit të këtyre ligjeve, nuk ka pasur mundësi të ndërhyrjes dhe paraqiten pengesat në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Pengesat të cilat ju kanë paraqitur këtij agjencioni, kanë qenë edhe dy raportet e mëparshme të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ku kërkesa e Bordit të AKP-së ka hasur në vesh të shurdhët si nga Kuvendi, si nga Qeveria e kaluar dhe çështja e njohjes së shumë investitorëve të huaj apo çështja e njohjes së UNMIK-ut, dokumentacionit të AKM-së dhe jo AKP-së, sjell edhe pasojat e fundit të cilat paraqiten, çështja e Trepçës dhe çështja e likuiditetit të shumë ndërmarrjeve.

Duke marrë parasysh se edhe në raport parashihet problemi me ndërmarrjet të cilat janë dhënë me Spin-off special dhe nuk shihen, shihen vetëm penalet që ju kanë dhënë këtyre ndërmarrjeve, ndërsa nuk dihet akoma se si do të plotësohen kushtet e kontratës, kur sot e asaj dite mund t'ju jepen penale dhe ato të vazhdojnë ashtu, se si do të arrihet të bëhet ajo marrëveshje e atyre kontratave, mbetet të shihet.

Në raport kemi mjaftë të qartë çështjen e të hyrave nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, mirëpo edhe shumë qartë shihet edhe çështja e këtyre parave nga privatizimi që nuk gjenden në Kosovës dhe Ligji i AKP-së e thotë mjaft qartë që këtu do të jetë edhe një përfaqësues i ICO-s, i cili duhet të japë pëlqimin për kthimin e të hollave. Duhet të kërkohej një plotësim - ndryshim sa më i shpejtë i Ligjit për AKP-në. Edhe një herë potencoj se Ligji për AKP-në ka ardhur në kohën me ligjet e pakos të presidentit Ahtisari dhe tash shpresojmë shumë shpejt që Qeveria do të sjellë në mënyrën më të shpejtë të mundur Ligjin për AKP-në, Ligjin për Odën e veçantë dhe njëkohësisht Ligjin për Trepçën për arsye se pasojat janë të mëdha.

Koalicioni për Kosovën e Re e përkrah Raportin e AKP-së dhe shpreson që të gjitha këto sugjerime do të merren parasysh. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputetja Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je kroz aktivno učešće svojih članova u Komisiji pažljivo razmotrila godišnji izveštaj Kosovske agencije za privatizaciju. Smatramo da su ispunjeni adekvatni uslovi, i samim tim mi podržavamo usvajanje istog. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas shqyrtimit të Raportit vjetor të punës për vitin 2010, të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe pas vlerësimit dhe rekomandimit nga ana e Komisionit përkatës të këtij raporti, Grupi Parlamentar “6+” do ta miratojë këtë raport të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani diskutimet në emër të grupeve parlamentare janë ezauruar. Vazhdojmë me paraqitjen e deputetëve. Sipas radhës, është deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, nënkryetar!

Kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Sa herë kemi diskutuar për raportet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më shumë jemi marrë me politikat privatizuese, se sa për punën teknike të këtij agjencioni.

Edhe sot, dhe gjithnjë do të merremi me këto politika privatizuese, sepse janë politika që nuk i kanë sjellë të mira qytetarëve të Kosovës. Edhe në këtë rast, në këtë raport, sikur në raportet tjera që janë diskutuar nga ky Kuvend, ne nuk e dimë se çka po ndodhë me paratë e privatizimit, ku janë ato, a janë të sigurt, pse nuk po investohen në Kosovë, pse po vonohet pagesa e 20% për punëtorët. Është shumë e çuditshme se si po shitet pasuria jonë dhe kjo po bëhet nga individë të cilët ndoshta kurrë nuk do të investojnë në këto prona, dhe këtu nuk po përmendet se në çfarë shumash po shiten këto ndërmarrje.

Ndoshta nuk po bëhet sa duhet edhe në reklamimin e këtyre potencialeve ekonomike apo ende nuk ekziston klimë e favorshme për të investuar në Kosovë. U shit gati e gjithë pasuria e vendit dhe ende nuk kemi një investitor serioz. Ne jemi për privatizim të pronës shoqërore, por ky privatizim duhet të implementohet ashtu që të ndikojë drejtpërsëdrejti në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, në stimulimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në zbutjen e varfërisë, në rritjen e punësimit.

Procesi i privatizimit është pjesë përbërëse e reformave ekonomike që duhet të implementohen me një kujdes të veçantë. Privatizimi duhet të shënojë menjëherë impakt pozitiv. Agjencion i ri i privatizimit, AKP-ja, nëse do të gjenerojë mirësi për qytetarin e Kosovës dhe për ekonominë e saj, duhet të ndal dorën e mos të veprojë si AKM-ja e kaluar, por t'i marrë në konsideratë rekomandimet e cekura. Të vlerësohet dhe t'i jepet vlera reale objektit për shitje, të punohet drejtpërsëdrejti me blerësit potencial, të zgjidhet blerësi që garanton ardhmëri ekonomike të objektit, të ndihmohet blerësi deri te funksionalizimi i tërësishëm me ekspertizë dhe logjistikë nga AKP-ja.

Kuvendi është përgjegjës i drejtpërdrejtë i politikave privatizuese në Kosovë, prandaj bëjë thirrje që të bëhet edhe ndryshim - plotësimi i Ligjit për privatizim.

Një dukuri tjetër jo pak e përfolur nëpër media, është edhe dyshimi për shitje korruptive. Pra, favorizimi për njerëz të caktuar, si dhe kërcënime për shumë nga blerësit. Këtu duhet përmendur edhe rastin e Banjës së Pejës, ku kemi pas raste shantazhi, me ç'rast ka rezultuar me tërheqje të blerësit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Për natyrën e performancës së këtij Bordi apo këtij Këshilli folën shumë kolegë dhe u dhanë vlerësime shumë thelbësore, shpresoj të mos kenë rënë në vesh të shurdhër.

Nuk pata rastin të dëgjoj për një segment, për atë edhe e mora fjalën. Në raport nuk ka asnjë analizë të blerësit të dytë. Sa janë ato raste, pse ofertuesi i parë është tërhequr. Një analizë konkrete rreth kësaj që unë mendoj se është shumë, shumë kruciale për Kuvendin ta dijë atë.

Në diskutim disa thanë se pas privatizimit e menaxhon Kuvendi, Kuvendi i emëron, por Bordi më tutje do të dominohet nga të huajt. Në raport me Trepçën veriore, nuk e kemi asnjë raport. Fatmirësisht, Zyra e auditorit gjeneral i ka bërë një auditim pasqyrave financiare vjetore dhe unë mund t'ju them se atje janë gjetur një varg shkeljesh, për të cilat ne do t'ju njoftojmë në një takim shumë të shpejtë dhe ndoshta për këtë e mora më shumë fjalën.

Nuk është e udhës për raportime të flasim në mënyrë të dyfishtë dhe të dalim me vlerësime kontradiktore. Për pjesën veriore, jo vetëm që nuk kanë asnjë qasje në mënyrën e menaxhimit, por nuk kanë qasje as për mjetet nga granti qeveritar që i kanë dhënë atje. Nuk e kanë asnjë raport që është krejt e pa kuptimtë dhe krejt e patolerueshme, sepse buxheti është këtu, thesari është këtu dhe grandet tjera mund të kushtëzohen me raportime kthyesë, që nuk ka ndodhur asnjëherë. Por, edhe në vetë punën e Bordit, ka po them, lëshime me të cilat ju do të njoftoheni, do të shihni edhe në sferën e prokurimit atje që janë shkelur në mënyrë të vrazhdët shumë dispozita ligjore që kundërmojnë erëra të cilat duhet dikush t'i hulumtojë dhe të shkojë deri në

skaj aty, por thelbin e kësaj pse e mora fjalën, një herë e përgjithmonë duhet të mësohemi, dy herë raportimet mos t'i vlerësojmë në Kuvend.

Po them, brenda një jave ne do t'ju vijmë me pasqyra që ka punuar një grup ekspertësh një kohë të gjatë afër dokumentacionit, sepse ky është raport i punës i rregullt është. Natyra e çdo shkelësi apo vepruesi, i gjen një justifikim atij veprimi për çka e bën, prandaj është shumë subjektiv dhe ka nevojë që dikush, një i tretë të ndërhyjë dhe të japë vlerësime për natyrën dhe për rregullsinë e atij veprimi që ai e ka ndërmarrë.

Prandaj, në raportet e rregullsisë ne nuk duhet të presim që atje do të thotë nuk e kam bërë këtë, ose e kam bërë këtë keq o se kam bërë atë. Këtu është edhe natyra e re e një raportimit të tillë. Po them, lëshimet që i kemi vërejtur, për mua janë shqetësuese, të mos i komentoj para kohe, por ju do t'i shihni. Unë i apeloj Kuvendit, nuk ka këtu pozitë e opozitë, por duhet të gjithë ta shikojmë bashkërisht, se është pasuria e Kosovës.

Pse ky raport të mos shqyrtohet barabarë me tabelat që na i bie auditori? Dhe do ta shihni ju konkretisht se çka ka atje. Kjo është ajo për çka e mora fjalën.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Niazi Idrizi e ka fjalën.

NIAZI IDRIZI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Nga ky raport shihet se Agjencia Kosovare e Privatizimit ka zbatuar përveç 7 rundeve të privatizimit me spin-off edhe 5 shitje të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore me metodën e spin-offit, me metodën e likuidimit. Po ashtu, është shumë pozitive shpërndarja e 20% të vlerës për punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, të cilët i kanë përfituar rreth 13 milionë euro, që është një shumë serioze kur krahasohet me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, e cila ka arritur t'i shpërndaj vetëm 15 milionë euro të 20% për punëtorët gjatë gjithë mandatit të vet.

Për mua një shqetësim i veçantë është bërë privatizimi i tokës bujqësore. Një sipërfaqeje të madhe e kësaj toke iu ka ndërruar destinomi, në kundërshtim me ligjin, një sipërfaqe që konsiderueshme ka mbetur djerrinë, ndërsa një sipërfaqe krejtësisht e vogël është duke u shfrytëzuar për prodhim e ushqimit. Një pjesë e kësaj toke është privatizuar me spin-off special, por që në shumicën e saj nuk është duke u zbatuar asnjë aktivitet për të cilin këto kompani kanë marrë angazhim.

Legjislacioni i ardhshëm duhet të marrë parasysh edhe mënyrën e privatizimit të tokave bujqësore, duke e penguar ndërrimin e destinimit të saj, sepse kështu thotë edhe Ligji mbi tokën bujqësore. Kjo duhet të bëhet edhe për faktin se janë në proces të privatizimit edhe një sipërfaqe e konsiderueshme e tokës, që arrin rreth 20 mijë hektarë, e cila duhet të ketë fat më të mirë se kjo e deritashmja.

Modeli i shitjes me spin-off special, siç vërehet edhe nga raporti, ka shkaktuar shumë kokëçarje dhe shpesh këtë proces të disa ndërmarrje e ka kthyer në pikën fillestare. Sa

më shpejt që të jetë e mundur, është mirë që të nxirret Ligji mbi Trepçën dhe të ndërpritet mundësia që Trepça të trajtohet në bazë të ligjeve të tashme, njësoj si një kooperativë bujqësore. Duhet që të nxirret një ligj i veçantë, i cili Trepçën do ta trajtojë si ndërmarrje strategjike, me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

I nderuar ministër,

Është mirë, për mendimin tim, që kur po diskutojmë për raportet, po debatojmë edhe për gjendjen në fushën që e mbulojnë raportet, së paku kësaj radhe po, dhe jo vetëm për performancë.

Shikuar thjeshtë si raport, mendoj se raporti që po e shqyrtojmë sot është raport i mirë, i hartuar mirë, i saktë dhe është model, por çështja që kapërthehet në raport, mendoj që lë vend për të dëshiruar, madje edhe për të debatuar. Ndoshta do të ishte e mira që këto çështje të shqyrtohen pastaj në debate të veçanta. Besoj se do të krijohen kushtet, por druaj se shumica e vërejtjeve që mund të bëhen në fushën e privatizimit, kanë të bëjnë edhe me zgjidhjet kushtetuese e ligjore, të cilat i determinojnë anomalitë që janë të vërejtura atje. Unë këtu nuk do të ndalem në këto çështje, por dua të ndalem vetëm në disa aspekte që mendoj se, edhe pse u thanë, ia vlen ndonjëherë edhe të sforcohen edhe më shumë.

Së pari, çështja, nevoja e pashtyeshme e kosovarizimit edhe të drejtimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, edhe në Bord, edhe në Dhomën e veçantë, mendoj që nuk ka lëvizur asgjë në këtë drejtim dhe konform zhvillimeve të përgjithshme, duhet të përshpejtohet ky proces, aq më tepër kur ka edhe çështje të parregulluara sistemore kushtetuese, diku me UNMIK, diku me ligjet tona dhe shpesh ato janë jofunksionale.

Çështja e dytë, që dua ta shtroj, besoj që edhe kolegët do të më mundësojnë këtë që të flasim pak me zë më të ulët kur flasim mes veti, është çështja e 20%-shit të famshëm. U theksua ky problem me të drejtë, por ajo që unë dua ta përforcoj edhe më shumë, është fenomeni jo vetëm i vonesës, por ndonjëherë edhe i përjashtimit të të përjashtuarve. Në këtë 20% janë përfshirë vetëm ata që kanë mbetur në ndërmarrje, por shpesh janë sakrifikuar ata që shpesh për arsye politike kanë qenë viktimë e proceseve të mëhershme dhe mendoj se është e padrejtë ata të përjashtohen nga pensionet, të përjashtohen tash edhe nga 20%-shi, është një padrejtësi e madhe shoqërore.

Çështje në vete, është çështja e fondit të privatizimit, i cili edhe për mendimin tim, për arsye të pashpjegueshme dhe jo të kuptueshme për mua, vazhdon të mbetet jashtë Kosovës. Përveç dëmeve të tjera, me këtë edhe krijohet një dilemë e madhe për të ardhmen e Kosovës, por edhe për besueshmërinë e sistemit tonë bankar. Si ta bindim një investitor të jashtëm që t'i deponojë paratë këtu, kur ne vet i deponojmë paratë nëpër banka të huaja.

U theksua me të drejtë problematika e Trepçës, si problematikë e veçantë dhe këto ditë kishim edhe në media një reagim, madje edhe vetë Agjencionit të Privatizimit për fenomenin e shitjes të mineraleve. Sot po shiten mineralet, por nëse lejohet kjo, nesër mund të shiten minierat dhe nëse lejohet ajo, dihet ku çon kjo pastaj edhe territorialisht e tjera. Është koha që t'iu thuhet jo proceseve të tilla dhe në këtë drejtim mendoj se meriton përkrahje edhe ndërmarrja e vetë Agjencionit.

Çështja e fundit, që dua atë ngrehë, është bashkëpunimi i Agjencionit në procesin e privatizimit edhe me komunat, një bashkëpunim që ka çaluar shpesh dhe ka prodhuar vështirësi. Si shembull do të sillja shembullin e Gjilanit. Ka qenë, ka dështuar për pasojë e mungesës të këtij bashkëpunimi, edhe një projekt për ndërtimin e një shkolle në Gjilan, i cili përpara dhe mund të gjendej një justifikim, sepse ka pasur një mangësi të bazës ligjore, por tani kjo është rregulluar me Ligjin për përdorimin dhe shkëmbimin e patundshmërisë midis ndërmarrjeve shoqërore dhe komunave, është mundësuar kjo. Është e pa shpjegueshme që të dështojnë edhe projektet, siç është ndërtimi i shkollave, ndoshta për një pakujdesi burokratike. Besoj se në të ardhmen do të merren këto çështje dhe shumë vërejtje tjera që u thanë nga kolegët deputetë, të cilat unë i mbështes. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Të nderuar delegatë

Mendoj që shqetësimet e ngritura për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ne duhet të sistematizojmë dhe të ngrisim në nivel pak më shqetësues, se sa po i shpjegojmë. Nga paslufta deri më tani janë privatizuar shumë askete të Republikës së Kosovës dhe nga kjo që unë personalisht kam arritur t'i vërej edhe si shqetësime të qytetarëve, janë disa fabrika që janë privatizuar dhe të cilat nuk funksionojnë mirë. Për shembull, nga aspekti i menaxhimit të brendshëm të tyre ekonomik disa fabrika siç është Ferronikli menaxhon për vete mirë, mirëpo e dëmton shumë ambientin përreth dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, qytetarët e Drenasit dhe në përgjithësi atë ambient, i cili është i kufizuar me Ferroniklin, . Po ashtu, "Sharçemi" për shembull është një ndotës shumë i madh i ambientit për të cilin as Agjencioni Kosovar i Privatizimit e as institucionet e Republikës së Kosovës nuk e kanë ngritur si shqetësim shumë të madh për shëndetin e asaj popullate dhe aq më keq që "Sharçem"-in e privatizon një kompani e cila e ka monopolin në region dhe rrjedhimisht kjo do të jetë dirigjuese e çmimit dhe e lartësisë së çmimit të çimentos dhe ku Kosova është në fazën e ndërtimit, kjo orienton edhe çmimin më të lartë.

Mendoj, do të thotë që Agjencionit Kosovar të Privatizimit i ka munduar strategjia e qartë zhvillimore, monitorimi të cilin është dashur ta bëjnë institucionet e Republikës së Kosovës dhe ministrinë e dikastereve të cilat lidhen edhe me orientimet e privatizimit dhe obligimet që rrjedhin për të.

Kualiteti i implementimit të privatizimit po ashtu i ka munguar dhe ka mundësi që të revokohen këto asete të cilat janë privatizuar. Për shembull tokat bujqësore me vite të tëra rrinë në djerrinë dhe nuk ka një ligj i cili duhet të revokohet për atë privatizim i cili ka lënë pa punë shumë veta. Po ashtu fabrikat të cilat u janë ndërruar destinacionet janë shndërruar në orientime tjera restorante e të tjera.

Pika më shqetësuese është Fondi i Privatizimit, i cili edhe në një diskutim të mëparshëm të cilën e kam pasur rreth buxhetit, ai fond duhet të kthehet në Republikën e Kosovës. Duhet të nxjerrët baza ligjore për Fondin e Privatizimit dhe të orientohet në bonat e Thesarit për kreditimin e biznesit të brendshëm në Republikën e Kosovës.

Përfundimisht, mendoj që sot ky raport të miratohet mirëpo, mirëpo të thirret edhe në një seancë tjetër të rishikohet, komisionet përkatëse, t'i nxjerrin vërejtjet dhe të jetë në dobi të qytetarëve dhe të Republikës së Kosovës programi ai që ka mbetur me programet e Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti nënkryetar i Kuvendit, sinqerisht vendin e ka pasur këtu të jetë njëri prej 6 zëvendëskryeministrave. Unë e kam dëgjuar para disa ditëve që zëvendëskryeministrja Mimoza Lila -Kusari ka thënë që është e ngarkuar për ekonomi, ose ministrat përkatës që kanë një lloj përgjegjësie më të madhe edhe Bordi. Tash ne po bëjmë dialog ose monolog, po pa njerëz, pa Bordin e Agjencionit, dhe po më duket që mund t'i hymë në hak Dino Hasanajt dhe Bordit nëse flasim në raport me këtë shqyrtim që po e bëjmë sot. Salla e ka vendin për njerëz që vijnë këtu mund të dëgjojnë së paku, mund ta përcjellin debatin e deputetëve.

Unë kisha ndërmend sot t'i paraqes 20% e punëtorëve si problem, likuidimi si proces i ngadalshëm, Kosovës i duhet edhe 35 vjet ta mbyllë procesin e likuidimit në këtë dinamikë që ka. "Trepça" asetet e saja, industria dhe pronat që i ka në tërë territorin e Kosovës dhe jashtë Kosovës, spin-offi special dhe dështimi i kontratave, sidomos në industritë e mëdha dhe në industritë e lehta që Kosova ka qenë e njohur në regjione të caktuara, edhe këtu Gjilanin po flas, Industria e duhanit dhe industritë tjera në qytete, meqë Ardiani e përmendi i bëri disa pyetje po s'patë përgjigje edhe unë po duhet t'i shtroj vetëm si çështje.

Dhe, krejt në fund shfrytëzimi i mjeteve të privatizimit që janë bllokuar në Bankën Qendrore, sipas raportit janë 522 milionë e më shumë euro të grumbulluara gjatë kësaj periudhe kohore.

Atëherë mua po më mbetet vetëm përmes jush ta përcjell këtë shqetësim, por s'po e shoh të arsyeshme kurrgjë më shumë të diskutoj, pos që procesi si i tillë, po përcillet me shqetësime dhe problemet e tij. Natyrisht, unë e mbështes vlerësimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, por disa nga rekomandimet që zonja Sahatçiu i përcjelli këtu,

shpresoj të merren parasysh, por herëve tjera është mirë t'i kemi njerëzit kompetent këtu që së paku të na dëgjojnë dhe të na përmirësojnë për atë që kanë mundësi, kompetencë të tyre të përmirësojnë në të ardhmen.

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,

E vlerësoj raportin dhe mbështes raportin e AKP-së, me të gjitha detajet e paraqitura. Në kontest të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe në suaza të avancimit të punës së AKP-së, duhet të gjatë gjithë punës së vet AKP të jetë brenda kornizës ligjore, ligjet për AKP-n dhe në kuadër në suaza të Kushtetutës së Kosovës, do të jetë shtysë e zhvillimit ekonomik përmes një privatizimi të suksesshëm, duke mos harruar edhe obligimet të cilat janë krijuar për 20% e punëtorëve ndaj ish -punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara.

Kam shqyrtuar me kujdes raportin dhe më ka gëzuar fakti se "Trepça" ka rritur prodhimin edhe përkundër borxheve dhe probleme tjera të trashëguara. "Trepça" në Stantërg dhe Parku Industrial i Mitrovicës ka arritur vetëfinancime në 69% në Stantërg dhe deri në 90% Parkun Industrial. Dua t'i jap një mirënjohje më të lartë menaxhmentit të "Trepçës," minatorëve dhe punëtorëve të "Trepçës" të cilët arritën këto rezultate me punë në këto vitet e fundit edhe pse synimet e tyre dhe tonat janë edhe më të mëdha që "Trepça" të kthehet në gjigantë ekonomik, ashtu si ka qenë në të kaluarën.

Është befasishtar fakti se si në vllugun e i rimëkëmbjes së "Trepçës"- Dhoma e Veçantë e Gjykatës merr vendimin për emërimin e një administratori ndërkombëtar, gjë në këtë moment, nonsens.

Dua t'ua rikujtoj se AKP duhet të bëjë më shumë punë që "Trepça" të rivitalizohet duke marrë punëtorë të rinj për punë në minierë që të rriten kapacitetet prodhuese. AKP duhet të kërkojë llogaridhënie edhe nga menaxhmenti verior, ngase edhe ata paguhën nga tatimpaguesit kosovarë që "Trepça" të funksionojë tanimë si tërësi.

Pastaj trajtimi i mbetjeve minerale në Mitrovicë dhe për zonën ku vepron "Trepça" është çështje me urgjencë, ngase në vazhdimësi po dëmtohet ambienti në këto rrethana. Konstatohet se miratimi i strategjisë për "Trepçën" nga Qeveria në vitin 2010 ka qenë një hap i mirë, ndërsa "Trepça" do të duhej të trajtohej me një ligj të veçantë, ngase kemi të bëjmë me gjigantin më të madh të Kosovës.

Pastaj, çështje tjetër që duhet të shtyhet nga ana e Agjencionit Kosovar të Privatizimit është edhe privatizimi i Brezovicës, që tani e tri vjet vetëm po diskutohet dhe ende nuk ka një hap konkret drejt privatizimit të Brezovicës dhe likuidimi më i shpejtë i ndërmarrjeve shoqërore, me një hap më të shpejtë.

Një çështje dhe një dukuri që tani duhet të paraqes është edhe një dukuri e re e cila ka filluar të shfaqet, pengesat që disa kuvende komunale ka filluar t'i bëjë Agjencioni Kosovar i Privatizimit duke mos ua dhënë në shfrytëzim listat poseduese të ndërmarrjeve shoqërore, gjë e theksuar edhe tani në komunën e Prishtinës dhe të Podujevës, po që ka filluar një dukuri e tillë të shfaqet. Kjo është një pengesë dhe një çështje e cila do të duhej të trajtohej nëse i hyhet në ndryshimin e Ligjit për AKP-n, që kuvendet komunale kanë obligim të bashkëpunojnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me qëllim që këto ndërmarrje në pronësi shoqërore të privatizohen me një rritëm më të shpejtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me debatin edhe me pikën dhjetë, pastaj po procedojmë me votimin e të dy raporteve përnjëherë.

Pika dhjetë e shqyrtimit është:

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010

Komisioni funksional për Legjislacion ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2010 dhe Kuvendi i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotin Arben Gashi, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Arbeni nuk është.

Vazhdojmë Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk dëshiron të flasë.

Tani kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dihet se mandati i Agjencionit të Pronës është t'i zgjidhë kërkesat mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale që janë rezultat i luftës së fundit në Kosovë.

Gjatë vitit 2010, AKP ka bërë zgjidhje për disa çështje të cilat i ka parë si pengesë, çështjen e notifikimeve të gabuara të cilat janë ndërmarrë nga viti 2006 deri në vitin 2009, hapja e zyrave pronësore të UNHACER-it në Serbi, emërimi i dy anëtarëve vendorë të bordit nga Kuvendi i Kosovës.

Sipas raportit të punës së AKP-së deri më datën 3 dhjetor 2007 janë pranuar mbi 41 mijë kërkesa, prej të cilave përafërsisht 90% janë pranuar përmes zyrave të AKP-së në Serbi.

Nga data e mbylljes së pranimit të kërkesave në dhjetor të vitit 2007, AKP nuk ka pranuar më asnjë kërkesë. Nga kjo situatë rrjedh pyetja- a ekziston mundësia që t'iu mundësohet të interesuarve të cilat kanë humbur pronën si rezultat i luftës së fundit në Kosovë, të rihapet edhe një afat për paraqitjen e kërkesave, ku dihet se ende ka të interesuar për kërkesa të tilla.

Rreth 89% e këtyre kërkesave të pranuar kanë të bëjnë me tokën bujqësore, 9% në pronën banesore dhe 2% me pronat komerciale.

Gjatë vitit 2010 Komisioni për Kërkesa Pronësore ka vendosur mbi 3695 kërkesa të reja dhe 1685 kërkesa të shfuqizuara më parë, ku prej tyre janë kontestuar 98 kërkesa. Ky numër është dukshëm më i vogël se synimi i cekur në planin e punës të AKP-së.

Numri i kërkesave të vendosura deri në dhjetor të vitit 2010, domethënë gjatë vitit 2010, është 26 mijë e 953, megjithatë Komisioni ka shfuqizuar mbi 18 mijë kërkesa duke u bazuar në notifikimet e gabuara dhe në arsye tjera teknike. Do të thotë që nga kjo del se numri i kërkesave të vendosura të vlefshme është mbi 10 mijë, po ashtu Komisioni ka vendosur edhe 110 kërkesa kontestuese prej gjithsej 1549, sa kanë qenë të vlerësuara si kontestuese.

Deri në fund të periudhës është shumë e rëndësishme të cek këtë fakt, se deri në fund të periudhës së raportimit gjithsej 1867 prona janë përfshirë në skemë e qiradhënies. Shuma mbi 2 milionë e 500 mijë euro është mbledhur nga qiraja, prej tyre mbi një milion e 700 mijë u janë transferuar pronarëve të identifikuar, ndërsa pjesa tjetër mbahet si depozitë për pronarët e paidentifikuar, depozita të sigurisë dhe shpenzime administrative.

Gjithsej AKP-ja ka 581 dëbime në pritje, 299 prej tyre të janë në veri të Mitrovicës dhe 182 janë në jug të Mitrovicës, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në tërë Kosovën.

Me qenë se AKP është trashëgimtare e Habitatit, neve si grup parlamentar na intereson se sa ka arritur AKP-ja t'i implementojë vendimet për pronat që gjenden në veri të Mitrovicës? Vlen të ceket se rreth 35% e buxhetit të Agjencisë së Pronave është nga buxheti i Kosovës, ndërsa pjesa tjetër financohet nga donacionet.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit të raportit me gjithë vërejtjet e cekura, mbështet Raportin vjetor të Agjencionit Kosovar të Pronës për vitin 2010 dhe njëherit fton edhe grupet tjera parlamentare ta votojnë këtë raport. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ne emër të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!
Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, kuptohet për vitin 2010. Ne e kemi vlerësuar punën dhe angazhimin e agjencisë sipas raportit të paraqitur në bazë të ligjit dhe kompetencave që ka e vlerësojmë dhe japim përkrahje në parim.

Ajo çka është brengë e përgjithshme është edhe për Lidhjen Demokratike të Kosovës , sepse akoma rezulton perceptimi se kjo agjenci është në funksion vetëm të një komuniteti apo më mirë të them të komuniteteve pakicë dhe ne edhe ashtu edhe përmes njerëzve tanë në komisionin funksional, kemi kërkuar që ky perceptim të reflektojë më pozitivisht në bazë të raporteve dhe kërkesave pronësore që ekzistojnë në problematikën pronësore-juridike.

Prandaj, si Grup Parlamentar i LDK-së shprehim gatishmërinë të përkrahim punën dhe angazhimin e tyre dhe japim përkrahje të vazhdueshme sipas kompetencave dhe ligjeve në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Para se të vazhdojmë radhën e diskutimeve, ne patëm bisedë me 4 – 5 grupe parlamentare, nëse i kanë caktuar deputetët, një grup pra prej 4 – 5 deputetësh, le të shkojnë të bisedojnë me grevistët dhe t'u thonë që Ligji për vlerat e luftës dhe për veteranët e luftës do të vijë në ndërkohë nga Qeveria dhe këtë vit do të miratohet ky ligj, për procedura tjera, ne do ta njoftojmë opinionin. Kisha lutur që deputetët që biseduam le të dalin dhe të shkojnë dhe të bisedojnë.

Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kërkuar Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë

Kur flasim për pavarësinë e Kosovës, për shtetndërtimin, ndërtimin e institucioneve, lirinë e qytetarëve, e kemi të domosdoshme t'i hedhim një sy pavarësimit të shteteve tjera dhe sidomos parimeve në bazë të cilave ato janë ndërtuar. Shembujt e vonshëm të pavarësimit të shteteve, janë rastet e ngjashme me Kosovën, vendet të cilat, po ashtu para pavarësimit të tyre ishin nën pushtim, ishin koloni. Këto shtete janë sot të lira dhe liria e tyre u ndërtua në bazë të disa parimeve të njohura me kartën e OKB-së, parime pa të cilat pavarësia e një vendi nuk mund të mendohet.

Njëri ndër elementet kryesore të pavarësimit të një vendi, është procesi i dekolonizimit, pra e drejta që një populli t'i rikthehet prona si kusht elementar për zhvillimin ekonomik të tij. Po nuk iu kthye prona e marrë nga pushtuesit, po nuk iu krijuan kushtet që ai të ketë mundësitë e zhvillimit e ekonomik, ai përfundon prapë i varur. Pa pronën, varësia i bëhet e pashmangshme. Edhe përkundër përpjekjeve të tija të një populli pra të mëdha të ndërtojë pavarësinë e tij, pa fajin e tij, ai përfundon në varësi të re.

Agjencia Kosovare e Pronës, e bën të kundërtën, e në bashkëveprim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, këto të dyja bashkë e bëjnë saktësisht të kundërtën,

shpronësimin e plotë të Kosovës, duke e injoruar plotësisht faktin që Kosova ka qenë nën pushtim.

Në raportin vjetor për vitin 2010 të AKP-së, në kapitullin e parë, tek pika ku sqarohet, themelimi dhe mandati, qartësohet se AKP është themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut të vitit 2006/10 dhe i ndryshuar pastaj me Rregulloren 2006/50 dhe që nga 31 dhjetori 2008, funksionon në bazë të ligjit nr. 03/L-079 të Kuvendit të Kosovës dhe ku thuhet po ashtu se ligji i ri nuk e ndryshon natyrën dhe funksionimin e pavarur të agjencisë.

Më tej thuhet se AKP, ka mandat t'i zgjidhë kërkesat pronësore dhe të drejtën e shfrytëzimit për pronën e patundshme private, përfshirë pronat komerciale dhe tokën bujqësore e direkt të ndërlidhura këto si rezultat (siç e quan raporti) i konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, dhe sqaron se janë pranuar rreth 41000 kërkesa 90% e të cilave janë pranuar përmes zyrave të AKP-së në Serbi. Natyrisht, nga shpallja e Pavarësisë, këtë punë e kryen tash UNHCR-ja përmes zyrave të saj të pronave.

Pra, përveç asaj që thuhet se në Kosovë nuk kishte luftë, por vetëm konflikt të armatosur, ky konflikt konsiderohet i kufizuar, madje në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Edhe pse tani në kuadër të AKP-së është edhe ish- Drejtoria për Çështjen Pronësore të Banesave, që është marrë edhe me trajtimin e uzurpimit të banesave nga periudha e viteve '90, trajtimi është bërë asisoj që, vetëm rastet tejet flagrante të largimit të qytetarëve nga banesa në vitet '90 i ka trajtuar. Ndërsa, rastet kur personat e kanë humbur, ta zëmë, banesën me humbjen e punës si pasojë e largimit nga puna, nuk janë trajtuar dhe procesi i dhënies së banesave aso kohe, në ato vite për qytetarët serbë në kuadër të planit për kolonizim të Kosovës trajtohet si i ligjshëm.

Po harrojmë që në ato vite si pasojë e terrorit, dhe politikës së spastrimit, Kosova çdo ditë zbrazej nga shqiptarët dhe çdo ditë në Kosovë vinin kolonistë të rinj, nga Serbia dhe zonat e luftës në Kroaci, Bosnje.

Pronat në AKP, nuk shikohen pra përmes prizmit të një trajtimi të thellë e të drejtë, ndërsa kur bëhet fjalë për çështjen e pronave për shqiptarët në veriun e Kosovës, ato trajtohen vetëm sipërfaqësisht, me arsyetimin e gjendjes së rëndë atje. Është një numër tejet të vogël i trajtimit të pronave atje në raport me problemet, në raport me uzurpimet edhe përkundër kërkesave të shqiptarëve. Intervenimet për dëbime nga pronat e shqiptarëve të cilat janë uzurpuar, janë ndalë që nga janari i vitit 2010 dhe këto intervenime kishin filluar në shtator të vitit 2009, pra vetëm 4 muaj ka zgjatur kjo ndërmarrje.

Duhet sërish të përmendim faktin që janë 11.564 shqiptarë të dëbuar nga veriu i Mitrovicës në shkurt të vitit 2000, pronat dhe banesat e të cilëve i shfrytëzojnë sot serbët atje. Veriu i Mitrovicës para vitit 2000, dhe edhe në vitet e mëhershme ishte i banuar me shumicë shqiptare, pa pjesën jugore. Pra edhe pjesa e ndarë, pa jugun në vetvete ishte e

banuar me shumicë shqiptare. Këtu do të duhej të punohej e jo të zvarritej ky proces pasi paralelisht me këtë zvarritje, shqiptarët e varfër, të dëbuar nga shtëpitë e tyre janë detyruar t'i shesin pronat e tyre e të cilat i blen qeveria e Serbisë, përmes fondeve të saja.

Nga ana tjetër bazuar edhe nga përqindja e kërkesave drejtuar AKP-së dhe fakti që ato vijjnë 90% nga zyrat në Serbi, tregon se puna kryesore e AKP-së janë pronat e serbëve.

Çështja e pronave të shqiptarëve të dëbuar në veri, zvarritet, dhe çështja pronave të serbëve është prioritet, pa u shikuar asnjëherë origjina e atyre pronave se a janë prona kolonësh.

Në Kosovë kanë ndodhur krime, shkatërrime familjesh, dëbime, rrëmbime pronash etj. Edhe kjo përgjatë një periudhe të gjatë, me dekada. Dhe gjatë tërë kësaj kohe ajo që shqiptarët mbajnë në mend më së tepërmi është blerja dhe riblerja e pronës së vet.

Shqiptarët historikisht pas vitit 1912, ose janë detyruar t'i lënë pronat, pasojë e dëbimit ose janë detyruar t'i riblen shumë herë pronat e veta të marra shumë herë nga pushteti dhe kolonët. Dhe shumëkush sot pronat që i ka, i ka në saje të këmbënguljes që ta ruajë pronën e trashëguar nga të parët dhe ta mbajë edhe përkundër çmimit.

Në librin e studiuesit serb Millovan Obradović, që quhet " Reforma agrare dhe Kolonizimi i Kosovës, të vitit 1918-1941," të periudhës kohore 18 – 41 jepen me emra e mbiemra të dhënat për gjithë kolonët serbë e malazias të ardhur, përshkruhet shumë qartë, dëbimi i shqiptarëve, nga Kosova për në Turqi si dhe marrja e pronave të shqiptarëve dhe dhënia e atyre pronave kolonëve serbë e malazias.

A do të duhej ta shtrojmë ndonjëherë çështjen, çështjen se sot në Turqi jetojnë në varfëri shqiptarë të shumtë, pronat e të cilëve janë në Kosovë, dhe janë në pronësi të kolonëve, a nuk është kjo një padrejtësi?

A nuk kanë ndodhur padrejtësi të tilla vazhdimisht, a nuk është krim edhe fakti që këta kolonë janë mësuar që pronat e dhuruara t'i shesin dhe pushtetet t'ua dhurojnë sërish?

Dhe të mos harrojmë se edhe sot përsëritet e njëjta gjë përmes të ashtuquajturit kthim i qëndrueshëm. Jemi për kthimin edhe do të donim që ai të jetë i qëndrueshëm, por jo që në emër të fjalës i qëndrueshëm të dhurohen vendbanime në vendet ku nuk kanë jetuar më parë ata që kthehen, pasi ky kthim i qëndrueshëm nënkupton që të kthyerit mund të kthehen diku ku nuk kanë jetuar më parë dhe jo domosdoshmërisht në pronën e tyre. Atyre pra iu ndërtohet një shtëpi tjetër apo banesë tjetër diku në një vend tjetër, ndërsa që pronën e mëhershme e kanë tanimë të shitur.

A nuk është kjo një politikë e vazhdimit të kolonizimit dhe veprimtaria e AKP-së a nuk po e ndihmon këtë?

Me AKP- n dhe me këtë politikë të padrejtë nuk ka ndërtim të shtetit të Kosovës, nuk ka zhvillim dhe do të ketë përherë varësi.

Çështja e pronave duhet rishikuar, duke pasur parasysh parimet e dekolonizimit, origjinën e pronave, pasi ajo do të duhej të ishte e shenjtë, për të gjithë.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta votojë Raportin e Agjencisë Kosovare të Pronës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti ose në emër të Grupit Parlamentar, kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Raporti të cilin e kemi sot para vetes e paraqet saktë atë që ka ndodhur gjatë vitit të kaluar si pjesë e punës së Agjencionit Kosovar të Pronës, agjencion ky i cili është themeluar në vitin 2006 në mënyrë që t’i shkarkojë gjyqet dhe t’i zgjidhë kontestet e drejtpërdrejta pronësore, kryesisht që kanë të bëjnë me serbët e larguar menjëherë pas luftës në Kosovë, mirëpo edhe ka qenë dashur të merret edhe më tepër atë numër të shqiptarëve që janë larguar nga pjesa veriore e Kosovës, më pastaj.

Në total mendojmë se ka ndodhur një punë, ka kaluar një pjesë e mirë e rasteve të cilat janë shqyrtuar edhe një herë po them raste të drejtpërdrejta nga Agjencioni Kosovar i Pronës, është një gjë e cila ndoshta mbetet që të shihet edhe pak më tutje pse nuk ka qenë një financim më i madh nga Qeveria e Kosovës, në mënyrë që Kosova të ketë pronësi më të madhe?

Kur flas për këtë financim, atëherë me qenë se ka ndodhur një punë, me qenë se ka ndodhur një financim ne e dimë që donatorët mandej kanë qenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një kohë, Qeveria e Norvegjisë e pa i përmend veç e veç edhe shtet e Unionit Evropian edhe mendojmë se ky financim ka kontribuar që sot të kemi pakë raste të kontestuar sa i përket pronës në Kosovë.

Ajo që ka ndodhur fillimisht ka qenë si një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës janë vendosur, janë strehuar nëpër prona për shkak se shtëpitë e tyre dhe prona e tyre ka qenë e shkatërruar totalisht. Ata njerëz nuk kanë pasur ku të jetojnë për shkak se Serbia e ka shkatërruar krejt çka kanë pasur, do të thotë në çfarëdo rrethana njerëzore dhe humane, strehimi ka qenë absolutisht legjitim. Në ndërkohë, ka ndodhur një rindërtim në Kosovë, kryesisht prej donatorëve dhe shumë shtëpi janë rindërtuar, shumë njerëz janë kthyer nëpër vende të veta dhe prapë Kosova, Kuvendi, Qeveria e Kosovës duhet ta falënderojë cilindo donatorë, prej Japonisë e deri te Kanadaja, për ndihmën që i ka dhënë Kosovës në atë kohë. Një gjë që ka mbetur peng është se Kosova me fondet e veta i ka ndërtuar një numër jo të vogël të shtëpive të qytetarëve serbë të Kosovës, kur shtëpitë e tyre janë djegur ose janë rrënuar, qoftë në vitin 2004, qoftë përpara, qoftë për çfarëdo arsye tjetër, mirëpo ende nuk e kemi një fond të Qeverisë së Kosovës që t’i rindërtojë ato shtëpi sado që të jenë të qytetarëve të Kosovës shqiptarë, të cilët nuk kanë arrit që të përfitojnë nga ndihmat e donatorëve pas vitit 1999 deri në vitin 2000.

Ne e dimë pse ka ndodhur ndërrim i titullarëve me dhunë më përpara, ne e dimë se ka pas shpronësimit të shqiptarëve. Shumë prej nesh këtu që janë prezentë e kanë provuar t'i blejnë pronat e veta tri herë radhazi, mirëpo kjo nuk e zhbën nevojën që ne të vendosim ligjshmëri sa i përket kthimit të pronave te ata që i kanë.

Agjencioni Kosovar i Pronës nuk është shkalla e fundit e zgjidhjes së kontesteve pronësore, ka edhe gjyqe.

Ne si Grup Parlamentar do ta mbështesim këtë raport, do t'ia japim votën tonë që të miratohet për shkak se nuk ka rrugë tjetër, janë disa provizione tjera që e rregullojnë pak më ndryshe, mirëpo i kemi disa rekomandime. Ne e thërrasim Agjencionin Kosovar të Pronës, që të paktën në vitin 2011 të punojë pak më tepër në veri të Kosovës, duke i ditur sfidat, duke i ditur që sfidat atje janë edhe të sigurisë me të cilat duhet të merret edhe Qeveria e Kosovës, por prapëseprapë të paktën nominalisht Agjencioni Kosovar i Pronës duhet të ketë kujdes për shkak se precepti është krijuar, me të drejtë ne besojmë se Agjencioni më tepër i ka kushtuar kujdes kthimit të pronave qytetarëve serbë të Kosovës se sa kthimit të pronave të qytetarëve shqiptarë të Kosovës dhe ne mendojmë se kështu nuk duhet të ndodhë.

Duhet përshpejtohet përmbyllja e punës, do të thotë raste të cilat bien në kompetencë të Agjencionit Kosovar të Pronës duhet të zgjidhen sa më shpejtë që të jetë e mundur, raste të cilat nuk mund t'i zgjidh agjencioni duhet t'iu kalojnë gjyqeve, por kjo punë duhet të ndodhë më shpejtë. Duhet të gjejmë zgjidhje Kuvendi, Qeveria dhe Agjencioni për vazhdimësinë. Ju e dini që agjencioni, përpos zgjidhjes së rasteve drejtpërdrejta e ka në mbikëqyrje edhe një proces ose një sistem të skemës së qirasë, ku ato prona të cilat nuk mund të zotërohen nga pronarët legjitimë, jepen me qira dhe këtë proces e menaxhon Agjencioni Kosovar i Pronës. Do të thotë në këtë rast ne e dimë se edhe nëse përmbyllet çështja e zgjidhjes së rasteve do të mbetet një punë e agjencionit në të cilën të ardhmen ne do të gjejmë zgjidhje se si do të kryhet.

Një rekomandim për Qeverinë e thashë më përpara, Qeveria e Kosovës duhet ta ketë një data-bazë të saktë cilët janë ata qytetarë të Kosovës të cilët nuk kanë përfitua prej ndihmave prej vitit '99 e këndej dhe për aq sa ndërton shtëpi për qytetarët serbë të Kosovës, që ne mendojmë që është një punë legjitime, po aq duhet të ndërtojë shtëpi edhe për qytetarë shqiptarë të Kosovës të cilët mund t'ju them se ende kemi raste të cilët jetojnë nëpër shtëpi të djegura ose gjysmë të ndërtuara që nga viti 1999. Me këto vërejtje, me këto rekomandime ne që i bëjmë, ne do ta votojmë Raportin e Agjencionit Kosovar të Pronës. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, ka shqyrtuar raportin e Agjencionit Kosovare të Pronës. Konsiderojmë se i njëjti përmbushë kushtet teknike dhe përmbajtjesore të raportimit të njëjtin do ta përkrahim. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “6+” deputeti, Allbert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2010 dhe pas vlerësimit të tij mendojmë se në vete përmban të dhëna të mjaftueshme për aktivitetin e AKP-së, dhe mendojmë si i tillë i plotëson kushtet për miratim. Dhe, Grupi “6+” do ta mbështesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Prej SLS-së ka dikush? Nuk ka.

Atëherë, fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Dhe unë jam në kuadër të qëndrimit që u tha më herët që ne e përshëndesim këtë përpjekje dhe punën që e ka bërë Agjencioni për Pronën, ndërsa unë desha ta komentoj pak raportin në faqen 24 që lidhet me gjendjen në Mitrovicë. Thjeshtë, për arsye se nuk është thjeshtë çështje teknike që bëhet fjalë për disa prona të uzurpuara në këtë pjesë dhe tentimi i një balancimi në mes të dy pjesëve të qytetit, që nuk është aspak reale, për arsye siç dihet që në jug të qytetit qiratë aplikohen veç 5 vjet, ndërsa në veri vërtetë shumë pak është bërë në këtë drejtim. Prandaj, dhe dëshirat që shprehen këtu në raport që atje të kemi angazhime shtesë në drejtim të respektimit të drejtave, lirive të njeriut por edhe që komplet si sistem edhe jashtë kompetencave të AKP-së, bëjnë gjithçka që është e mundur në mënyrë që së paku njerëzve t’iu ndihmohet që të mos shiten pronat aty ku nuk ka vullnet si pasojë e halleve që qytetarët kanë ngase nuk janë në një situatë që të kthehen në pronat e tyre për shkak të situatës që është.

Prandaj, një përkrahje për raportin, por që ajo që unë të shpreh pakënaqësinë time që këtu në raport nuk është dhënë as më e vogla ide se cilët janë hapat e paraparë që në kuadër të gjitha angazhimeve dhe në drejtimin e rritjes së sundimit të ligjit dhe në drejtimin krijimit të fondeve që ata njerëz të kompensohen në mënyrë që së paku qytetarët ta krijojnë një shpresë që nëse jo sot atëherë së paku së shpejti atyre do t’iu zvogëlohen pasojat që kanë për arsye se nuk kanë qasje në pronat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Ndoshta ka menduar që ky është raporti i punës. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

E mbështes Raportin e Agjencisë Kosovare të Pronës, me një kërkesë timen dhe të shumë qytetarëve të Mitrovicës, që kjo agjenci vërtet gjatë punës së saj ta ketë një qasje më parimore në Mitrovicë, në veçanti për pronën e shqiptarëve e cila ende vazhdon të shfrytëzohet dhe të keqpërdoret nga uzurpuesit dhe parimin e reciprocitetit, domethënë nuk e ka respektuar Agjencia Kosovare e Pronës dhe mund të them që krahasuar pjesa jugore me atë veriore, nuk ka pronë po thuaj se më fare të uzurpuar, ajo është e liruar në pjesën jugore, ndërsa po thuaj se e tërë prona e shqiptarëve në pjesën veriore të Mitrovicës vazhdon të mbetet e uzurpuar edhe Agjencia e Pronës këtu nuk ka bërë shumë për të ndryshuar gjendjen.

Dhe unë një diskutim timin më të hershëm i kam quajtur të gjithë ata shqiptarë që vazhdojnë të qëndrojnë në pjesën veriore të Mitrovicës dhe ata të cilët nuk kanë pranuar edhe këtë pronë të uzurpuar ta shesin si patriotë të vërtetë të çështjes dhe të momentit të kësaj kohe të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë, s'kemi të lajmëruar për diskutim.

Kemi të votojmë për dy raporte. Fillimisht votojmë për Raportin vjetor të Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Në sallë jemi 68 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 46 vota "për", 14 "kundër" dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Edhe raportin e fundit, do të thotë përgatitemi për të votuar Raportin vjetor të Agjencionit Kosovar të Pronës. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 51 vota "për", 13 "kundër" dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Agjencionit Kosovar të Pronës për vitin 2010.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lektorim e Kuvendit të Kosovës